



Balkan Sunflowers
Volunteers for Social Reconstruction



Partneritet për Kohezion Social përmes Programeve të Edukimit dhe Zhvillimit të
Fëmijërisë së Herëshme në Europë

RESPEKTIMI I DIVERSITETIT DHE NDËRTIMI I PAQES NË KOSOVË PËR FËMIJËRIN E HERËSHME



Manual për edukatorët që punojnë në fëmijërinë e herëshme

Falenderim

Balkan Sunflowers Kosova dhe anëtarët e Rrjetit PRECEDE në Kosovë dëshirojnë të falenderojnë të gjithë profesionistët dhe edukatorët për kontributin e tyre në rishikimin e manualit Respektimi Diversitetit dhe Ndërtimi paqes në fëmijërinë e hershme për t'u zbatuar në institucionet e arsimit parashkollor në Kosovë:

Ministria e Arsimit –Departamenti për Fëmijërinë e hershme

Instituti Pedagogjik i Kosovës IPK

Kosova Education Center KEC

Kopshti publik “Ardhmëria” Prishtinë

Kopshti publik “Ardhmëria 2” Gjilan

Kopshti publik “Yllkat” Prishtinë

Kopshti publik “QEAP” Lipjan

Kopshti publik “Dielli” Drenas

Kopshti jo publik “SOS”, Prishtinë

Kopshti jo publik “Mësonjëtorja Qiriazi” Gjilan

Kopshti jo publik “Margherita Kits” Klinë

Kopshti jo publik “Kopshti i Fëmijëve” Ferizaj

Kopshti jo publik “Loja” Prishtinë

OJQ-të:

Save The Children

Shpresa e Jetës

Gjithashtu Rrjeti i PRECEDE dëshiron të falenderojë të gjithë fëmijët që kanë qënë pjesë e pilotimit të programit dhe prindërit e tyre në kopshtët e sipër përmendur si dhe specialistëve të arsimit parashkollor të Drejtorive Komunale: Prishtinë, Ferizaj, Lipjan, Klinë, Gjilan, Drenas.

Një falenderim i veçantë shkon për Z. Rand Engel i cili ka dhënë mbështetjen në pilotimin e këtij manuali dhe përshtatjen me kontekstin kosovar por gjithashtu edhe për mbështetjen teknike të ofruar në strukturimin e tij.

Pa mbështetjen e personave dhe institucioneve të lartpërmendura nuk do të ishte i mundur rishikimi dhe përshtatja e këtij manuali që do të përdoret në Kosovë.

Përmbajtja

Hyrje	4
Qasja e programit	5
Profesionisti reflektiv	8
Materialet e përdorura në këtë manual	9
KAPITULLI 1	12
KAPITULLI 2	18
KAPITULLI 3	25
KAPITULLI 4	35
KAPITULLI 5	45
KAPITULLI 6	50
KAPITULLI 7	54
KAPITULLI 8	58
KAPITULLI 9	73
Error! Hyperlink reference not valid.	
Përdorimi i teknikave të ndryshme	100
Shtojca 1	101
Historia “Qyteti i Ndjenjave”	101
Shtojca 2	104
Historia “Foshnja në Djep”	104
Shtojca 3	106
Historia “Breshka dhe Lepuri”	106
Shtojca 4	107
Historia “Luani dhe Miu”	107
Shtojca 5	109
Historia “Arbeni Kalon Kohën me Miqtë e Tij”	109
Shtojca 6	111
Historia e milingones dhe gjinkalles	111

Hyrje

Manuali për Respektimin e Diversitetit dhe Ndërtimi Paqes në Kosovë është përshtatur për ti ndihmuar edukatorët dhe profesionistët që punojnë në fëmijërinë e hershme në qendra dhe institucione. Ky manual është një përshtatje e Manualit Rajonal PRECEDE i zbatuar në 48 kopshte të 5 shteteve të Ballkanit; Shqipëria, Kosova, Serbia, Kroacia dhe Maqedonia. Ky manual është një ndërthyrtje e Manualit Ndërkombëtar të Profesionistëve që Punojnë me Fëmijët e Vegjël në Zonat e Konfliktit i cili është zhvilluar nga Rrjeti Ndërkombëtar i Paqës dhe Manualit të Aflatot për edukimin shoqëror dhe financiar të Fëmijëve të Vegjël i zhvilluar nga Sekretariati i Aflatoun.

Ne besojmë që fuqizimi, barazia, pranueshmëria dhe të kuptuarit si dhe respekti për të tjerët, janë element kyç për të ndërtuar paqën dhe respektin për diversitetin që në moshë të hershme. Këto vlera janë të gdhendura në besimin tonë se fëmijët e vegjël janë agjentë të paqës. Me këtë manual ne kemi si qëllim që:

- Të trajtojë dhe ndryshojë qëndrimet ekzistuese dhe mbizotëruese rreth funksionit të Kujdesit dhe Zhvillimit të Fëmijërisë së Hershme dhe programet që nxisin respektin për diversitetin;
- Të rrisë kuptueshmërinë e rëndësisë së zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme dhe rolin që kanë insitucionet apo qendrat e fëmijërisë së hershme për të ofruar mundësi të barabarta në jetë për të gjithë fëmijët dhe për të fuqizuar të gjithë aktorët kyç në arsimin parashkollor për të avokuar për programe gjithëpërfshirëse;
- Të motivojë insitucionet e arsimit parashkollor dhe komunitetet lokale që të rrisin ndërgjegjësimin e tyre kundër diferencimeve apo kategorizimeve për shkak të fesë, gjinisë, racës, moshës etj. dhe për t'a përkthyer vlerën e BARAZISË në një vlerë e cila zbatohet në praktikën e përditshme;
- Të promovojë pranimin e besimeve të ndryshme, etnike dhe gjuhësore mes fëmijëve dhe të rriturve, gjithashtu të krijojë kuadro për të kuptuar dhe respektuar diversitetin.

Gjatë zbatimit të Manualit për Respektimin e Diversitetit dhe Ndërtimit të Paqes duhet:

- *Të nxitet pjesëmarrja e fëmijëve dhe familjeve tyre;*
- *Të prezantohen fëmijët dhe familjet e tyre me Konventën e të Drejtave të Fëmijëve;*
- *Të rritet ndërgjegjësimi i edukatoreve mbi rolin e fëmijëve dhe të prindërve si dhe mbi rëndësinë që ka njohja e perspektivave të fëmijëve dhe prindërve në jetën e kopështit;*
- *Të nxisë edukatorët të pranojnë dhe të njohin vlerën e ideve dhe pikëpamjet e fëmijëve dhe prindërve gjatë punës tyre;*
- *Të japë mundësi edukatoreve të ndajnë vizionin dhe moton e tyre me fëmijët dhe familjet e tyre;*
- *Të përfshijë dhe të nxisë një mjedis multi-kulturor dhe praktika gjithëpërfshirëse që nxisin të drejtat e çdo fëmije dhe respektimin e aftësive individuale;*
- *Të nxisë dhe të prezantojë avantazhet e kësaj qasje në praktikën e punës në programet e fëmijërisë së hershme*

Qasja e programit

Ne jetojmë në një botë të përbërë nga kultura, gjuhë, raca dhe sfoden historike të ndryshme. Kjo shumëllojshmëri e bën jetën tonë më interesante, por vetëm nëse jemi në harmoni me njeri tjetrin. Gjithashtu u bë e qartë se ambjenti ku mëson fëmija shtrihet përtej ambjentit të shtëpisë apo qendrave të fëmijërisë së hershme jashtë shtëpisë.

Kuadri konceptual i fëmijës në kontekstin e familjes së tyre dhe të komunitetit u hartua dhe u ndikua duke u bazuar në Teorinë e Sistemeve Ekologjike Bronfenbrenner (Bronfenbrenner 1979). Teoria e Sistemeve Ekologjike shpjegon se si mjedisi social i fëmijëve ndikon në rritjen dhe zhvillimin e tyre.

Sipas Bronfenbrenner, mjediset që ndikojnë në zhvillimin e fëmijëve variojnë nga sistemet mikro në sistemet makro. Sistemet mikro i referohen marrdhënies midis fëmijës dhe mjedisit të menjëhershëm siç janë prindërit, shtëpia dhe familja. Ndërkohë që fëmija rritet, sistemet makro bëhen më komplekse, duke përfshirë më shumë njerëzës siç janë qendrat e fëmijërisë së hershme. Sistemet makro janë strukturat më të mëdha sociale të cilat janë të largëta për fëmijën, por që ende kanë ndikim të madh mbi fëmijën. Sistemet makro përfshijnë kontekste më të gjera të modeleve institucionale të kulturës të tilla si politikat qeverisëse, ekonomike, të medias, luftës dhe konfliktit.

Korniza e mëposhtme (figura 1) përfaqëson fëmijën në qendër dhe disa prej shtresave të rëndësishme sociale që ndikojnë mbi fëmijën dhe e rrethojnë atë në çdo kohë të dhënë.

Nga perspektiva e të drejtave të fëmijëve, këto sisteme sociale kanë ndikim të ndërsjelltë, fëmija ndikohet nga, por edhe ndikon sistemet.




Fig.1 Korniza

Korniza ofron një mjet të dobishëm për të krijuar një hartëzim dhe për të vlerësuar programet në mënyrë që të maksimizojë potencialin pozitiv të programeve dhe të minimizojë efektet e mundshme negative të konfliktit tek fëmijët e vegjël. Gjithashtu lejon përfshirjen e ndikimit ekologjik të dhunës fizike, strukturore dhe kulturore, dhe rëndësinë e adresimit të të gjitha këtyre aspekteve në ndërtimin e paqes së qëndrueshme.

Duke menduar ekologjikisht rreth ndërtimit të paqes, ne pranojmë pohimin e Galtung se "Paqja është më shumë se mungesa e Luftës" (Galtung 1996). Prandaj ndërtimi i paqes bën fjalë jo vetëm për adresimin e dhunës fizike dhe ndikimin e saj në jetën e fëmijëve të vegjël, por bën fjalë edhe për adresimin e dhunës strukturore dhe kulturore. Gjithashtu si një ndikimin të tmerrshëm të dhunës fizike, ne duhet të pranojmë edhe pabarazitë në aksesin për kujdes shëndetësor, dhunënë kulturore të tillë si pabarazitë gjinore dhe ndikimin e tyre tek fëmijët e vegjël. Nëpërmjet këtij këndvështrimi ekologjik shumë-dimensional, ne pranojmë se nëse duam që ndërtimi i paqes të jetë i qëndrueshëm, duhet të përfshijë dimensionet ligjore, kulturore dhe socio-ekonomike të jetës së fëmijëve të vegjël.

Fëmija - Ndërsa natyra dhe shkalla e konfliktit është e ndryshme në çdo situatë, rezultati është që fëmijët e vuajnë këtë gjë si një fatkeqësi direkte, fizike apo emocionale. Prandaj fëmija është në qendër të punës dhe të menduarit tonë, ndaj dhe të gjitha veprimet e ndërmarra duhet të marrin në konsideratë mjediset e ndryshme që kanë ndikim tek fëmija.

Familja – Situatat konfliktuale mund të sjellin stres dhe tension në familje gjë e cila ndikon në aftësinë e tyre për t'u kujdesur për fëmijët e tyre në mënyrë efektive. Trauma e përjetuar në familje mund të kuptohet dhe brëndësohet nga fëmijët. Gjithashtu, urrejtja dhe paragjykimi mund të kalojë nga një brez tek tjetri. Për këtë arsye ne duhet të mbështesim familjet në situata konfliktuale. Programet e Fëmijërisë së Hershme që kanë si komponent të fortë edukimin e

prindërve, mund të kenë një ndikim veçanërisht të fuqishëm në kapitalin social, duke bërë që prindërit të ndërtojnë besimin mes grupeve të ndara "(ACEV 2008).

Qendrat e fëmijërisë së hershme - Sipas Connolly dhe Hayden (2007) programet e Zhvillimit të Fëmijërisë së Hershme (ECD), kanë aftësinë që të inkurajojnë komunitetet në konflikt që të zhvillojnë vizione alternative për të ardhmen bazuar në nevojat e fëmijëve.

Si pasojë e konfliktit, ri-ndërtimi i shoqërisë është një sfidë pasi ata karakterizohen zakonisht nga mosbesimi, tensioni dhe urrejtja. Shumë prej marrëdhënieve ndërpersonale i kanë rrënjët e tyre në fëmijërinë e hershme, për këtë arsye ndërhyrjet në vitet e fëmijërisë së hershme mund të kontribuojnë në ndryshimin e sjelljes. Të gjitha programet e Fëmijërisë së Hershme, duhet të bazohen në pedagogjinë me fëmijën në qendër dhe të përqëndrohet në ndërtimin e ndjeshmërisë, vetë-vlerësimin dhe respektin për të ndryshmen, diversitetin. "Arsimi në përgjithësi veçanërisht kopshtet apo qendrat e fëmijërisë së hershme janë një vlerë e madhe psikologjike dhe e menjëhershme gjatë periudhës së luftës duke ofruar një hapësirë të sigurtë për fëmijët si dhe ofrojnë shpresë në situatat kaotike ose me fjalë të tjera situata që në dukje janë të pashpresa" '(UNESCO 2002; Nixon 1996) .

Komunitetet e mëdha - Konflikti mund të sjellë si rezultat jo vetëm shkatërrimin e familjes por edhe shpërbërjen e komuniteteve. Ai mund të ndikojë në shërbimet që ofrojnë spitalet, në aksesin e rrugëve, higjenë dhe furnizimin me ujë. Kjo mund të sjellë jo vetëm vuajtje dhe zhvendosje, por edhe krijimin e ndarjeve të reja të thella në komunitet (Connolly dhe Hayden 2007). "Kur programet e Fëmijërisë së Hershme janë të hartuara si ndërhyrje për zhvillimin shoqëror duke tejkuluar nivelet mikro dhe makro në shoqëritë e pritura drejt konfliktit, ata mund të ndërhyjnë në ndarjet e komunitetit dhe kanë një ndikim pozitiv në kapitalin social dhe dinamikat pro paqes' (ACEV 08).

Kultura, Ekonomia, Qeverisja, Kërkimet, Media – Ky është grupi më i madh dhe më i largët i strukturave shoqërore që kanë një ndikim të madh mbi fëmijën. Këtu përfshihen: liritë e lejuara nga qeveria e vëndit; vlerat kulturore; ekonomia; ndikimi i medias dhe programet e bazuara në fakte. Këto ndikime mund të ndikojnë një fëmijë pozitivisht ose negativisht. Nga një pikëpamje ekologjike është thelbësore që praktika dhe advokacia të arrijnë këtë nivel.

Për të ndërtuar një paqe të qëndrueshme, duhet të adresohen të dyja shkaqet e dhunës, shkaqet e drejtpërdrejta dhe ato jo të drejtpërdrejta. Në mënyrë që të drejtat e fëmijëve të vegjël të mbrohen tani dhe në të ardhmen duhet të vendosen ura lidhëse ndërmjet praktikës dhe politikave, medias dhe niveleve të qeverisjes.

Roli i profesionistëve/mësuesve/të rriturve është një rol kyç në mbështetjen që u jepet fëmijëve për të fituar vlera, qëndrime dhe aftësi për të trajtuar diversitetin/ndryshueshmërinë pozitivisht dhe për t'i bërë aktorë socialë në ndërtimin e paqes.

Organizimi i aktiviteteve për ndërtimin e paqes në punën tuaj me fëmijët, ju mund të siguroni që interesat më të mira të fëmijëve dhe familjeve janë parësore në punën tuaj. Vlerat e bazuara tek të drejtat themelore të fëmijëve të tilla si, e drejta për t'u dëgjuar, respektuar, e drejta për barazi, pjesmarrje, mbrojtje dhe lojë, mund të vendosen/nguliten në praktika të përshtatshme sipas moshës. Ky është ndërtimi i paqes në nivel individual (ndërtimi i paqes nga brenda dhe jashtë).

Profesionisti reflektiv

Si profesionistë reflektiv, është thelbësore që ju të shqyrtoni në mënyrë kritike aktivitetet dhe qëllimin e tyre dhe ti përshasni këto aktivitete në situatën tuaj kulturore, lokale dhe kombëtare dhe grupmoshës së fëmijëve me të cilët ju punoni. Kjo kërkon që ju të përshtasni aktivitetet sipas zhvillimit të grupmoshës së fëmijëve, duke treguar një sërë tregimesh, vjershash dhe këngë bazuar mbi kulturën, fenë dhe historinë si dhe duke organizuar aktivitete të ndryshme nga vetë mjedisi juaj apo i të tjerëve. Kjo është e rëndësishme pasi i jep mundësi fëmijëve të familjarizohen me këtë gjë si dhe të pranojnë perspektivën e të tjerëve dhe atyre që janë të ndryshëm.

Fëmijët janë një pjesë përbërëse e shoqërisë. Ata vështrojnë, përthithin dhe brëndësojnë ngjarjet dhe informacionin që përjetojnë. Ata vijnë nga niveli i parashkllorëve dhe nga shkolla, me shumë njohuri dhe informacion të cilin e kanë marrë nga prindërit, vëllezërit e motrat, fqinjët, pjestarët e komunitetit, televizioni dhe interneti. Të gjitha këto aspekte luajë një rol në formësimin e perceptimit dhe në ndikimin e të kuptuarit të ngjarjeve që ndodhin rreth tyre (në mënyrë eksplicite dhe implicite).

Fëmijët e vegjël janë gjithashtu "qytetarë të botës", të cilët janë të vetëdijshëm për rrënjët e tyre, por të hapur për horizonte kulturore dhe gjeografike pa kufij (Rinaldi, 2001). Nëse ne si edukatorë të fëmijërisë së hershme, dëshirojmë që fëmijët që janë në kujdesin tonë apo ato me të cilët punojmë të kuptojnë këtë perspektivë, ne duhet të ndihmojmë fëmijët që të mësojnë të pranojnë dhe kuptojnë ngjashmëritë dhe dallimet me të tjerët, sidomos në rajonet e konfliktit, ku për fat të keq ata mund të marrin mesazhe kontradiktore nga ajo që i rrethon.

Nëse ne dëshirojmë të edukojmë fëmijët që të respektojnë të tjerët të cilët janë të ndryshëm, ata duhet të kenë mundësinë për të eksploruar traditat dhe zakonet e komuniteteve të ndryshme në vëndin ku jetojnë. Duke vepruar në këtë mënyrë, ne u japim fëmijëve mjetet dhe njohuritë e nevojshme për të kuptuar respektin dhe pranimin e të tjerëve. Në jetën e përditshme në programet e fëmijërisë së hershme nuk është e lehtë të trajtosh çështjen e "pranimit të të tjerëve" dhe ndonjëherë në vëndet që janë në konflikt, duket si një mision i pamundur. Megjithatë, kërkimet tregojnë se trajtimi i dallimeve/ndryshueshmërisë në programet e fëmijërisë së hershme mund të sjellë një ndikim pozitiv në jetët e fëmijëve (Connolly et al 2009).

Ka një bazë të përbashkët në zgjidhjen e konflikteve si në nivel ndër personal edhe në rrethe më të gjëra, të tilla si në nivel kombëtar, etnik dhe fetar të cilat janë rrënjët e situatave të konfliktit. Prandaj nëse fëmijët kuptojnë dhe kalojnë një përvojë të zgjidhjes së konfliktit, pajtimit dhe ndërtimit të paqes në nivel ndër personal kjo nënkupton një zhvillim të përshtatshëm dhe gjatë kohës që ata rriten vendosin bazat për mirëkuptimin e ndryshueshmërisë, tolerancës, respektit, të dëgjuarit dhe demokracisë në mjedise të ndryshme. Nëpërmjet modeleve pozitive që nga fëmijëria e hershme dhe më pas, fëmijët do të kuptojë se në botë ka shumë mënyra dhe strategji për të trajtuar konfliktet.

Gjithashtu programet e Fëmijërisë së Hershme mund të reduktojnë pabarazitë duke promovuar zhvillimin e të gjithë fëmijëve veçanërisht të atyre që janë në disavantazh apo të pa favorizuar.

Kjo mund të përmirësojë shanset e suksesit në jetë. Edukimi i ndërtimit të paqes mund të promovojë aftësitë që i japin mundësi fëmijëve dhe prindërve që të bëhen agjentë ndryshimi për ndërtimin e paqes në shoqëritë e tyre. Kjo mund të sjellë ndërtimin e paqes në nivel shoqërie.

Është përgjegjësia jonë që të krijojmë një mjedis të sigurtë dhe mbrojtës në qendrat/mjediset e fëmijërisë së hershme të tilla si kopshtet, shkollat apo ndonjë ambient tjetër që nxit fëmijët të kenë një kuptueshmëri më të gjërë të konfliktit, paqes dhe pajtimit. Është roli juaj si profesionistë/mësues/kujdestar për të njohur fëmijët me aktivitete të cilat i ndihmojnë ata të kuptojnë dhe përqafojnë pozitivisht diversitetin kulturor dhe pranimin e të tjerëve. Gjithashtu ne si profesionistë mund të sfidojmë stereotipet dhe paragjykimet dhe të inkurajojmë fëmijët e vegjël që të kenë një sërë mënyrash për të parë të shumëllojshmërinë. Kjo mund të ndodhë në situata të planifikuara si përshebull kur zbatojmë një aktivitet të programit. Por mund të ndodhë edhe në ndonjë situatë të pa planifikuar në rastet kur profesionistët krijojnë një mundësi të mësuarit për fëmijët.

Materialet e përdorura në këtë manual

Për të ndihmuar fëmijët të kuptojnë konceptet e prezantuara në këtë manual si dhe për të bërë aktivitetet sa më të gjallëruara, duhet të përdoren disa mjete dhe metoda të caktuara. Gjithashtu, ju mund të përdorni në sërë aktivitetesh dhe mënyrash kreative me të gjitha mjetet që keni rreth jush. *Thjeshtë jini kreativ!*

Kubi i ndjenjave

Duke përdorur kubin e ndjenjave, fëmijët janë në gjëndje të identifikojnë dhe të shprehin ndjenjat si dhe të zhvillojnë aftësi komunikimi për të shpjeguar si ndihen ata dhe si ndihen të tjerët, të respektojnë të tjerët dhe të mësojnë të përballen me ndjenjat dhe emocionet e tyre në jetën e tyre duke mos përdorur dhunën fizike ose verbale për t'u shprehur. Kjo ndihmon fëmijët të zhvillojnë mënyra më të mira për të shprehur veten. Është e rëndësishme të theksojmë se të gjitha ndjenjat janë të pranueshme dhe që secili prej nesh ka ndjenja të ndryshme. Është e rëndësishme t'i shprehim ato dhe të përballemi me to në mënyrë të shëndetshme!

Kartat e ndjenjave

Ashtu si një foto flet sa një mijë fjalë, ashtu dhe fytyrat tona mund të shprehin më shumë seç mund të imagjinojmë. Aftësia për të komunikuar emocionet delikate me një ngritje të thjeshtë vetull ose përdredhje e buzës mund të jetë e lindur.

Fëmijët e vegjël duhet të jenë në gjëndje të njohin emocionet në veten e tyre dhe në të tjerët dhe të kenë fjalët për të shprehur se si ata ose të tjerët janë ndjenja. Emocionet si i lumtur, i trishtuar, i zemëruar dhe të frikësuar janë një pikënisje.

Fëmijët e vegjël duhet të jenë në gjëndje të njohin ndjenjat e tyre dhe të të tjerëve si dhe të emërtojnë ato. Mund të fillohet me ndjenjat të tilla si: i/e kënaqur, mërzitur, inatosur dhe frikësuar.

Personazhet kukulla

Personazhet Kukullat përfaqësojnë karakterin e tyre individual, përvojat e tyre në jetë, çfarë u pëlqen dhe çfarë nuk u pëlqen. Çdo kukull ka një familje dhe një komunitet në të cilën jeton.

Personazhet kukulla u tregojnë fëmijëve përvojat e tyre të mira dhe ato jo të mira, si dhe mund të përdoren për të eksploruar bashkë me fëmijët shumë çështje. Kjo mund të bëhet midis të rriturve duke përdorur zërin e tyre.

Disa pika kyçe për t'u marrë në konsideratë kur prezantoni personazhet kukulla në qendrat e arsimit parashkollor.

- Personaliteti i kukullave duhet të reflektojë fëmijët e grupit;
- Në grupin ku fëmijët janë nga i njëjti grup etnik ose përfaqësojnë të njëjtën kulturë dhe nuk kanë aftësi të kufizuara etj, është e rëndësishme të prezantohen kukulla të cilat reflektojnë diversitetin;
- Sapo të caktohet karakteri kukullës, është e nevojshme të mbahet njësoj;
- Të rriturit duhet ti japin jetë kukullave;
- Kukullat bëhen miqtë e vegjël me të cilat fëmijët identifikohen;
- Kukullat dhe historitë e tyre janë mbështetje për fëmijën për të shprehur ndjenjat e tyre dhe në zgjidhjen e problemeve;
- Kukullat i ndihmojnë fëmijët të mendojnë mbi përvojat e tyre;
- Kukullat mund të ndihmojnë fëmijët të përballen me ankthin dhe frikërat;
- Është e rëndësishme të keni një përzierje të barabartë kukullash djem dhe vajza.

Fushat dhe çështjet që mund të eksplorojnë përmes kukullave/marionetave përfshijnë:

- Ndjenjat - inati, trishtimi, frika, lumturia
- Empatia
- Zgjidhja e problemeve
- Ç'mësimi parajudicial
- Respektimi i dallimeve dhe të tjerëve
- Dëgjimi i zërit të fëmijëve
- Diversiteti kulturor
- Të drejtat e fëmijëve
- Identiteti dhe përkatësia

Disa këshilla praktike për përdorimin e personazheve kukulla me fëmijët

- I rrituri vepron si folës i kukullave;
- I rrituri nuk është kukulla por flet në vend të kukullës;
- Flisni me zërin tuaj të zakonshëm;
- Tregojini fëmijëve që kukulla ka ardhur t'ju tregojë atyre një përvojë ose ndjesi të veçantë;
- Nxitini fëmijët të shtojnë;
- Lërin fëmijët të flasin më shumë;
- Roli i të rriturit është të lehtësojë bisedat;
- Dëgjoni më kujdes dhe në mënyrë aktive atë çfarë thotë fëmija

- Nëse është e nevojshme, mund të mbështesni fëmijët duke u drejtuar pyetje;
- Nxisni fëmijët të emërtojnë ndjenjat e qenit, të dëgjojnë njeri tjetrin, të mendojnë thellë dhe të shprehin mendimet e tyre;
- Biseda mbi ndjenjat dhe idetë është më e rëndësishme se sa gjetja e zgjidhjes
- Kur i jepni jetë kukullës, bëni një prezantim hyrës të shkurtër, ku jepni mjaftueshëm informacion dhe në mënyrë të kënaqshme
- Qellimi është të tërhiqni vëmendjen e fëmijëve në mënyrë që ata të shfaqin interes për atë çfarë i ka ndodhur kukullës
- Shpjegojini shkurtimisht fëmijëve se kukullat duan të bisedojnë për diçka me ta;
- Drejtoni pyetje udhëheqëse dhe përsëritni atë që po thonë fëmijët dhe vini re reagimet e tyre të cilët janë të prekur ose përjetojnë situatë të ngjashme me atë që po diskutohet;
- Ofroni mbështetje nëse nuk ndihen rehat;
- Mbyllja e historisë duhet të jetë e shkurtër dhe e thjeshtë;
- Jo gjithmonë mund të ketë një përfundim të lumtur;
- Thurni/Sajoni mbi fjalët që shtojnë fëmijët, veçanërisht mbi ato që përputhen me qëllimin e historisë – atë që ju doni që të mësojë fëmija nga historia

Blerja ose bërja vetë e personazheve kukullave

Personazhet kukulla dhe kukullat marioneta mund të blihen, megjithatë nëse të ardhurat janë problem, ju mund ti bëni vetë kukullat. Për shembull, në Kepin Perëndimor në Afrikën e Jugut, kukullat dhe rrobat e tyre bëhen nga gratë si pjesë e një projekti për nxjerrjen e të ardhurave për zhvillimin e zonave rurale. Ky projekt ka ndihmuar në zhvillimin e aftësive dhe ofrimin e të ardhurave në një zonë me nivel të lartë varfërie.

Bojërat me ngjyrën e lëkurës

Fëmijët zbulojnë se ngjyra e lëkurës sonë ka disa nuanca si dhe të analizohet rëndësia e tipareve fizike dhe tipareve të karakterit. Ata duhet të zbulojnë se edhe pse ngjyra e lëkurës dhe cilësi të tjera na bëjnë ne unikë, ne jemi të ngjashëm edhe në mënyra të tjera gjithashtu. Të gjithë kemi nevojë për dashuri, përkatësi dhe të trajtohem në mënyrë të drejtë. Duke përdorur bojërat me ngjyrën e lëkurës, fëmijët do të:

- Njohin që ngjyra e lëkurës tonë ka disa nuanca.
- Krahasojnë se në çfarë mënyre ngjajnë dhe dallojnë njëri-tjetrit.
- Diskutojnë sesi nuancat e ndryshme të ngjyrës sonë të lëkurës pasurojnë botën në të cilën jetojmë.
- Krijojnë dhe shfaqin në klasë një grup punimesh që tregojnë nuancat e ndryshme të ngjyrës së lëkurës që egziston në botë.

KAPITULLI 1

Gjithcka Rreth Meje: Identiteti dhe Përkatësia

HYRJE

Këndvështrimi i fëmijëve: Gjithësecili prej nesh është një “UNË”. Nuk ka asnjë tjetër të ngjashëm me ty. Ti jeni unik/e. Ti je i/e rëndësishëm/e. Ti ke një emër. Ti mund të ndjehesh ngrohtë dhe ftohtë, i/e lumtur dhe i/e mërzitur, disa herë je i/e uritur disa herë jo, disa herë je gjumash/e dhe disa herë je plot me energji. Por ti je gjithmonë ti. Dhe ti je shumë i/e veçantë

Këndvështrimi i të rriturve: Është e rëndësishme që në punën tonë me fëmijët e vegjël ne të konfirmojmë identitetin unik, personalitetin dhe interesat e çdo fëmije. Kjo është shumë e rëndësishme në zonat e prekura nga konflikti ku në disa raste familjet ndahen apo zhvendosen. Puna me grupe të mëdha fëmijësh mund të jetë sfiduese dhe për këtë arsye është e rëndësishme që gjatë aktiviteteve të përdoren një sërë metodash për t’i përfshirë ata një e nga një, dyshe apo në grupe të vogla dhe të mëdha. Gjithashtu është e rëndësishme që ambjenti ku do të luajnë dhe mësojnë fëmijët, të reflektojë identitetin dhe interesat më të mira të çdo fëmije.

Në mënyrë që puna jonë të shkojë mirë duhet që prezantimi i aktivitetit dhe i temave të tij të bëhet në mënyrë të thjeshtë, me dy apo tre rrjeshta sipas mënyrës më të përshtatshme për fëmijët.

Pyetje të mundshme për diskutim

- Ne të gjithë kemi një emër; a e di se përse të kanë vënë këtë emër? Kush ta ka vendosur/nga vjen?
- Çfarë ju pëlqen të bëni më shumë?
- Çfarë nuk ju pëlqen të bëni?
- Çfarë ju bën për të qeshur?
- Çfarë kafshësh pëlqeni?
- Keni motra/vëllezër?
- Çfarë ju pëlqen të hani?
- Kush është loja jote e preferuar?
- Kush është ngjyra jote e preferuar?

Aktivitetet

Diskutime/Gjuha/Aktivitete mbi Komunikimin

- Merrni një pasqyrë dhe vendoseni brenda një rrethi me fëmijë dhe kërkojini fëmijëve që të shohin pasqyrën dhe të thotë se çfarë shohin?

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve

Neni 7: Ti ke të drejtën të kesh një emër dhe kombësi

- Kërkojini fëmijëve që të bëjnë një fytyrë të lumtur... çfarë gjërash apo kush persona i bëjnë ata të ndjehen në këtë mënyrë?
- Kërkojini fëmijëve që të bëjnë një fytyrë të inatosur... çfarë gjërash apo kush persona i bëjnë ata të ndjehen në këtë mënyrë?
- Kërkojini fëmijëve që të bëjnë një fytyrë të habitur... çfarë gjërash apo kush persona i bëjnë ata të ndjehen në këtë mënyrë?
- Kërkojini fëmijëve që të bëjnë një fytyrë të frikësuar... çfarë gjërash apo kush persona i bëjnë ata të ndjehen në këtë mënyrë?
- Më tregoni një gjë që ju ka bërë të ndjeheni krenar/e dhe të fortë (flisni rreth përvojave pozitive kur fëmija ka mundur të zgjidhë një problem)
- Na tregoni diçka për familjen tuaj...(emrat e anëtarëve të familjes apo njerëzve me të cilët jeton fëmija)
- Bëni një listë fjalësh me të cilat fëmijët mund të emërtojnë pjesët e tyre të trupit ... fjalët duhet të jenë nga më të thjeshtat tek më të komplikuarat

Aktivitete Praktike

1. UNË E DI EMRIN TIM

Materialet që duhen:

- Personazhet kukulla,
- Letra të prera
- Ngjitëse letër,
- Letra të mëdha flipçart,
- Kuti këpucësh

HAPI 1:

1. Kërkojini fëmijëve të ulen në rreth dhe kërkojini atyre që u fillon emir me A të ngrihen në këmbë.
2. Kërkojini fëmijëve të mendojnë sende/objekte të tjera që fillojnë me gërmen "A". Mund ta filloni ju me një shembull: "aeroplan", "arra".
3. Kërkojini fëmijëve të vendosen dyshe dhe me ndihmën tuaj të formojnë gërmen A.
4. Ndërsa qëndrojnë të pozicionuar në formë A; ata duhet të thonë edhe emrat e tyre që fillojnë me A si: "A si Ana, Ardit, Arben".

Vazhdoni këtë lojë dhe me emra që fillojnë me gërma të tjera...

2. KUSH QUHET KËSHTU?

1. Thuajini fëmijëve se gjatë këtij aktiviteti ata do të mësojnë shkronjat që janë në emrin e tyre. Shkruani një shkronjë shtypi të madhe të emrit të fëmijës në secilën prej kutive të këpucëve. Pyesni fëmijët:
 - I kujt është ky emër?
 - Kush është shkronja e parë që shihni?
 - Si tingëllon/si shqiptohet kjo shkronjë?
2. Thuajini fëmijëve që të gjitha shkronjat e emrit tij/saj janë fshehur dhe se ata duhet t'i gjejnë. Tregojini atyre shtatë kutitë dhe shpjegojuni se çdo kuti ka një nga shkronjat e emrit tij/saj.
3. Shpjegojini se ata duhet të kontrollojnë për shkronjat dhe të vendosin secilën prej tyre në kutinë e duhur.
4. Jepuni atyre 5 minuta për të kontrolluar për shkronjat që janë të fshehura nëpër klasë/dhomë.
5. Pasi ata të kenë mbaruar me gjetjen e shkronjave, kërkojini që të ulen.
6. Lëri fëmijët që t'i tregojnë shokut/shoqes së tyre shkronjat e emrit tyre.
7. Me fëmijët më të rritur, ju mund t'i fshihni shkronjat e para të emrit të fëmijëve dhe t'i kërkonit atyre që t'i gjejnë.
8. Kërkojini atyre që të vendosin shkronjat e veçanta në Kutitë.
9. Kërkojini fëmijëve të bëjnë kuti me emrat e prindërve në shtëpi dhe ta sjellin në kopësht.

Bisedë me fëmijët:

1. Pyesni fëmijët:
 - Po sikur që të gjithë të quheshin _____ (përdorni një emër shumë të zakonshëm)? Çfarë mendoni se do të ndodhte?
2. Theksojini fëmijëve se është e rëndësishme që të dimë dhe të vlerësojmë emrin e gjithësecilit sepse përdoret për të thirrur/identifikuar ata.
3. Ose në mënyrë alternative, mund të përdorni një pyetje të thjeshtë:
 - Çfarë emri do t'ju pëlqente të kishit? Përse?
4. Shpjegojini fëmijëve se gjithësecili ka emra të ndryshëm. Nëse keni në grup dy fëmijë me të njëjtin emër, shpjegojini që mbiemri është ndryshe, që do të thotë se çdo fëmijë është unik në emrin që ka.
5. Kërkoni fëmijëve që të përmendin emrin e një personazhi vizatimor ose emrin e një shoku/shoqe apo personi të familjes që ata e duan shumë. Kjo do të ndihmojë për të treguar diversitetin e emrave ekzistues. Ju mund t'i kërkonit fëmijëve më të rritur se kush është shkronja e parë e emrit të tyre.

Tregimi i historive

- Lejoni fëmijën që të tregojë historinë e tij/saj (psh)...ata mund t'i sajojnë këto histori, mund t'i kenë dëgjuar nga prindërit, nga televizori, nga të tjerët...gjithçka bëhet sipas interpretimit të tyre
- Lejoni fëmijët të tregojë historinë e emrit të tyre

- Lejoni fëmijët që të përdorin kukulla për të treguar rreth përvojave të tyre apo për të treguar një histori
- Lejoni fëmijën që të tregojë se çfarë frutash/perimesh/ushqimi ai/ajo pëlqen dhe nuk pëlqen të hajë dhe se si ndjehet ai/ajo kur ha frutat/perimet/ushqimet e preferuara dhe ato jo të preferuara

Pyesni fëmijët nëse e dinë origjinën e emrit të tyre. Për më shumë, ata mund të pyesin prindërit ose të afërmit për historinë e emrit tyre. Përgatisni një shënim për t'ua dhënë prindëerve si më poshtë. Kështu, në ditën në vazhdim fëmijët mund të tregojnë historinë e emrit tyre.

Shënim për familjen e fëmijës

I dashur Prind _____,

Sot biseduam për emrat dhe kuptimin e tyre. Ne jemi kurioz të dimë edhe më shumë për origjinën e emrave tonë!

Të lutem, a mund të bisedosh më shumë me fëmijën për historinë dhe origjinën e emrit tij/saj dhe pse është zgjedhur ky emër?

Do bisedojmë më gjatë me fëmijët për këtë gjatë ditës së nesërme.

Faleminderit, _____

Aktivitete artistike

- Ndhimojini fëmijët të diskutojë dhe të emërtojë pikturën e tyre
- Vizatoni dhe/ose pikturoni veten tuaj
- Vizatoni dhe/ose pikturoni veten dhe familjen tuaj
- Vizatoni ose pikturoni veten në shtëpinë apo shkollën tënde, apo duke luajtur me të tjerët
- Vizatoni ose pikturoni frutat dhe perimet që ju pëlqeni dhe nuk pëlqeni
- Grupe të vogla fëmijësh mund të bëjnë një kolazh me miqtë e tyre apo fëmijët me të cilët jetojnë duke përshkruar dallimet dhe ngjashmëritë e tyre

Personazhet kukulla

Përdorini personazhet kukulla për të filluar bisedën me çdo fëmijë dhe bëjini ata që të ndajnë ndjenjat dhe përvojat e tyre dhe vendosini fëmijët që të bashkë veprojnë me kukullat dhe të ndajnë me të tjerët ndjenjat dhe përvojën e tyre

Lojrat krijuese

- Lërimi fëmijët që të luajnë me lojra spontane dhe vëzhgojini se si ai/ajo bashkëvepron me të tjerët (sillni një sërë rrobesh, materialesh dhe objektësh në mënyrë që fëmijët t'i përdorin dhe të ndërveprojnë më to)
- Mësuesi apo kujdestari prezanton një temë (çfarë do të bëhesh kur të rritesh?) dhe i fton fëmijët që të hartojnë dhe përfundojnë një histori (ndjenjat, situatat, ngjarjet, konfliktet, reagimet)

Kërcimi dhe muzika

- Kërkoji çdo fëmijë që të sjellë në klasë muzikën/këngën e tij/saj të preferuar të cilën mund ta këndojë dhe ta ndajë me të tjerët
- Çdo fëmijë krijon lëvizjet e tij/saj të kërcimit dhe i ndan me të tjerët

Lojrat

- Ndihamoni fëmijët që të dekorojnë dy çanta apo dy kuti. Njëra shërben për të mbajtur gjërat që ata nuk pëlqejnë dhe njëra për të mbajtur gjërat që nuk pëlqejnë (fëmijët janë të aftë të lëvizin gjërat para mbrapa, në varësi të asaj se si ndjehen rreth gjërave apo nëse shtojnë gjëra të reja gjatë kohës)
- Duke përdorur çorape të vjetra por të pastra, kopsa, lapsa dhjamor, pambuk, dhe gjëra të tjera, fëmijët mund të krijojnë kukulla apo personazhe të cilat mund të kthehen në mikun e tyre më të mirë dhe që ata kanë dëshirë të luajnë

Aktivitetet në natyrë

- Lejoni fëmijën të zgjedhë një nga një sërë aktivitete që bëhen në natyrë dhe që ai/ajo ka qejf t'a bëjë. Vëzhgoni sjelljen e tyre dhe se si bashkë veprojnë më të tjerët. Vëreni se si ndryshojnë ata kur janë brenda dhe kur janë jashtë...lërimi të bëjnë zgjedhje individuale

KAPITULLI 2

Ndenjat dhe Shprehja e Ndjenjave - Të ndihmojmë fëmijët të shprehin veten

HYRJE

Këndvështrimi i fëmijëve - Gjithkush ka ndjenja dhe emocione. Disa herë mund të ndjehesh i/e lumtur dhe disa herë i/e mërzitur. Disa herë mund të ndjehesh i/e frikësuar ose vetmuar dhe disa herë i/e inatosur. Është mëse normale që ju të keni ndjenja dhe emocione të ndryshme në kohë të ndryshme. Disa herë ne kemi nevojë të flasim me të tjerët rreth ndjenjave tona, si ndjehemi dhe pse ndjehemi ne atë mënyrë. Të flasësh për ndjenjat me dikë që të kupton, na ndihmon të ndjehemi më mirë.

Këndvështrimi i të rriturve - Fëmijët e vegjël varën shumë nga të rriturit të cilët mund të ndihmohen nga ata për të shprehur ndjenjat dhe emocionet e tyre. Fëmijët mund të kalojnë nga një përjetim ndjenjash në një përjetim tjetër dhe kanë vështirësi për të kuptuar dhe emëruar emocionet e tyre. Të rriturit luajnë një rol të madh në aftësinë e fëmijëve për të identifikuar, kuptuar dhe shprehur ndjenjat dhe emocionet e tyre në një mënyrë të shëndetshme. Fëmijët mësojnë të emërojnë shprehjen e ndjenjave të tyre duke patur modele pozitive nga të rriturit. Është e rëndësishme që të rriturit të shprehin emocionet e tyre në një mënyrë pozitive. Për shembull “kjo është frustuese, më duhet vetëm të marr frymë thellë dhe të filloj përsëri”. Është e rëndësishme që të kujtojmë se të flasësh rreth ndjenjave mund të jetë e vështirë. Ne gjithashtu duhet të jemi të ndërgjegjshëm dhe të kuptojmë ndjenjat tona për mënyrën se si mund të ndikohemi nga ndjenjat dhe përvojat e një fëmije, prindi apo anëtari tjetër staf. Është e rëndësishme që fëmijët të njohin gjuhën e trupit të të tjerëve duke e shoqëruar me ndjenjat e tyre. Fëmijët të cilët janë të aftë të shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre përballojnë më mirë konfliktet dhe problemet dhe janë të angazhuar në sjellje më pak destruktive në krahasim me fëmijët që nuk janë të aftë ta bëjnë këtë gjë. Gjithashtu ne duhet të jemi të aftë të menaxhojmë situatën në kohën e duhur dhe sidomos kur fëmijët flasin rreth përvojave të tyre. Përgjigja e kujdestarëve në situatat e vështira si inati dhe mërzitja, janë një model i rëndësishëm për fëmijët. Duke qënë se në situatë konflikti ekzistojnë emocionet e inatit dhe të frikës është e rëndësishme që këto shprehje emocionale të adresohen dhe të mbështeten në strategji për rregullimin e ndjenjave.

Pyetje të mundshme për diskutim

- A mund të mendoni për diçka që ju bën të lumtur?
- A mund të kujtoni një rast kur jeni ndjerë i/e mërzitur? (Njihni ndjenjat e fëmijëve "edhe mua kjo do të më bënte të mërzitesha")
- A mund të kujtoni një rast kur jeni ndjerë i/e frikësuar?
- A mund të mendoni një rast kur jeni ndjerë të inatosur?
- Çfarë mund të bëni kur ndjeheni i/e mërzitur/frikësuar/inatosur? (me kë mund të flisni?)

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve

Neni 12: Ti ke të drejtën të shprehësh mendimin tënd. Ti ke të drejtë të shprehësh çfarë mendon dhe ndjen dhe ke të drejtë të dëgjohesh

Neni 24: Ti ke të drejtë kesh kujdes shëndetësor të përshtatshëm për shëndetin tënd.

- A ka ndonjë person me të cilin mund të flisni kur ndjeheni i/e mërziur/frikësuar/inatosur
- Si e kuptoni kur shoku/shoqja/vëllai/motra juaj ndjehet i/e lumtur/mërziur/frikësuar/inatosur? (përshkruani gjuhën e trupit si psh. faqet e tij/saj skuqen dhe shtërngon duart, mendoj se ai/ajo ndjehet i inatosur)
- Si mund ta ndihmoni shokun/shoqen/vëllain/motrën tuaj kur kuptoni se ai/ajo ndjehet i/e mërziur/frikësuar/inatosur? (kjo është e rëndësishme pasi ndihmon fëmijët për të zhvilluar empatinë si dhe për të identifikuar mënyrat e tyre të përballimit)

Aktivitete që mund të bëhen në qendër

Diskutime/Gjuha/Aktivitetet mbi komunikimin

- Krijoni një rreth me fëmijët për të folur rreth ndjenjave të ndryshme
- Bëjini fëmijëve disa prej pyetjeve të mësipërme
- Ndjenja e lumturisë/mërzitjes/frikës/inatit etj
- Kjo gjë i ndihmon fëmijët të njohin gjuhën e trupit tek vetja e tyre dhe tek të tjerët të shoqëruar me ndjenja

Inkurajoni fëmijët që të zgjidhin problemet duke dhënë ide dhe zgjidhje që i ndihmojnë ata dhe të tjerët të ndjehen më mirë kur ndjehen të mërziur/frikësuar/inatosur etj.

Aktivitete praktike

6. MUND TË SHPREHEM ME TRUPIN TIM

Materialet:

- Kartat e ndjenjave ose personazhet kukulla,
- Kubi ndjenjave
- Instrumente muzikore,
- Top,
- Historia *Qyteti Ndjenjave*,
- Pjata plastike,
- Gërshërë,
- Ngjitës
- Lapsa me ngjyra,
- Revista te vjetra
- Fije,
- Litar
- Shkopinj,
- Ngjitës letër,
- Fletë të bardha (për aktivitete shtesë)

HAPI 1:

1. Filloni duke pyetur shkurtimisht fëmijët për “Byrekun më të pëlqyer të familjes”
2. Uluni me fëmijët në formë rrethi dhe tregojini atyre kartat e ndryshme me shprehjet e fytyrës.
3. Bisedoni së bashku me fëmijët për secilën prej kartave.
4. Praktikoni së bashku secilën prej mimikave/shprehjeve të fytyrës.
5. Tregojini fëmijëve që do luani lojën “Ngriva shkriva”. Shpregojini se do jetë loja. Kubi ndjenjave do u kalojë fëmijëve me radhë ndërkohë në sfond do luhet muzikë. Sapo të ndalojë muzika, do ndalojë dhe kalimi kubit të ndjenjave. Fëmija që mban kubin e ndjenjavë në momentin që ndalon muzika, duhet të bëjë shprehjen e fytyrës që tregohet në faqen e kubit të ndjenjave.
6. Përsërisni lojën derisa ta kenë provuar disa fëmijë dhe derisa të jenë përdorur një sërë kartash.
7. Tregoji që pas aktivitetit, të lexohet një histori *Qyteti Ndjenjave*, e cila flet për shumëllojshmërinë e ndjenjave/emocioneve që kemi.

HAPI 2:

1. Lexo historinë “*Qyteti i Ndjenjave*”, (Shtojca 1)
2. Pasi të keni lexuar për fëmijët “*Qyteti i Ndjenjave*”, bëjini atyre pyetjet që janë të përfshira në fund të tregimit. Mos harroni t’u thoni fëmijëve se sa normale është që të kesh ndjenja të ndryshme - frikë, mërzitje, turp, etj. Shpjegoni se të gjitha këto janë ndjenja normale dhe se është shumë e rëndësishme që t’i ndani ata me njerëz të tjerë.
3. Shpjegojini fëmijëve se ne mund të themi se çfarë ndjejnë njerëzit e tjerë vetëm duke parë situatën ose trupin e tyre, vecanërisht shprehjet e fytyrës së tyre. Gjithashtu ne mund të kuptojmë emocionet e të tjerëve ndërkohë që flasim me ta: si tingëllon zëri i tyre kur ata janë të mërzitur, të emocionuar, të inatosur ao të lumtur.
4. Kërkojini fëmijëve që të flasin me një shok/shoqe duke përdorur një ton zëri të lumtur, pastaj të mërzitur, të emocionuar, të inatosur dhe të frikësuar.
5. Nëse ata janë shumë të vegjël, atëherë kërkojini atyre që të bëjnë një fytyrë të lumtur, mërzitur, emocionuar apo të frikësuar.
6. Jepi çdo fëmije një pjatë letre (ose një karton të rrumbullakët) dhe tregojini se ata do të bëjnë Maskën e tyre të Ndjenjave.
7. Lërinia ata të mendojnë rreth ndjenjave që dëgjuan nga historia dhe kërkojini atyre që të zgjedhin se cilën nga ndjenjat do t’a bëjnë si maskën e tyre.

8. Ndhijojini ata që të presin formën e hundës, veshëve, dhe gojën nga figurat e revistave të vjetra. Një mënyrë tjetër është që fëmijët mund të vizatojnë direktë në pjatat e letrave fytyrat e tyre.
9. Nxisni fëmijët që të përdorin materialet që janë në dispozicion për pjesët e tjera të fytyrës (përshebull fijen e leshit për flokët).
10. Ndhijojini fëmijët që të bëjnë vrima tek pjata në vendin e syve.
11. Ngjisni dy shirita anash maskës në mënyrë që fëmijët ta veshin atë. Në mënyrë tjetër mund të jetë duke ngjitur në maskën prej letre një shkop në mënyrë që fëmijët ta mbajnë afër fytyrës së tyre.

Biseda me fëmijët:

1. Lejoni fëmijët një e nga një që të tregojnë maskat e tyre për pjesën tjetër të grupit.
2. Ndërkohë që çdo fëmijë tregon maskën e tij/saj, pyesni të tjerët:
 - Çfarë situatë mund të bëjë që ju të ndjeni të njëjtin emocion?
 Për shembull, për një fytyrë të inatosur pyesni:
 - “Çfarë situatë mund t’ju bëjë ju të keni një fytyrë të inatosur?”
 - A e keni ndjerë ndonjëherë këtë emocion? Kur?

Libërthi i ndjenjave:

Me fëmijë më të rritur, bëni një libërth ndjenjash. Shikoni në revista të vjetra për figura që tregojnë emocione të ndryshme, dhe pritini ato. Jepini nga një figurë çdo fëmijë dhe kërkojini që ta ngjisin atë në fletën e bardhë. Pyesni fëmijën: “Çfarë situatë mund t’ju bëjë ju që të ndjeni këtë emocion?” dhe shkruani përgjigjen e tij/ saj në fund të fletës. Plotësoni fletën e ndjenjave të gjithësecilit dhe lidhni ato sëbashku për të krijuar Libërthin e Ndjenjave.

Tregimi i historive

- Lexoni histori që kanë të bëjnë me ndjenjat dhe emocionet
- Përfshini histori që sygjerojnë se si mund të përballemi me ndjenjat
- Tregojini një histori fëmijëve kur ju jeni ndjerë të mërzitur/frikësuar/inatosur etj dhe si e keni përballuar
- Lejoni fëmijët që të tregojnë historitë kur janë ndjerë të mërzitur/frikësuar/inatosur etj, me kë kanë folur rreth këtyre ndjenjave etj
- Lejoni fëmijët të tregojnë një histori kur një shok/shoqe/vëlla/motër e tyre është ndjerë i mërzitur/frikësuar/inatosur dhe se farë kanë bërë për ta ndihmuar

Aktivitetet Artistike

- Jepu mundësi fëmijëve që të pikturojnë ose vizatojnë figura të gjërave që kanë bërë kur janë ndjerë të lumtur etj.
- Emëroni pikturat dhe vizatimet e fëmijëve sipas përshkrimit që ata po bëjnë me fjalët e tyre

- Lejoni fëmijët që nga revista të vjetra të presin figura të njerëzve që shprehin emocione të ndryshme. Këto figura mund të ngjiten në një fletë apo karton për të bërë një kolazh ndjenjash
- Fëmijët mund të përdorin pjata plastike dhe bishtat e lëpirëses për të bërë kukulla marioneta që shprehin ndjenja dhe emocione të ndryshme
- Fëmijët mund të pikturojnë dhe vizatojnë maska me emocione të ndryshme të cilat mund t'i përdorin për të treguar se si ndjehen. Gjithashtu loja me role rreth ndjenjave mund të ndihmojë fëmijët të shoqërojnë ndjenjat e tyre me situata të ndryshme si psh. dita e parë në kopësht; kur mami shkoi në spital; kur babi solli në shtëpi një qenush etj

Personazhet kukulla

- Përdroni kukullat dhe kukullat marioneta për të folur rreth ndjenjave dhe emocioneve
- Sot kukulla ndjehet e lumtur/mërzitur/frikësuar/inatosur etj
- Kushtojini vëmendje gjuhës trupore të kukullës
- Shpjegoni se përse kukulla ndjehet e lumtur/mërzitur etj
- Pysni fëmijët nëse edhe ata kanë patur një përvojë të tillë
- Ftoni fëmijët që të japin ide dhe zgjidhje se si mund të ndihmojnë kukullën që të ndjehet më mirë
- Kukulla u thotë fëmijëve se ndihmues ishin ata

Lojrat krijuese

- Krijoni një lojë me role të një skene në spital për t'i dhënë mundësi fëmijëve që të flasin rreth asaj që ndjejnë pacientët/doktorët/infermejeret dhe familjet
- Ndërtoni për fëmijët një kënd me kontekstin e një familje ku të tregohen situatat që e bëjnë një familje të lumtur dhe mbështetëse për njëri-tjetrin

Kërcimi dhe muzika

- Dëgjoni lloje të ndryshme muzike...të lehtë, ritmike, të gëzueshme, etj
- Disa lloj muzikash na bëjnë të lumtur/të gëzueshëm, na bën të kërcëjmë dhe të hidhemi
- Disa lloj muzikash na bëjnë të qetësohemi, të marrim gjërat shtruar, të pushojmë
- Këndoni këngë rreth ndjenjave dhe emocioneve si psh. "Kur jeni të lumtur përplasni duart"
- Lëroni fëmijët të kërcëjnë me tingujt të muzikës së qetë/të mërzitur dhe të shpejtë/të lumtur

Lojrat

- Përdorni kubin e ndjenjave në udhëzuesin praktik për të ndihmuar fëmijët që të emërojnë dhe njohin emocionet dhe ndjenjat.
- Kërkojini fëmijëve që të rrotullojnë kubin e ndjenjave dhe shihni se farë emocioni do të shfaqet.
- Hapini letrat e emocioneve dhe merrni kubin e ndjenjave dhe kërkojini fëmijëve që të gjejnë një fytyrë të lumtur/mërzitur/frikësuar/inatosur për ta vendosur tek kubi
- Bëni formuese (puzzle) me fytyra të lumtura/mërzitura dhe lëroni një fëmijë që të bëjë bashkë figura që përshkruajnë se ndjehet ai/ajo.

- Tregojini fëmijëve alternativa që mund të përdorin për të çliruar inatin e tyre dhe për të reduktur mundësinë e ndonjë konflikti të mundshëm. Thuajni fëmijëve që të marrin frymë thellë, të ngrajnë krahët e tyre sikur të ishin balona fluturuese. Pastaj kërkoji atyre që të nxjerrin ajrin dhe të ulen si balona të shfryra. Bëjini ata që ta përsërisin këtë proces disa here.

KAPITULLI 3

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve

Neni 29: Arsimimi duhet t'ju ndihmojë ju që të zhvilloni dhe të përdorni aftësitë tuaja. Gjithashtu duhet t'ju ndihmojë ju që të jetoni në paqe dhe të respektoni njerëzit e tjerë.

Unë dhe të Tjerët – Të njohësh nevojat e të tjerëve

HYRJE

Këndvështrimi i Fëmijëve - Të flasësh dhe të bësh gjëra me miqtë e tu, me vëllezërit dhe motrat si dhe me fëmijët e tjerë mund të jetë shumë argëtuese. Është shumë mirë kur njerëzit shkojnë mirë dhe ndihmojnë njëri-tjetrin....na bën të ndjehemi të lumtur.

Këndvështrimi i të Rriturve - Ndërgjegjësimi për nevojat e të tjerëve – Fëmijët kanë nevojë që të zhvillojnë kapacitetin e tyre për të krijuar marrëdhënie dhe për të ndërvepruar me të tjerët. Ata kanë nevojë të ndërtojnë marrëdhënie miqësie, të shkojnë mirë me njëri-tjetrin dhe të kënaqen me lojrat e tyre krijuese dhe duke luajtur në një pjesë drame bashkë me fëmijët e tjerë. Mbështetja e zhvillimit social është një nga punët më të rëndësishme që kemi ne si të rritur, dhe një nga mënyrat më të mira për të mbështetur zhvillimin social është duke treguar aftësi të mira sociale, jo vetëm drejt të rriturve të tjerë por edhe drejt fëmijëve. Fëmijët kanë nevojë të ndjehen të dëgjuar, të vlerësuar, të respektuar dhe të pranuar. Zotërimi i aftësive të mira sociale ndihmon një fëmijë që të ketë sukses në jetë. Një fëmijë me aftësi të mira sociale shkon mirë me bashkëmohatarët dhe zhvillon ndjenjën e ndjeshmërisë për nevojat e të tjerëve. Rregulli i artë është: trajtoi të tjerët ashtu siç do të doje të të trajtonin ty. Fëmijët me aftësi të mira sociale kanë gjasa më të mëdha për t'u bërë të rritur me një përgjegjësi më të madhe sociale që i japin rëndësi të drejtave të njerëzve.

Pyetje të mundshme për diskutim

- Çfarë gjërash bëni me miqtë tuaj që ju bëjnë të ndjeheni të lumtur?
- A mund të na tregoni për ndonjë rast kur miqtë tuaj ju kanë ndihmuar për të bërë diçka?
- Si u ndjetë pas kësaj mbështetje që morët?
- A mund të na tregoni për ndonjë rast kur ju keni ndihmuar një shok/shoqe për të bërë diçka?
- Si u ndje shoku/shoqja jote pas mbështetjes që ju i dhatë?
- Si u ndjetë ju kur ndihmuat shokun/shoqen tuaj?
- A jeni lënduar ndonjëherë nga dikush?
- Si u ndjetë?
- Kush është loja juaj e preferuar?
- A keni miq që pëlqejnë lojra të ndryshme?
- Kush është sporti juaj i preferuar?
- A keni miq që pëlqejnë sporte të ndryshme?

1. KËTA JANË NJERËZIT E RËNDËSISHËM NË JËTËN TIME

Materialet e Nevojshme:

- Ngjitës lëng/shirit
- Fletë të bardha të prera në formë rrethore të vogla
- Stilolapsa dhe lapsa me ngjyra
- Kartona
- Shkopa të vegjël druri (shkopa lëpirësesh)

HAPI 1:

1. Ftoni fëmijët që të dalin jashtë dhe kërkonin që secili prej tyre të mbledhë dy degë të mëdha peme dhe dy degë të vogla. (Nëse kjo nuk është e mundur, shpërndani disa degë ose shkopinjtë që ju i keni mbledhur më parë).
2. Kurtë ktheheni në klasë, jepi çdo fëmijë nga një copë kartoni dhe kërkojini atyre që të bëjnë një kornizë fotografie duke përdorur degët e mbledhura duke vendosur dy degët e shkurtra në pozicionin vertikal dhe dy degët e gjata në pozicionin horizontal ndërmejt atyre të shkurtrave për të bërë një formë drejtkëndëshe.
3. Pasi ata të kenë vendosur degët në pozicionin e duhur, kërkoji fëmijëve që të ngjisin degët aty ku janë mbi karton.
4. Thuajini fëmijëve se korniza e tyre e fotografisë do të mbajë fotografitë e personave të veçantë që ata kanë.

HAPI 2:

1. Pyesni fëmijët:
 - Kush janë njerëzit më të veçantë në jetën tuaj? Përse janë ato kaq të veçantë?
 - Çfarë bëni ju për t'i treguar atyre se ata janë shumë të veçantë për ju?
 - Çfarë gjëje që ju pëlqen bëni ju me ata?
2. Shpjegojini fëmijëve se kur njerëzit e duan njëri-tjetrin, është shumë e rëndësishme që të:
 - Të bëni shumë gjëra të këndshme për njëri-tjetrin.
 - Ti themi njëri-tjetrit se sa e duam njëri-tjetrin.
 - Të tregojmë dashurinë tonë nëpërmjet gjërave që ne bëjmë.
3. Pyesni fëmijët:
 - A ka bërë ndonjë person për ju diçka që ju e keni përzemër? Për shembull, ju ka përqaftuar, ju ka falenderuar për diçka, apo ju ka ftuar që të bëni diçka të veçantë?
 - Çfarë bëni ju për t'i treguar njerëzve që ju i doni ata?
4. Për fëmijë më të vegjël, është më mirë të fokusoni diksutimin më shumë në atë se çfarë pëlqejnë të bëjnë ata me njerëzit që janë afër tyre. Për fëmijët më të rritur, ju mund të fokusoheni më shumë në atë se çfarëna ofron familja jonë ne, dhe se si çdo anëtar i familjes ndihmon në punët dhe nevojat e familjes, siç është ushqimi, strehimi, veshmbathja, kujdesi për njëri-tjetrin etj.
5. Jepini fëmijëve disa nga rrethët e përgatitur dhe kërkojini atyre që të vizatojnë në rreth fytyrat e njerëzve më të rëndësishëm për ata.
6. Pasi të kenë mbaruar së vizatuari njerëzit e tyre të rëndësishëm në rreth, shpërndani shkopat (e lëpirseve) në mënyrë që çdo fytyrë të ketë një shkop.

7. Bëni ose ndihmoni fëmijët që të ngjisin shkopat ose t'i lidhin ata pas vizatimeve të tyre dhe të shkruajnë mbrapa emrin e tyre.

Pyetje për reflektim:

1. Kërkojini fëmijëve që të ulen në një rreth.
2. Këndoni këngën, "Ku është?" Filloni me emrin e një fëmije.
3. Më pas, filloni, 'Ku është...', dhe kërkojini një fëmije që të thërrasë dikë në emër që është i rëndësishëm për atë. Përsëriteni këtë me fëmijët e tjerë. Kur të mbarojë kënga kërkojini atyre që të ngjisin në kornizën e fotos që bënë, vizatimet e Njerëzve të rëndësishëm për ata. Përsëriteni këngën në mënyrë që edhe fëmijët e tjerë të kenë mundësi të emrin e një personi të rëndësishëm për atë.
4. Kërkojini fëmijëve që të vendosin kornizën e vizatimit të tyre në Kutit apo dosjen e tyre (Cdo fëmije duhet të ketë dosjen e tij/saj në kopësht).

AKTIVITET NË FAMILJE:

Dërgojini prindërve një shënim për t'i kërkuar atyre që t'i tregojnë fëmijëve të tyre rreth diçkaje të rëndësishme që e kanë patur kur kanë qënë fëmijë. Përdorni modelin e mëposhtëm:

I/E dashur _____

Sot ne kemi biseduar rreth njerëzve të rëndësishëm në jetën e fëmijëve.

Për të ndihmuar fëmijën tuaj që të mësojë më shumë rreth kësaj gjëje, tregoni atij/asaj një foto ose një pjesë/copë ose një rrobë/lodër që ju e keni patur kur keni qënë fëmijë.

A mund t'ja jepni fëmijës tuaj këtë send/foto për t'a sjellë në orën e ardhshme mësimore? Do të ishte diçka e bukur që ai/ajo t'ja tregojë fëmijëve të tjerë dhe t'u shpjegojë atyre se përse kjo gjë është e rëndësishme për ju kur ishit fëmijë.

Në rast të kundërt, nëse ju nuk keni dëshirë që t'ia jepni fëmijës tuaj sendin/foton për ta sjellë në kopësht/shkollë, ju mund ta vizatoni atë bashkë me fëmijën tuaj.

Kujtojini fëmijës tuaj që ta sjellë në sesion e ardhshëm. Ne do të flasim rreth kësaj gjëje bashkë me fëmijët e tjerë!

Me konsideratë, _____

2. FOSH NJA NË DJEP

Materialet e Nevojshme:

- Vizatimi i një fytyre të qeshur
- vizatimi i një fytyre të mërzhitur
- Shkumës
- Historia: Foshnja në Djep (Shtojca 3)
- Një bebe kukull
- Djep/mbajtëse fëmijësh
- Copa rrobesh të prera më parë

- Ngjitës lëng
- Letër (për aktivitete shitesë)
- Lapsa me ngjyra

HAPI 1:

1. Para se të filloni aktivitetin e ri, kërkojini fëmijëve që të prezantojnë gjërat që i kanë dhënë prindërit e tyre në fund të aktivitetit të shkuar.
2. Kërkojini fëmijëve që të përmendin gjëra që dinë rreth bebeve/foshnjeve.
3. Eksploroni dijen e tyre më tej duke bërë pyetje të tilla si:
 - Çfarë bëjnë bebet?
 - Për çfarë kanë nevojë bebet?
 - A mund të jetojnë vetëm bebet?
 -

AKTIVITETI:

1. Lexoni historinë, “Foshnja në Djep”. Ndërkohë që lexoni, kërkojini fëmijëve që të imitojnë tingujt e kafshëve të përmendur në tregim dhe të imitojnë lëvizjet e tyre duke ndjekur shembujt tuaj.
2. Pasi të mbaroni së lëxuari, pyesni fëmijët:
 - Për çfarë bënte fjalë tregimi?
 - Kush ishin kafshët që donin që bebi të bëhej fëmija i tyre?
 - Përse ishte e pamundur që ata të kujdeseshin për foshnjen e vogël?
 - Për çfarë gjërash kishte nevojë bebi?
3. Vizatoni një vizë në dysheme. Vizatoni në një rën anë të vizës një fytyrë të qeshur dhe në anën tjetër vizatoni një fytyrë të mërzhitur. Shpjegoni fëmijëve se ju do të thoni disa fjali dhe nëse ajo që thoni është e vërtetë, ata duhet të shkojnë tek fytyra e qeshur, nëse fjalia është gabuar ata duhet të shkojnë tek fytyra e mërzhitur. Nëse është e mundur kërkojini fëmijëve që të hidhen si bretkosat për të arritur tek vëndi/fytyra ku duan të shkojnë. i pari që arrin tek vëndi duhet t’i shpjegojë fëmijëve të tjerë se përse ai/ajo mendon se fjalia që ju keni thënë është e drejtë/gabuar.
4. Thoni fjalitë e mëposhtme një e nga një:
 - Bebet kanë nevojë për qumësht.
 - Bebet kanë nevojë për lëngje.
 - Bebet kanë nevojë për çokollatë.
 - Bebet kanë nevojë që prindërit të kujdesen për ta.
 - Bebet mund të flenë në rrugë.
 - Të gjithë fëmijët duhet të marrin atë që marrin bebet.
5. Kujtojini fëmijëve se çdo fëmijë ka nevojë të ketë një familje për t’u kujdesur për ta dhe për t’u dhënë dashuri.

Pyetje për Diskutim:

Bëni me dije fëmijët se ata do të bëjnë një jorgan për klasën si pjesë e një projekti arti.

Kërkojini çdo fëmije që të marrin nga një copë të prerë më parë.

Kërkojini atyre që t’i ngjisin në një fletë të madhe për të bërë jorganin e tyre.

Sigurohuni që jorgani është tharë plotësisht para se të lejoni fëmijët që të luajnë me të.

Lërinia ata të bëjnë sikur janë prindërit e kukullës bebe. Pyesni fëmijët:

Si do të kujdeseni për beben/foshnjën?

Lejoni fëmijët që të përdorin jorganin, kukullën bebe dhe djepin.

Përsërsini mesazhin kyç që të gjithë fëmijët meritojnë të kenë një familje e cila mund t'i japë atyre një shtëpi të mirë, të kujdesen për nevojat e tyre dhe t'i japin atyre dashuri dhe vëmendje. Gjithashtu përforconi idenë se është e rëndësishme për çdo jeri në familje që të ndihmojë dhe mbështesë njëri-tjetrin.

AKTIVITET SHITESË

Kërkojini fëmijë që të bëjnë një libërth “Një ditë me Familjen Time” (shikoni shembullin e mëposhtëm). Theksoni përdorimin e kohëve, si psh. “Në mëngjes unë...”. Kërkojini atyre që të vizatojnë gjëra të ndryshme që bëjnë gjatë ditës. Pasi të kenë mbaruar, kërkojini që të shkruajnë emrin e tyre pas libërthit dhe t'a vendosin në Kutinë apo Dosjen e tyre.

NJË DITË ME FAMILJEN TIME

Vizatuar nga _____

Në mëngjes unë,me familjen time.

Pasditë, unëme familjen time.

Në darkë, unë.....me familjen time.

Si aktivitetet tjetër ju mund të ndani klasën në tre grupe dhe kërkojini cdo grupi që të përformojnë një pjesë të ditës së tyre me familjet e tyre.

AKTIVITET NË FAMILJE

Kërkojini prindërve që të bëjnë “Jorganin e Familjes” Përdorni modelin e letrës informuese për prindërit.

I/E dashur _____

Sot ne folëm përsëri për familjen dhe mësuam të vlerësojmë rolin e çdo anëtari në familje.

Ju mund të ndihmoni fëmijën tuaj që të kuptojë më shumë duke ndihmuar atë që të bëjë “Jorganin e Familjes” duke përdorur rrobe nga çdo anëtar i familjes. Filloni duke kërkuar për rroba që janë të vjetra dhe që mund t’i prisni.

Ja si mund të bëni sëbashku “Jorganin e Familjes”

- Prisni rrobat në formë katrore, 10 cm X10 cm.
- Qepini bashkë copat e rrobeve për të bërë jorganin të madh drejtëkëndësh.
- Kërkojini anëtarëve të familjes më të madhe apo miqve për rroba të cilat ata nuk i dua më, nëse doni t’a bëni jorganin më të madh.

Kujtoni fëmijën tuaj që ta sjellë në klasë për orën e ardhshme mësimore!

Me konsideratë, _____

Pasi të mbaroni me “Jorganin e Familjes” mund t’ja tregoni klasës.

3. UNË DHE FAMILJE JEMI TË LUMTUR SË BASHKU

Materialet e Nevojshme:

- Lapsa me ngjyra
- Fletë të pastra (një fletë për çdo fëmijë)

HAPI 1:

Kujtojini se sa e rëndësishme është që të ndani emocionet me miqtë dhe familjen, kur ju jeni i/e lumtur apo mërziur. Përforconi edhe rëndësinë që në të kuptojmë nëse familjarët apo miqtë tanë janë të lumtur apo të mërziur apo për mënyrën se si ndjehen.

1. Tregoni kartat e Emocionove ose Kukullat Personazhe dhe kërkojini fëmijëve që të kujtojnë emocionet e ndryshme që shfaqen.
2. Kërkojini fëmijëve që të ulen në një rreth dhe jepini çdo fëmije nga një kartë emocioni Kërkojini fëmijëve që mos të tregojnë kartën e emocioneve tek fëmijët e tjerë.
3. Me rradhë, kërkoji çdo fëmije që të imitojnë për fëmijën që është ulur në krahun e tij/saj të djathtë, emocionin e treguar në kartën e tij/saj. Kërkojini fëmijës që të zbulojë se çfarë emocioni po imiton shoku i tij/saj. Pasi ta ketë gjetur, kërkojini fëmijës që të ripërsërisë procesin me fëmijën në krahun etij/saj të djathtë.

HAPI 2:

1. Bëni me dije fëmijët se edhe anëtarët e tjerë të familjes onë ndjejnë emocione të ndryshme. Përshembull, ndonjëherë kur ata vijnë në shtëpi pas pune, familjarët mund të jenë të lodhur ose të mërzitur. Ndonjëherë ata janë të lumtur sepse diçka e këndshme u ka ndodhur atë ditë.
2. Thuajini fëmijëve se ju do të formuloni disa fjali rreth diçkaje që mund t'i ndodhë një anëtar të familjes. Pas çdo fjalie, kërkojini fëmijëve që të tregojnë se si mund të ndjehet ai person, duke bërë një fytyrë të ngjashme:
 - Mamaja pa një pjatë të thyer.
 - Vëllai ka një lodër të re.
 - Motra ka harruar se ku e ka lënë kukullën e saj.
 - Babai erdhi i lodhur nga puna
 - Gjyshja është sëmurë dhe është shtrirë në krevat
3. Nëse aktiviteti duket se është i vështirë për fëmijët e vegjël, ju mund të fokusoheni vetëm tek emocionet e lumtura dhe të mërzitura, dhe në vënd që t'i kërkon të tregojnë emoionet e tyre, kërkojini fëmijëve që të thonë vetëm se si mund të ndjehen.

Pyetje për dikutim:

1. Jepi çdo fëmije një copë letër dhe lapsa me ngjyra dhe kërkojini atyre që të vizatojnë atë që mund t'a bëjë të lumtur atë apo një anëtar tjetër të familjes së tij/saj.
2. Shpjegoni se si gjërat që ne bëjmë, ndikojnë të tjerët dhe gjërat që të tjerët bëjnë ndokojnë tek ne. Kjo do të thotë se ne mund t'i bëjmë njerëzit të lumtur me veprimet tona por gjithashtu ne mund t'i bëjmë ata të ndjehen të mërzitur apo të inatosur.
3. Sigurohuni që ata të shkruajnë emrat e tyre në vizatime dhe kërkojini që t'i vendosin ato në Kutinë apo Dosjen e tyre.

AKTIVITET SHITESË

Me fëmijë më të rritur, kërkoji atyre që të sjellin shembuj të gjërave që ata kanë bërë dhe i ka bërë njerëzit të ndjehen të mërzitur apo të inatosur. Pyesni ata:

- Si u ndjetë?
- Si u ndjenë familjarët nga veprimet e tua?
- Si e zgjidhët?

Këto pyetje mund të hapin një dialog të madh, dhe për këtë arsye është mirë që t'i dëgjoni me kujdes ata dhe të jeni të vetëdijshëm për mirëqënien Zhvillimi Emocional të fëmijës.

Diskutime/Gjuha/Aktivitete mbi Komunikimin

- Merrni me vete një sërë llojesh këpucësh për aktivitetin e fëmijëve në rreth. Kërkojini fëmijëve të mendojnë se si ndjehen nëse do të ishin personi që do të vishte këto këpucë.
- Përdorni një pasqyrë ku ata mund të shohin veten e tyre dhe të tjerët dhe sëbashku diskutoni për dallimet dhe ngjashmëritë

- Gjërat që duam të bëjmë vetëm si psh. vizatimi i një pikturë dhe gjërat që duam të bëjmë me të tjerët si psh. të luaj lojra të ndryshme me top

Tregim i historive

- Nxisni fëmijët të tregojnë historitë e rreth vetes dhe të tjerëve – nxitini ata të thonë mendimet dhe këndvështrimet e tyre
- Zgjidhni histori nga burime të tjera rreth miqve, si të shkojnë mirë me njëri-tjetrin; të qënurit ndihmues; pëlqimi për gjëra të ndryshme; situatat lënduese etj.
- Përdorimi i kukullave dhe kukullave marionetave për të treguar histori rreth historive që kanë brënda sjellje ndihmuese dhe lënduese

Aktivitetet Artistike

- Bëni kartolina për miqtë ose anëtarët e familjes për të treguar se ju kujdeseni për ta
- Vizatoni piktura të gjëravë që mund të bëjnë miqtë sëbashku
- Vizatoni piktura të gjërave që ju bëjnë të ndjeheni të lumtur
- Inkurajoni grupe të vogla fëmijësh që të punojnë sëbashku për të bërë një kolazh

Personazhet kukulla

- Përdorni kukullat për të folur rreth gjërave që ata pëlqejnë/nuk pëlqejnë
- Përdorni kukullat për të treguar histori rreth ndjenjave të shoqëruara me të ndjerit i/e përfshirë/përfshatuar në një situatë loje
- Përdorni kukullat për të treguar situata rreth sjelleve ndihmuese

Lojrat krijuese

- Bëni një kolazh me një grup fëmijësh për të treguar se si secili prej tyre mund të japë kontributin e tij/saj dhe si mund të punojnë sëbashku
- Ndërtoni vënde ku mund të luhet, si psh. në shtëpi/spital për t'u dhënë mundësi fëmijëve që të provojnë se çfarë ndjen nëse je dikush tjetër – mami, babi, bebja, infermierja, doktori, pacienti etj.
- Bëni një pemë me duar duke përdorur shenjat e duarve në vënd të gjetheve dhe tek gjethet ngjisni figura që tregojnë raste kur njerezit kane ndihmuar dikë ose shkruani mesazhe të sjelleve ndihmuese.
- Sillni ose kërkoni fëmijëve që të sjellin lloje të ndryshme frutash/perimesh dhe pastaj ndihmoini ata që të bëjnë një sallatë frutash apo perimesh (ose të dyja bashkë) dhe ndërkohë diskutoni se kur jemi vetëm ne mund të kemi vetëm një gjë ndërsa kur jemi bashkë mund të kemi shumë gjëra

- Bëni një kornizë pasqyrë me letër apo me ndonjë material tjetër. Më pas kërkojini fëmijëve që të qëndrojnë nga të dyja anët e “pasqyrës”. Njëri prej fëmijëve duhet të bëjë një fytyrë të lumtur/mërzitur/inatosur/frikësuar dhe fëmija tjetër nga ana tjetër e “pasqyrës” të imitojë atë çfarë ai/ajo sheh në “pasqyrë”. Fëmijëve të tjerë u kërkohet që të komentojnë ngjashmëritë/dallimet midis fëmijëve që po aktrojnë kur ata janë të lumtur, mërzitur/inatosur dhe frikësuar

Kërcimi dhe muzika

- Kërceni me ritme të ndryshme muzikore
- Kërceni vetëm, më pas me një partner/e dhe më pas në grup
- Lëri fëmijët që të zgjedhin muzikën e tyre të preferuar dhe bëni krahasime pozitive rreth llojeve të ndryshme të muzikës që kanë zgjedhur fëmijët

Lojrat

- Luani lojra që duan një partner/e. Partneriteti I ndihmon fëmijët që të fillojnë të zhvillojnë ndërgjegjësimin mbi të tjerët, nevojat dhe perspektivat e tyre
- Dy fëmijë mund të krijojnë një varkë ndërkohë që këndojnë një këngë “vozt, vozit, vozit varkën tënde.” Uluni fëmijët në dysheme ballë për ball njëri-tjetrit, vendosini këmbët e tyre bashkë, mbani duart dhe pastaj shkoni sa para-mbrapa dhe këndon
- Luani lojra në skuadra të vogla si psh. duke kaluar topin nga koka e një fëmije tek koka e një fëmije tjetër; hidhjani topin çdo fëmije dhe thirreni ne emër

Aktivitetet në natyrë

- Çfarë ndodh nëse një njeri rrëzohet dhe vritet ose ka frikë të ngjitet? Si mund ta ndihmojmë ne atë person?

KAPITULLI 4

Ne të gjithë jemi të ndryshëm – Të respektojmë Diversitetin

HYRJE

Me Fokus tek Fëmija - Shikoni përreth jush...çfarë shikoni? Disa prej nesh kanë flokë të gjatë...disa kanë flokë të shkurtër, disa kanë sy me ngjyrë blu, disa po buzëqeshin dhe disa jo. Ne disa gjëra i bëjnë njësoj...ushqehemi, qeshim, flemë. Disa gjëra ne i bëjmë ndryshe... mund të flasim gjuhë të ndryshme ose mund të jemi të ndryshëm në mënyra të ndryshme.

Disa herë fëmijët mund të ndjehen të lënë pas dore nëse ndjehen ndryshe nga të tjerët. Ndonjëherë fëmijët mund të ndihen të lënë pas dore, nëse ata janë të ndryshëm në një farë mënyre. Kjo e bën fëmijën të ndjehet i/e trishtuar. Por ne jemi të gjithë të ndryshëm dhe kjo është ajo që e bën botën. Ne mund të kemi flokë, sy, ngjyrë lëkure të ndryshme, por ne mund të dëshirojmë apo pëlqejmë të bëjmë të njëjtat gjëra të tilla si të notojmë, të luajmë apo të pikturojmë. Edhe pse jemi të ndryshëm, çdo fëmijë është i/e veçantë dhe i/e rëndësishëm.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës:

Neni 2: Ti ke të drejtë të trajtohesh në mënyrë të drejtë dhe të barabartë pavarësisht se kush je, ku jeton, çfarë race apo feje ke apo nëse je vajze apo djalë.

Me Fokus tek i Rrituri - Që në moshë të vogël, fëmijët përjetojnë dhe përpiqen ti japin kuptim dallimeve brenda komuniteteve. Hulumtimet tregojnë se mes moshës dy dhe pesë vjeç, fëmijët bëhen të vetëdijshëm dhe kurioz rreth gjinisë, racës, etnisë dhe aftësisë së kufizuar. Gradualisht fëmijët fillojnë të kuptojnë (se çfarë të përbashkëtash dhe ndryshimesh kanë) si ata janë të njëjtë dhe se si janë të ndryshëm nga njerëzit e tjerë dhe se si ndihen ata për ato dallime. Në mënyrë që të zhvillojmë ndjeshmërinë, të rriturit duhet së pari të inkurajojnë fëmijën që të identifikojë ngjashmëritë dhe interesat e përbashkëta. Për shembull, çfarë aktiviteti kanë dëshitë të bëjnë fëmijët në kopësht apo në shtëpi përpara se të flisni me ata rreth dallimeve. Një shembull mund të jetë diskutimi rreth festave të ndryshme, llojeve të ndryshme të ushqimit apo veshjeve.

Kur punojmë me fëmijët e vegjël është e nevojshme të përdorim një qasje e cila adreson respektimin e dallimeve për të sfiduar paragjykimet, stereotipet dhe paragjykimet. Të rriturit luajnë një rol jetik për të ndihmuar fëmijët e vegjël të zhvillojnë qëndrime pozitive në ndryshim.

Disa shembuj pyetjesh që mund të përdoren për diskutim:

- Cfarë ngjyre janë flokët e tu?
- Ti ke flokë të shkurtër apo të gjatë?
- Sa fëmijë në grupin tonë kanë flokë të zinj, bjond, kafë apo të kuq?
- Sa fëmijë kanë flokë të shkurtër? Po të gjatë?
- Cfarë ngjyre i këni sytë?
- Sa i/e gjatë je?
- Si është ngjyra jote e lëkurës, është ngjyrë e hapur apo e errët?
- A ka lekura juaj nishane apo pika?
- A keni motra apo vëllezër?
- A ju pëlqen të luani lojra me top?
- Cfarë lojrash me top keni qejf më shumë?
- Cfarë bëni kur nuk jeni në kopësht?
- A ka ndonjë gjë që ju keni qejf të bëni por shoqja apo shoku juaj nuk ka qejf?

Aktivitetet

Aktivitete rreth Diskutimeve/Gjuhës/Komunikimit

- Bëju fëmijëve disa prej pyetjeve të mësipërme dhe shto pyetje të tjera që kanë lidhje me dallimet në komunitetin tuaj dhe dallimet në botë.
- Përdorni metodën e rrethit të kohës për të folur rreth ngjashmërive dhe dallimeve.
- Thuja “Si jeni?” në gjuhë të ndryshme
- Kërkoni fëmijëve që të sjellin foto të familjeve të tyre dhe të flasin pozitivisht për të gjitha familjet dhe familjet e ndryshme
- Kërkoni fëmijëve që të përshkruajnë se sa të ndryshme janë festivalet apo pushimet që organizohen nga ana kulturore/tradicionale/familjare, dhe se çfarë bëjnë fëmijët me të rriturit me të cilët jetojnë gjatë këtyre aktiviteteve

Aktivitete Praktike

1. **Unë dhe Miqtë e Mi - Ndhimojmë njëri-tjetrin ZINXHIRI MIQËSISË**

Materialet e Nevojshme:

- Lapsa
- Gjashtë postera
- Shkumës
- Shirita letrash, (7.5 x 2.5 cm, një për çdo fëmijë)
- Shirit ngjitës
- Fletë e bardhë (një për çdo fëmijë)

Para këtij aktiviteti, vendosni gjashtë posterat në vende të ndryshme në dyshe. Vizatoni një vizë ndërmjet posterave dhe vendosni një vizë “Fundit” pas posterit të fundit. Nëse keni oborr ose hapsirë të sigurtë jashtë kopështit, atëherë ju mund të bëni aktivitetin e “Fillimit” jashtë.

HAPI 1:

1. Kërkoni fëmijëve që të bëhen çift me njëri-tjetrin. Kërkoni çdo fëmijë që të kapet nga krahu me shokun/shoqen që ka në krah. Shpjegoni se ata duhet të kërcëjnë për të shkuar nga një poster në një poster tjetër. Me fëmijë më të rritur, ju mund t’i kërkoni çdo çifti që të ndalojë sa herë që arrijnë vizatimin/posterin dhe të thonë me zë të lartë një gjë që ai/ajo ka dëshirë ta bëjë me miqtë (psh. të qeshë, të luajë, të këndojë, etj).
2. Pasi të gjithë të kenë arritur në vizën me shkrimin “Fundit”, kërkoni fëmijëve që të ulen në një rreth dhe pyesni:
 - Ishte e lehtë apo e vështirë që të arrije në vizën Përfundimtare?
 - A mendoni se do të ishte më e lehtë apo më e vështirë për të arritur vizën e Fundit nëse shoku/shoqja juaj nuk do të kishte kërcyer bashkë me ju? Përse?

2. Aktivite në Grup: Njohja e Dallimeve

Për të realizuar këtë aktivitet, kërkojini fëmijëve që të sjellin një foto të familjes së tyre nga shtëpia.

Gjatë aktivitetit të gjithë fëmijët do të marrin foton e familjes së tyre në dorë dhe do të prezantojnë të anëtarët e familjes një e nga një. *Psh: Eni jeton me 3 motrat e saj dhe vëllain, me mamin dhe me dy gjyshërit e saj. Ajo është shumë e lumtur që ka një familje të madhe. Një rast tjetër mund të jetë Land i cili jeton vetëm me babain/mamin e tij.*

Në fund të çdo prezantimi, falenderoni fëmijën për prezantimin që bënë dhe pyesni atë se çfarë aktivitetesh bëjnë ata si familje sëbashku. Nëse fëmija nuk përgjigjet, ju mund të jepni shembuj aktivitetesh që ata mund të bëjnë bashkë me familjarët e tyre.

Pasi të gjithë fëmijët të kenë mbaruar me prezantimin e anëtarëve të familjes së tyre duke përdorur fotografitë, diskutoni me fëmijët për llojet e ndryshme të familjave si nga madhësia, përbërja e anëtarëve etj. sepse ata bëjnë shumë gjëra bashkë si psh..(ju mund të pyesni vetë fëmijët se cafrë bëjnë ata si familje ose të jeni shembuj aktivitetesh që ata mund të bëjnë) Vazhdoni të flisni rreth familjeve të ndryshme që në kemi duke theksuar që çdo fëmijë ka një familje por familja mund të jetë e përbërë nga anëtarë të ndryshëm, disa fëmijë jetojnë vetëm me nënë/babain e tyre, disa të tjerë jetojnë me prindërit dhe gjyshërit, disa të tjerë me motrat/vëllezërit e tyre, disa kanë kafshë shtëpiake etj. Të gjitha këto familje janë familje të vërteta.

Një familje mund të jetë e madhe ose e vogël por ajo që ka më shumë rëndësi është dashuria dhe mbështetja që ne i japin njëri tjetrit kur jetojmë në familje!

Ju mund t'i jepni fëmijëve shembuj të llojeve të familjeve të ndryshme si psh: një fëmijë që jeton vetëm me nënën e tij/saj, me prindër të divorcuar, njëri nga prindërit ka ndërruar jetë, njëri nga prindërit jeton jashtë vëndit ose në një qytet tjetër, babai osë nëna ka aftësi të kufizuara, ata kanë ardhur nga një vënd tjetër dhe tani po jetojnë në vëndin tonë.

Tregimi i historive

- Lexoni histori rreth ngjashmërive dhe gjërave të ndryshme
- Në një këndvështrim pozitiv tregoni histori që kanë të bëjnë me komunitetin në të cilin ju jetoni dhe histori nga bota që kanë të bëjnë me kulturat e ndryshme
- Tregoni histori që reflektojnë çështjet e aftësisë së kufizuar në një këndvështrim pozitiv
- Ndani me fëmijët histori që përmbajnë imazhe pozitive të ndryshimeve kulturore
- Ndani me fëmijët libra informues rreth kulturave të të tjerëve, besimeve fetare etj.
- Përdorni historinë e Princit të Vogël dhe udhëtimin e tij rreth planeve dhe vendeve të ndryshme për të diskutuar ndryshimet e rajoneve dhe vendeve të ndryshme në një këndvështrim pozitiv

Aktivitetet Artistike

- Prisni disa figura nga një revistë makinash
- Krahasoni ndryshimet në aspektin e ngjyrave, përmasave, etj
- Kush janë ngjashmëritë? Psh. të gjitha makinat kanë rrota, motor etj
- Krijoni piktura dhe vizatoni njerëz – fëmijët mund të përdorin një sërë materialesh si psh. pasqyra, pjata plastike, ngjyra për të lyer, etj për të krijuar imazhet e vetes së tyre
- Bëni shenjat e duarve duke përdorur bojra dhe bashkojini bashkë këto pamje për të bërë një kolazh
- Fëmijët mund të përdorin pjata plastike dhe lëpirëse për të bërë kukulla të cilat përshkruajnë kultura të ndryshme

Personazhet Kukulla

- Përdorni kukullat për të përshkruar kultura, besime fetare dhe aftësi të kufizuara të ndryshme etj
- Flisni me fëmijët në një këndvështrim pozitiv mbi ekperiencën e tyre me kukullat
- Lëri kukullat marioneta të tregojnë historitë e tyre se çfarë bëjnë me familjet, miqtë e tyre etj
- Kukullat marioneta mund të flasin rreth festave që bëjnë
- Ftoni fëmijët të flasin me kukullat marioneta rreth përvojave të tyre
- Lidhni ngjashmëritë dhe ndryshimet në një mënyrë pozitive

Lojrat Krijuese

- Mjediset e lojrave duhet të kenë materiale dhe gjëra të tjera që përshkruajnë kulturat e ndryshme
- Veshja e rrobave duhet të përshkruajë kultura të ndryshme

Kërcimi dhe muzika

- Dëgjoni muzika të ndryshme për të reflektuar tradita, kultura të ndryshme etj
- Përdorni instrumenta muzikor që përfaqësojnë kultura dhe tradita të ndryshme
- Eksploroni kërcime që reflektojnë tradita lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare
- Këndoni këngë që reflektojnë respektin për të ndryshmen si psh. “ Ne duam të gjithë fëmijët e botës” ose “Unë jam i/e veçantë”

Lojrat

- Luani lojra që përshkruajnë njerëzit rreth botës, sportet dhe festivalet, flamujt kombëtar të disa vëndeve të botës etj
- Prezantoni formuese (puzzle) në të cilat në një këndvështrim pozitiv paraqiten njerëz nga kultura dhe besimeve fetare të ndryshme nga e gjithë bota
- Prezantoni formuese (puzzle) ku paraqiten në një këndvështrim pozitiv njerëz me aftësi të kufizuara
- Luani lojën “Dielli shkëlqen mbi”: Fëmijët ulën në karrige në një rreth dhe një fëmijë qëndron në mes dhe thotë: Dielli shkëlqen mbi të gjithë ata që kanë flokë të shkurtra. Të gjithë fëmijët që kanë flokë të shkurtra ngrihen dhe ulen tek karrigia e një fëmije tjetër; fëmija që ngel pa karrige qëndron në mes dhe e ripërsërit ushtrimin duke përdorur një vlerësim tjetër.”

3. Prezantimi aftësisë së kufizuar dhe pranimi i dallimeve - Fëmijët me aftësi të kufizuara

Çfarë janë mjetet ndihmëse?

Filloni të flisni me fëmijët rreth asaj se si dikush mban syze për të parë më mirë dhe disa fëmijë mbajnë proteza për të drejtuar dhëmbët. Mjetet që përdorim për të na ndihmuar ose mbështetur në përmirësimin e lëvizjes, funksionimit të shqisave etj quhen **mjete ndihmëse**.

Kërkojini fëmijëve të bisedojnë për përvojat e tyre dhe njohuritë që kanë mbi mjetet ndihmëse. Ndoshta gjyshja e ndonjërit prej fëmijëve përdor proteza dhëmbësh, ndoshta gjyshi i ndonjërit prej fëmijëve përdor shkop/bastun për të ecur, mund të ketë fëmijë të cilët mund të tregojnë për babain/nënë e tyre që mban syze etj. Nëse fëmijët thonë se kanë parë ose provuar mjetet ndihmëse, kërkojini atyre të shpjegojnë se për çka shërben dhe për çfarë ndihmojnë këto mjete. Nxisni fëmijët të japin sa më shumë shembuj nga përvoja e tyre. Pyesni: A keni parë ndonjëherë dikë të ecë me paterica? A keni parë ndonjë person të lëvizë në karrige me rrota? Të ecë me shkop? Të përdorë aparat dëgjimi ose syze për të dëgjuar ose për të parë më mirë?

4. Të ndihmojme shokët/shoqet tona!

Disa fëmijë dhe të rritur kanë nevojë për ndihmë për të lëvizur, për të ecur ose për të shkuar në dyqane ose kinema.

Tregojini fëmijëve imazhe/fotografi ku tregohen fëmijë që përdorin mjete të ndryshme që i ndihmojnë ata të lëvizin dhe të ecin.



Fig. 1

Pyesni fëmijët të emërtojnë mjetet që po përdorin fëmijët në fotografi. Fëmijët që nuk mund të ecin lëvizin përdorin karrige me rrota.

Fig. 2

Fëmijët të cilët kanë aftësi të kufizuara në të shikuar ose që janë të verbër lëvizin duke përdorur shkopin e bardhë ose qenin ndihmës.



Fig. 3

Qeni Ndhmës është qen i trainuar/mësuar posacërisht për të ndihmuar personat që nuk shikojnë të lëvizin në shtëpinë e tyre ose në komunitet. Qeni Ndhmës ndihmon personat që nuk shikojnë të kalojnë rrugën, të shkojnë në park ose të takohen me miqtë.

Pyesni fëmijët nëse kanë parë ndonjëherë ndonjë fëmijë ose të rritur që përdor Qen Ndhmës apo duke përdorur një shkop të bardhë.

Mund të zhvilloni një aktivitetet që mund të ndihmojë fëmijët të mësojnë dhe të kuptojnë çfarë do të thotë të lëvizësh pa parë sendet vërdallë. Kështu, lidhni sytë e gjysmës së fëmijëve në mënyrë që të mos shohin ndërsa pjesa tjetër e fëmijëve, do të ndihmojë fëmijët që u janë lidhur sytë për të lëvizur në dhomë. Kështu, fëmija që nuk i ka të lidhura sytë do ndihmojë fëmijën që i ka të lidhur sytë për të lëvizur në klasë. Përpara se të fillojnë nga aktivitetit, shpjegojini fëmijës që shoqëron fëmijën që ka sytë e lidhur se duhet ti tregojë atij hapat që duhet të hedhë në mënyrë që të mos pengohet më ndonjë send.

KËSHTU DHE ASHTU

Filloni duke zhvendosini tavolinat dhe karriget në një cep të dhomës, për të krijuar hapësirë ku fëmijët të lëvizin lirshëm nga një anë e dhomës në anën tjetër. Fëmijët duhet të lëvizin nga njëra anë e dhomës për të marrë lodrat e vendosura në anën tjetër të dhomës dhe ta çojnë përsëri në vendin ku e morën dhe të kthehen serish në vendin e parë.

Përpara se të filloni lojën, edukatorja duhet të prezantojë fëmijët me rregullat e lojës.

Udhëzoni fëmijët Nuk duhet të shtyni ose të nxitoni në vrap. Kjo nuk është garë dhe nuk është e rëndësishme kush arrin i pari apo i fundit. Është e rëndësishme të argëtohemi, të kujdesemi për njeri tjetrin si dhe të gjejmë sa më shumë mënyra të ndryshme si mund të lëvizim.

Aktiviteti: Edukatorja udhëzon: “Tani shkoni në pjesën tjetër sallës/dhomës dhe sillini këtu nga u nisët lodrat që janë atje”. Fëmijët duhet të ecin për të marrë lodrat që ndodhen në anën tjetër të dhomës/sallës.

Pastaj mund të thoni: “OK, lërimi përsëri lodrat aty dhe ejani përsëri në pikën nga ku u nisët. Jut ë gjithë ecët dëri të vendi ku janë vendosur lodrat. Por, ka një rëz që lëvizin ndryshe. Edhe në mund të lëvizim në mënyrë tjetër/ndryshe. Si mund të lëvizim në mënyrë tjetër për të shkuar deri te vendi ku janë lodrat?” Nëse fëmijët nuk përgjigjen, atëherë bëni një pyetje tjetër të tillë si: “Si lëvizin bebet? Si ecin kotelet? ”

Diskutoni me fëmijët për të gjitha mënyrat e ndryshme sesi mund të lëvizim. Pasi të keni gjetur gjitha mënyrat e mundshme sesi një rëz mund të lëvizin/ecin, thuajini fëmijëve të shkojnë përsëri te lodrat e vendosura në anën tjetër të dhomës duke u zhvendosur në mënyra të ndryshme. Fëmijët mund të lëvizin duke ecur mbrapsht, duke ecur anash, duke ecur kembadorazi, duke u hedhur pupthi, duke u zvarritur, me levizje te perzjera, mbi duar dhe kembe etj. Lavdëroji për përpjekjet e tyre për të bërë mënyra të ndryshme lëvizjeje si dhe pa u përjasur me njeri tjetrin.

Loja SYMBYLLAZI

Qëllimi i kësaj loje është që fëmijët të mësojnë si të orientohen në hapësirë si dhe të nxiten shqisat, prekja dhe dëgjimi. Duke aktruar sikur kanë aftësi të kufizuar në të shikuar, fëmijët mund të kuptojnë se si është për personat me aftësi të kufizuar në të shikuar orientimi në hapësirë.

Gjashtë fëmijë mund të jenë pjesë e aktivitetit ndërsa fëmijët e tjerë mund të jenë shikues.

Fëmijët e tjerë duhet të qendrojnë në qetësi. Mund të lidhni sytë tre prej fëmijëve. Ndërsa tre fëmijët e tjerë mund të pozicionohen në kënde/anë të ndryshme të dhomës duke thënë: “jam këtu” Fëmijët që kanë lidhur sytë duhet të ecin vetë nëpër dhomë për të arritur fëmijët që janë pozicionuar në anë të ndryshme të dhomës.

Përpara se të fillojë loja, edukatorët duhet të shpjegojnë rregullat e lojës.


Loja: Secili prej fëmijëve të pozicionuar në kënde të ndryshme të dhomës duhet të thonë vazhdimisht “jam këtu” “jam këtu”. Fëmijët të cilët i kanë të lidhura sytë duhet të lëvizin vetë duke përdorur shqisën e të dëgjuarit dhe prekjes drejt fëmijëve që thonë “jam këtu”. Fitues është ai që arrin i pari një prej fëmijëve.

Shenjat e aftësisë së kufizuar



Shpjegoni fëmijët me këtë shenjë dhe pyesni ata nëse kanë pare ndonjëherë një shenjë të ngjashme, dhe ku? Fëmijëve që njerëzit që përdorin karrige me rrota apo paterica për të ecur, kane nevojë për më shumë hapësirë për të lëvizur. Njerëzit që përdorin karrige me rrota kanë nevojë për për rampe për të hyrë në një ndërtesë, dhe që të mos ketë shkallë, kanë nevojë për trotuare pa bordura, për tualete të përshtatura.

Disa shenja të tjera që ju mund t'i shihni dhe që tregojnë aftësi të kufizuara të ndryshme:



Për të bërë një bisedë me fëmijët rreth aftësisë së kufizuar sygjerohet që të përdorni pyetje të tilla si: A keni ndihmuar ndonjëherë ndonjë fëmijë që ka patur nevojë psh për të veshur këpucët apo xhupin? Apo kur ata kanë qënë të sëmurë me grip?

Shpjegoni fëmijëve se të ndihmsh të tjerët që kanë nevojë është shumë mirë por theksoni se para se ata të ofronjnë ndihmë duhet të pyesin: nëse mund të ndihmojnë dhe nëse po, si mund të ndihmojnë?

1. Po ju prezantojme me miqtë tanë me aftësi të kufizuara!

Për këtë aktivitetet përdoren foto me imazhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilat ju ja prezantoni fëmijëve.

Shënim: Nëse në grupin e fëmijëve ka fëmijë që kanë të njëjtin emër me fëmijët në kartat e mëposhtme, përdorni emra të tjerë..

Fëmijët që kanë vështirësi në dëgjim: Anisa është 4 vjec, ajo ka floke te gjatë me ngjyrë kafe që i kap përherë në dy bishtaleca. Ajo është shumë miqësore me të gjithë fëmijët. Anisa gjithashtu ka vështirësi në të dëgjuar, ndaj ajo mban aparat dëgjimi që e ndihmon të dëgjojë më mirë. Anisës i pëlqen të luajë te parku dhe lojërat e shpejtësisë. Ajo është më e shpejta ndër shokë e shoqe.

U kaloni fëmijëve fotografinë e Anisës dhe filloni bisedën për pajisjen e dëgjimit: A është e rehatshme? Për çfarë përdoret? A është e nevojshme?

Fëmijët me aftësi të kufizuara fizike: Besi është një djalë 5 vjec që ka ardhur para një muaji. Ai ka floke kacurrel dhe është shumë i qeshur. Besi përdor një karrige me rrota për t'a ndihmuar me të ecurin pasi nuk mund të eci vetë pa ndihmë. Besi vizaton shumë mirë dhe kafshët që vizaton duken si të vërtetë.

U kaloni fëmijëve foton e Besit dhe filloni bisedën rreth karriges së tij me rrota: Ku mund të shkojë ai me karrigen? Çfare pengesash mund të ketë që mund të vështirësojë lëvizjen e tij? Çfarë vështirësish mund të has Besi ndërsa vjen në kopësht?

Fëmijët me vështirësi në të parë: Niseni bisedën me fëmijët me pyetjen: A e mbani mend kur keni luajtur syllambyllazi me shokët dhe shoqet e e juaja? Prisni përgjigjet e fëmijëve dhe pastaj filloni të tregoni historinë e Benit. Beni është 4 vjeç dhe ka një passion shumë të madh për të kërcyer. Ky pasion i vjen nga dëshira për të dëgjuar muzikë. Atij i pëlqen jo vetëm kërcimi dhe muzika por edhe të regjistrojë veten njësoj si prezantuesit në radio. Beni ka vështirësi në shikim dhe për të ndihmuar veten ai përdor një shkop të bardhë kur ecen, ndërsa për të lexuar përdor librat me shkrimin Braille përmes gishtave.

U kaloni fëmijëve foton e Benit dhe pyetini ata: Çfare po ben ai ne kete foto? A është duke lexuar?

Pyesni fëmijët: a mund të lexojnë personat e verbër? Kaloni me radhë fëmijëve kartën me shkrimin Braille dhe shpjegojini fëmijëve që në librat për fëmijët e verbër ose për fëmijët që kanë vështirësi në të shikuar gërmat janë sin ë këtë kartë që po u kalon atyre me radhë. Pikat e ngritura që ju mund ti ndjeni me gishtërinjtë quhen Braille.

Jepin fëmijëve mundësi të prekin shkrimin Braille si dhe nxitini ata të shprehin përvojën e tyre: “Çfarë ndjeni me prekjen?” Mund të shtoni që në këtë mënyrë lexojnë fëmijët e verbët, ata lexojnë duke prekur me gishtërinjtë e tyre gërmat ashtu sic po bëni ju tani.

Gjeni rastin të bëni dallimin midis fëmijëve që kanë syze që i ndihmon ata të lexojnë dhe të shohin dhe fëmijëve të cilët janë të verbër. Fëmijët që mbajnë syze nuk janë të verbër por sytë e tyre kanë nevojë për ndihmë për të parë më mirë gërmat ose figurat.

Bisedoni me fëmijët çfarë lojërash mund të luani me secilin prej fëmijëve.

KAPITULLI 5

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve

Neni 12: Ti ke të drejtë të shprehësh mendimin tënd. Ti ke të drejtë të shprehësh atë që mendon dhe ndjen dhe ke të drejtë të dëgjohesh nga të rriturit.

Neni 13: Ti ke të drejtë të shprehësh veten tënde në të gjitha mënyrat krujuese të mundshme

Duke më Dëgjuar Mua dhe Duke Dëgjuar të Tjerët

Vetë – shprehja dhe vetë-aktualizimi (Gjithashtu shiko materialet mbështetëse “Duke Dëgjuar Fëmijët e Vegjël”)

HYRJE

Këndvështrimi i Fëmijëve - Çdo njeri ka idetë, mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tyre. Disa herë ju doni t'i shtoni këtyre mendimeve ide, ndjenja dhe emocione. Kur ju doni të ndani idetë tuaja është e rëndësishme që të keni të rritur dhe fëmijë të tjerë për të dëgjuar atë se çfarë doni të thoni. Ju mund të shprehni veten tuaj edhe në mënyrë të tjera, nëpërmjet të kënduarit, duke bërë art, duke luajtur dhe kërcyer. Është mirë të dëgjohesh dhe është gjithashtu e rëndësishme të dëgjojmë të tjerët.

Këndvështrimi i të Rriturve - Fëmijët zhvillojnë aftësitë e tyre të dëgjimit kur ju flisni me ata. Prisni që të dëgjoni përgjigjen e tyre. Fakti që ne i dëgjojmë me të vërtetë fëmijët, ka të bëjë më pak me përgjigjet e tyre dhe më shumë me vëzhgimin që bëjmë ne rreth mënyrave që ata përdorin për të komunikuar verbalisht dhe jo verbalisht – “100 gjuhët e fëmijës”. “Mënyrat e mira për të promovuar aftësitë e dëgjimit mund të përfshijnë: tregimin e historive për fëmijët dhe duke i bërë ata që të imagjinojnë se çfarë do të ndodhë më pas ose bëjini ata që të tregojnë historinë për ju; leximi i historive për fëmijët; zhvillimi i lojrave që kanë në thelb dëgjimin si tregimin e vjershave dhe lërinini ata të gjejnë se kush do të jetë fjala e fundit që rimon. Aftësitë dëgjuese të forcuara për një fëmijë si, “më dëgjo mua..tani, ose, të kam thënë 100 herë...” – zakonisht nuk i nxisin fëmijët që të dëgjojnë pasi ato janë mënyra të imponuara. Nxisni një dëshirë pozitive për të dëgjuar të tjerët dhe për t'u dëgjuar nga të tjerët duke perifrastuar dhe duke e bërë të dëgjuarin të këndshëm. Të dëgjosh fëmijët e vegjël në rajonet e konfliktit është me të vërtetë e rëndësishme.

Pyetje të mundshme për diskutim

- Ne dëgjojmë vetëm me veshë? (Të dëgjosh do të thotë të përdorësh të gjithë trupin tënd për të kushtuar vëmendje të tjerëve...përdorim sytë për të parë, veshët për të dëgjuar, mëndjen për të menduar, të gjithë trupin për t'u përqëndruar)
- Kush janë disa nga njerëzit që ju dëgjojnë?
- Kush janë disa nga gjërat për të cilat keni dëshirë të flisni?
- Si ndjehesh kur asnjë nuk të dëgjon?
- Kush janë disa nga njerëzit që ju dëgjonin?
- Çfarë mund të bëni ju për t'u bërë një dëgjues/e i/e mirë? (Shikoni personin, prisni dhe dëgjoni se çfarë thotë ai/ajo pa u larguar, përsërsini atë që tha personi, bëni pyetje nëse nuk kuptoni)
- Kur mund të jetë e vështirë për të dëgjuar? (psh. kur ne ndjehemi të inatosur)
- Përse mendoni se është e rëndësishme që të dëgjojmë të tjerët? Çfarë do të ndodhte nëse ju nuk do të dëgjoni të tjerët? (mamanë, babain, moshatarët, mësuesit, doktorët etj)

- Përse mendoni se është e rëndësishme që të tjerët të të dëgjojnë? (çfarë informacioni të rëndësishëm doni të ndani...çfarë pëlqeni, nuk pëlqeni, diçka që ju ka ndodhur, çfarë doni të bëni)

Aktivite që mund të bëhen në qendra

Diskutime/Gjuha/Aktivite mbi Komunikimin

- Krijoni një rreth dhe krijoni një “objekt që flet” diçka të lehtë apo një kukull marionetë dhe kalojeni tek çdo fëmijë
- Fëmijët mund ta kalojnë me rradhë objektin tek njëri-tjetri. Duke fituar përvojë, fëmijët mund të vendosin vetë se kur duan t’a marrin objektin që flet
- Kur fëmija ka në dorë objektin që flet, ai/ajo mund të na tregojë diçka rreth vetes dhe të tjerët duhet t’a dëgjojnë pa e ndërprerë
- Nëse ndonjë fëmijë nuk do që të flasë, ai/ajo mund të kalojë objektin apo lodrën tek fëmija tjetër
- Fëmijët mund të flasin rreth familjes, kashfëve, gjërave të tyre të preferuara, gjërat që kanë dëshirë të bëjnë etj

Tregimi i historive

- Sillni njerëz nga komuniteti – prindër ose gjyshër për të treguar histori për fëmijët
- Nxisni të dëgjuarin duke lexuar në mënyrë ekspresive dhe me energji për të tërhequr fëmijët në historinë që po tregohet...nxisni bashkëveprimet me historinë për shembull, pas çdo faqe kërkoni një fëmijë që t’ju tregojë se për çfarë bëhej fjalë në faqen që sapo u lexua
- Jepini fëmijëve mundësinë që të tregojnë historinë e tyre, çfarë bënë dje, çfarë bënë shumë kohë më parë...një herë e një kohë
- Tregoni histori nga kultura të ndryshme dhe imazhe të fëmijëve që mund të duken ndryshe në aspektin e ngjyrës, veshjes, mjedisit shoqëror etj. Tregojini fëmijëve rreth kulturave të ndryshme... cilat janë ngjashmëritë e të gjithë fëmijëve...në çfarë janë të ndryshëm? Filloni diskutimin për mënyrën se si i respektojmë ne të tjerët, si i kuptojmë dhe a duhet të jemi të gjithë të ngjashëm apo të ndryshëm?
- Nxisni fëmijët që të flasin mbi mënyrën e komunikimit që kanë kafshët që ata mund të kenë afër (qen, mace, zogj, lopë) apo kafshë të tjera që mund të jetojnë pranë tyre (lopë, dele, kuaj). Si përpiqen ata të komunikojnë kur nxjerrin tinguj (si tingëllojnë ata kur janë të frikësuar, të uritur, kur duan të dalin, çfarë bëjnë ata për të treguar që pëlqejnë/nuk pëlqejnë diçka/dikë

Aktivitetet artistike

- Jepu mundësi fëmijëve që të shprehin veten e tyre nëpërmjet bërjes së shenjave, pikturës, vizatimeve dhe artit me mjete rrethimore
- Ftoni fëmijët që të flasin rreth asaj që kanë vizatuar/bërë dhe më pas bëni pyetjen: çfarë është?
- Emëroni vizatimet e fëmijëve sipas asaj që ata po thonë dhe dokumentojeni këtë me fjalët që përdor vetë fëmija
- Nëse keni një aparat, jepini fëmijëve mundësinë që të dokumentojnë veten e tyre
- Jepu mundësi fëmijëve që të bëjnë aktivitete artistike duke bashkëpunuar me njëri tjetrin siç mund të jetë bërja e një kolazhi i cili kërkon një punë në grup
Sillni revista, gazeta, foto të cilat fëmijët mund t'i ndajnë me njëri-tjetrin. Nxisni ata që të bëjnë një kolazh nga vënde të ndryshme, me njerëz të ndryshëm, me mjete transporti dhe mjedise të ndryshme... të mësosh të vlerësosh se si të tjerët janë të ngjashëm ose të ndryshëm. Si mund të komunikojmë ne me të tjerët edhe pse nuk flasim të njëjtën gjuhë... duke përdorur gjuhën trupore si buzëqeshjen, shtrëngimin e duarve apo duke ndihmuar njëri-tjetrin.

Personazhet kukulla

- Përdorni kukullat për të shprehur se si u ndjenë ata kur askush nuk e dëgjoji atë ose kur ai/ajo ishte i/e frikësuar për të folur
- Sot kukulla nuk do të flasë, do vetëm të dëgjojë
- Kukulla ka një problem, ajo do që fëmijët ta dëgjojnë
- Fëmijët mund të japin zgjidhjen e tyre për problemin dhe të dëgjojnë zgjidhjet e fëmijëve të tjerë
- Kukulla u thotë fëmijëve se si ndjehesh kur të dëgjojnë dhe sa sa e ndihmuar fëmijët për të zgjidhur problemin
- Mbani mend, ju nuk duhet të bëni një zë të shtirur për kukullën. Kukulla mund t'ju flasë në vesh ndërkohë që ju e dëgjoni me vëmendje dhe më pas këtë informacion i'a thoni fëmijëve me zë.

Lojra krijuese

- Bëni një lojë duke bërë rolin e një doktori/dentisti/shitësi etj. Si i dëgjoni pacientët apo klientët?
- Çfarë do të bënit ju nëse jeni do të ishit pacienti apo klienti dhe doktori/dentist/shitësi nuk ju dëgjon?
- Imagjinoni sikur ju nuk mund të dëgjoni (vendosni duart apo kufje në veshët e fëmijëve). Si do t'a kuptoni ju se çfarë thonë apo bëjnë të tjerët?

Kërcimi dhe muzika

- Dëgjoni muzikë, tingujt, ritmin, instrumentat e ndryshëm etj
- A mund të kërcëjmë nëse nuk dëgjojmë muzikë?
- Dëgjoni lloje të ndryshme muzikash dhe ndaloni në mes të muzikës...lëri fëmijët të gjejnë vetë se çfarë muzike do të fillojë...më pas luani muzikën dhe vërtetoni përgjigjen e tyre. Përsëriteni disa herë këtë gjë në mënyrë që ata të mësojnë të dëgjojnë mirë dhe të gjejnë muzikën e që do të luhet më vonë

Lojrat

- Dëgjoni tinguj të ndryshëm në dhomë dhe jashtë. Më pas lëri fëmijët të gjejnë se çfarë tingujsh janë
- Lojrat me pëshpërim (telefoni i prishur) ku fëmijët i pëshpërisin diçka njëri-tjetrit në vesh për të transmetuar mesazhe
- Lojra ku fëmijët duhet të dëgjojnë me kujdes udhëzimet si psh loja e vigan - shkurtabiqit etj.
- Luani loja me rimë me fëmijët dhe kërkoni atyre që të gjejnë fjalën e ardhshme që rimon...kacamiu...lëpiu...etj

KAPITULLI 6

Të ndjehesh i/e sigurtë - Mjediset e sigurta dhe mbrojtëse

HYRJE

Këndvështrimi i fëmijëve - Ne të gjithë kemi të drejtë të ndjehemi të sigurtë pavarësisht se ku jemi dhe me kë jemi. Ne nuk ndjehemi të sigurtë kur ka të bërtitura, zënka dhe sjellje lënduese. Nëse nuk ndjehemi të sigurtë ne duhet ti themi një të rrituri i/e cili/a mund të na ndihmojë. Ne duhet të ndihmojmë të tjerët që të ndjehen të sigurtë duke qënë ndihmues dhe jo lëndues.

Këndvështrimi i të rriturve - Fëmijët rriten në mjedise që ndonjëherë mund të jenë të dhunshme dhe të dëmshme. Fëmijët nuk mund të luajnë, të relaksohen apo të shprehin veten e tyre nëse nuk ndjehen të sigurtë. Ka disa mënyra që ne si të rritur mund të ndihmojmë për të krijuar mjedise më të sigurta dhe mbrojtëse për fëmijët. Kjo përfshin mbrojtjen e fëmijëve nga ekspozimi ndaj dhunës duke e bërë mjedisin fizik më të sigurt. Në situata të konfliktit, fëmijët mund të ndjehen të pasigurt në ambientin e tyre të drejtpërdrejtë duke u ekspozuar ndaj frikës së të rriturve ose duke dëgjuar lajmet që transmetohen në televizion.

Është e rëndësishme që fëmijët të ndjejnë që mjedisi i tyre është i sigurt dhe se ka të rritur që janë në dispozicion për ti mbrojtur, për t'i dëgjuar dhe siguruar. Fëmijët mund të ndihmojnë në identifikimin e atyre elementeve të mjedisit që i bëjnë ata të ndihen të pasigurt, të frikësuar apo të kërcënuar. Ata gjithashtu ndihmojnë për t'a bërë mjedisin më të sigurtë për të gjithë. Kjo u mëson atyre përgjegjësi dhe si të kujdesen për veten dhe të tjerët.

Pyetje të mundshme për diskutim:

- Ku ndjeheni ju të sigurtë? Çfarë ju bën ju të ndjeheni të sigurtë?
- A ka ndonjë vënd ku ju nuk ndjeheni të sigurtë?
- Si ju bën të ndjeheni kjo gjë?
- Çfarë lloj sjelljesh janë lënduese?
- A mund të bëjmë ne gjëra që i lëndojnë të tjerët?
- Si mund të marrim ndihmë për këtë gjë? Ku e shihni dhunën që ndodh rreth jush?
- Si ju bën të ndjeheni kjo gjë?
- A ka ndonjë gjë apo ndonjë person që ju bën të ndjeheni të sigurtë kur ndodheni në këtë situatë?

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve

Neni 19 Ti ke të drejtën të ndjehesh i/e sigurtë dhe i/e mbrojtur.

Aktivitete

Diskutime/Gjuha/Aktivitete mbi Komunikimin

- Çfarë ju bën ju të ndjeheni të sigurtë? Bëni një diskutim me fëmijët që i ndihmon ata për të identifikuar tre gjëra që i bën ata të ndjehen të sigurtë (duke qënë me mamën, babin apo ndonjë person tjetër, duke luajtur në dhomë, duke qëndruar në një cep me librin apo lodrën e tyre të preferuar, duke qënë në kopësht, në një ambjent të sigurtë). Lërimi fëmijët që të përshkruajnë se si ndjehen kur janë të sigurtë....ndjenja e lumturisë, relaksit, pa shqetesime etj.
- Bëjini fëmijët që të diskutojnë tre gjëra që i bën ata të kenë frikë. Për shembull frika nga errësira. Fëmijët që jetojnë në zonat e konfliktit, mund ta përshkruajnë frikën duke e lidhur me zhurmën e armëve apo shpërthimeve. Profesionistët duhet të jenë të përgatitur për të dhënë përgjigje të ndershme që njeh frikën e fëmijëve dhe në të njëjtën kohë i jep siguri atyre.
- Bëni një diskutim për mënyrat se si mund ta mbajmë të sigurtë mjedisin e brëndshëm dhe të jashtëm.

Tregimi i historive

- Lexoni histori që kanë të bëjnë me ndjenjën e sigurisë, frikës dhe histori që zbusin frikën
- Si të rritur ju mund të thoni histori të tuaja kur jeni ndjerë i/e sigurtë, frikësuar etj kur keni qënë të vegjël dhe kush ju ka ndihmuar apo çfarë bëtë për të ndihmuar veten tuaj
- Fëmijët gjithashtu mund të tregojnë histori kur janë ndjerë të sigurtë/të lumtur dhe të pasigurtë
- Fëmijët mund të tregojnë histori se si sillen kafshët që jetojnë me ta ose afër tyre, kur ndjehen të pa sigurta apo të frikësura. Si i mbështesin kafshët e tyre fëmijët në të tilla situata?

Aktivitete Artistike

- Merrni disa revista dhe gazeta dhe lërimi fëmijët të presin figura të gjërave që janë të sigurta dhe të pa sigurta. Ata mund të bëjnë një kolazh me të gjitha gjërat e sigurta dhe të pa sigurta
- Kërkoji fëmijëve që të vizatojnë udhëtimin e tyre nga shtëpia për në kopësht/shkollë. Ndhmojini ata të identifikojnë ndonjë situatë të sigurtë më të cilën ata janë përballur. Fëmijët mund ta marrin këtë vizatim me vete në shtëpi për t'ua treguar prindërve/kujdestarëve të tyre
- Kërkoji fëmijëve që të vizatojnë një figurë të “zonës së tyre të sigurisë”, vendi ku ata shkojnë kur duan të ndjehen të sigurtë dhe të lumtur
- Fëmijëve mund t'u jepen materiale të ndryshme për të ndërtuar/krijuar skenat/momentet kur ata janë ndjerë të lumtur dhe të sigurtë dhe kush është në atë figurë që i bën të ndjehen të sigurtë. Të njëjtën gjë mund të bëjmë për të përshkruar një situatë në të cilën fëmijët janë ndjerë të pa sigurtë.

Personazhet kukulla

- Kukulla po qan. Ajo ndjehet e frikësuar sepse njerëzit afër saj po bërtasin dhe po zihen. Dikush e shtyu me forcë dhe u rrëzua mbi të, Çfarë mund të bëjmë ne për t'a ndihmuar?
- Kukulla nuk do të flejë në errësirë, çfarë mund të bëjë ajo që të ndjehet e sigurtë?
- Personazhi kukull dëgjoji nga jashtë disa zhurma të mëdha dhe të frikshme. Ai mendon se mund të jenë zhurma armësh, kush mund ta ndihojmë atë?

Lojra krijuese

- Kërkojini fëmijëve që të imagjinojnë sikur po ndërtojnë shtëpinë e tyre. Ku do ta ndërtojnë atë dhe kë do të ftojnë në shtëpi?
- Identifikoni tre zona në mjedisin tuaj në të cilat fëmijët ndjehen të sigurtë/pa sigurtë. Lejoni atyre të mbushin disa shishe me ujë të ngjyrosur si psh. me ngjyrë të kuqe dhe jeshile dhe një të shishe me ngjyrë vendose në mjedisin e sigurtë, tjetër në mjedisin e pasigurtë. këto. Punoni sëbashku për të ndryshuar zonat në mënyrë që të ndjehen të sigurtë
- Përdorni lojën me role për fëmijët që tu tregoni se si ndjehen ata kur janë të frikësuar apo kur përballen me situata të pa sigurtë.

Kërcimi, lëvizjet dhe muzika

- Ishujt e Mbrojtur (variant tjetër I lojës është ai me karrige dhe muzikë). Ju duhen katër fletë të mëdha letre. Këto letra duhet t'i ndani në pjesë për të krijuar disa "ishuj". Gjithashtu duhet të keni muzikë në sfond për t'ju shoqëruar gjatë gjithë lojës. I rrituri tregon se kur muzika të vazhdojë, fëmijët do të bëjnë sikur notojnë. Kur muzika ndalon, peshqari kërkon të hajë ushqimin e tij dhe të gjithë fëmijët duhet të gjejnë një vend në ishull për t'u mbrojtur. Pas kësaj muzika fillon prapë dhe ndërkohë i rrituri heq disa nga ishujt duke lënë më pak ishuj për fëmijët. Loja vazhdon deri sa të gjithë fëmijët mbeten vetëm në një ishull.

KAPITULLI 7

Zgjidhja e Problemeve - Aftësitë për zgjidhjen e konflikteve

HYRJE

Këndvështrimi i fëmijëve - Na pëlqen të luajmë me të tjerët; ja kalojmë shumë mirë bashkë. Në të shumtën e kohës na pëlqen të bëjmë të njëjtat gjëra por ndonjëherë duam të bëjmë diçka ndryshe ndërsa herë të tjera nuk biem dakort për disa gjëra. Ndihe mi të inatosur dhe e kemi të vështirë të dëgjojmë të tjerët dhe ti kuptojmë ata. Ndonjëherë kemi nevojë për ndihmë për të zgjidhur gjërat.

Këndvështrimi i të rriturve - Jeta është e mbushur me probleme çdo ditë. Problemet nuk janë “problemi” në vetvete; por ka lidhje me mënyrën si trajtojmë problemin dhe mënyrat që zgjedhim që mund të na çojnë drejt një rezultati pozitiv ose negativ. Mësuesit luajnë një rol ndihmues për fëmijët në zhvillimin e aftësive për zgjidhjen pozitive të problemeve. Kjo nënkupton: identifikimin dhe përcaktimin e problemit; gjetja e një zgjidhje të pranuar nga të dyja palët; ndihma që u jepet fëmijëve për të vendosur në praktikë zgjidhjet e tyre dhe më pas arsyetimi së bashku me fëmijën për zgjidhjen dhe përfundimin.

Ky është një proces i gjatë që kërkon bashkëbisedim dhe ndërveprim midis mësuesit dhe fëmijës, por është më i frytshëm dhe afatgjatë sepse i jep mundësi fëmijëve të zhvillojnë aftësi për zgjidhje të problemeve të tjera në të ardhme. Ndodh shumë herë kur të rriturit e zgjidhin problemin ose i japin fund një konflikti duke u thënë fëmijëve të ndalojnë ose të sillen mirë, por fjalët e ndalojnë sjelljen vetëm për momentin. Gjithashtu të rriturit vendosin si zgjidhje largimin/shkëputjen e fëmijës nga situata ose u thonë atyre se duhet të ndahen me tjetrin. Këto janë përjasje të orientuara nga të rriturit, ndaj nuk ndihmojnë në zhvillimin e aftësisë të fëmija për të zgjidhur problemin. Duke u dhënë mundësi fëmijëve që të përcaktojnë problemin, të gjejnë zgjidhje të arsyeshme/të pranueshme, dhe të provojnë nëse zgjidhja e tyre është një aftësi afatgjatë, fuqizon fëmijët dhe i bën ata të jenë aktiv në ndryshimin e vetë sjelljeve të tyre.

Hapa pozitive drejt zgjidhjes së problemeve

Më poshtë, paraqitet një strategji që fokusohet në zhvillimin e aftësisë së fëmijës për të zgjidhur problemet. Kur lind një problem në kontekstin e fëmijërisë së hershme, të rriturit duhet:

1. **T’i qasen situatës qetësisht, duke ndaluar çdo veprim dëmtues.** Qëndroni midis fëmijëve, uluni në nivelin e tyre; përdorni një intonacion zëri të qetë dhe qëndroni neutral duke mos marrë anën e askujt.
2. **Pranoni ndjenjat e fëmijëve.** Thoni diçka të thjeshtë si “Dukesh i/e mërziur.”

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve

Neni 29: Arsimiti yt duhet të të ndihmojë të përdorësh dhe zhvillosh talentet dhe aftësitë e tua. Gjithashtu, arsimi duhet të të mësojë të jetosh në paqe, të ruash mjedisin dhe të respektosh njerëzit e tjerë.

3. **Mblidhni informacion.** Pyesni “Çfarë problemi ka?” Mos bëni pyetje me “pse” pasi kjo fokuson fëmijët tek problemi dhe jo tek arsyet që qëndrojnë pas problemit.
4. **Riformuloni problemin:** “Pra, problemi është...” Përdorni dhe zgjeroni me tej fjalët e fëmijës, duke përdorur fjalë jo-paragjyquese për çdo fjalë lënduese të tilla si “budalla” ose “i keq”.
5. **Kërkojini zgjidhjet dhe zgjidhni një së bashku.** Pyesni “Çfarë mund të bëjmë për të zgjidhur problemin?” Nxisni fëmijët të mendojnë për zgjidhjen, por në të njëjtën kohë jepuni atyre variante zgjidhje nëse nuk u vjen asgjë ndërmend.
6. **Zgjidhni një alternativë zgjidhje së bashku dhe bëjani të ditur fëmijëve arritjen e tyre.** psh., “E zgjidhët problemin!”
Qëndroni afër në rast se ndonjëri prej fëmijëve mund të mos jetë i kënaqur me zgjidhjen, në këtë rast është e nevojshme përsëritja e procesit.

Aktivitete që mund të zhvilloni

Diskutime/Gjuha/ Aktivitete mbi Komunikimin

- Jepini dy fëmijëve një kuti me lapsa me ngjyra. Kërkojini atyre të vendosin se si do të ndajnë kutinë me lapsa për një grup me katër fëmijë. Çfarë do të bëjnë ata nëse disa fëmijë kanë më shumë/më pak lapsa me ngjyra se disa të tjerë?
- Kërkojini fëmijëve të përgatisin një fletë regjistrimi për aktivitetet në natyrë. Kush do të luajë i pari, i dyti, apo i treti ... në lëkundëse, ose në rrëshkitëse ose me biçikleta? Si do të mbajnë radhën? A mund të bëjnë fletë regjistrimi edhe për ditë të tjera?
- Në fund të ditës, mësuesi mund të zhvillojë aktivitetin “mirupafshim”. Çdo ditë, një fëmijë duhet të nxitet të tregojë diçka mbi atë çfarë ka ndodhur gjatë ditës në kopësht. Çfarë ndodhi? A ishte problem apo jo? Si u përball fëmija me situatën? A ka mënyra të tjera për të përballuar këtë situatë?
- Përdorni çdo situatë problematike që ka ndodhur si një mënyrë për t’i mësuar fëmijëve aftësitë e lartpërmendura.

Tregimi i historive

- Tregoni përralla ku fëmijët/kafshët/personazhet kanë mosmarrëveshje, debatojnë dhe konfliktohen. Përdorni këto për të treguar mënyra negocimi dhe zgjidhje të vështirësive dhe përshtatje të perspektivave të ndryshme.
- Gjeneroni histori/përralla interesante që tregojnë se si fëmijët kanë shfaqur aftësi për të zgjidhur problemin. Ka shumë përralla për fëmijë që kanë gjetur zgjidhje në kërkim të thesarit ose kanë kapërcyer pengesa. Lexojini përralla të tilla fëmijëve dhe nxitini ata të diskutojnë se si do t’i zgjidhnin ata të tilla probleme.
- Jepini mundësi fëmijëve të tregojnë histori mbi problemet që janë përballur dhe si i kanë zgjidhur ... ndonjëherë është aq e thjeshtë sa lidhja e këpucëve

Personazhet kukulla

- Kukulla nuk është e gëzuar. Sa herë shkon të luajë me kuba, fëmijët e tjerë shkojnë aty dhe i marin disa kuba, kështu ajo nuk mund të ndërtojë kullën e saj të madhe. Çfarë duhet të bëjë ajo?
- Kukulla është shumë e mërzhitur. Ajo do të luajë në lisharëse, por Sara do që ajo të zbresë prej aty, TANI!!!
- Kukulla është shumë e gëzuar; ajo ka gjetur një mënyrë për të marrë shumë libra për të lexuar. A e dini si i ka marrë kaq shumë libra?

Kërcimi dhe muzika

- Fëmijët qëndrojnë në rreth dorë për dorë. Pa lëshuar duart ata ndërthuren duke kaluar nën dhe mbi krahët e njeri tjetrit. Më pas ata duhet të përpiqen të zgjidhin ndërthurjen pa lëshuar duart me njeri-tjetrin
- Jepini fëmijëve mundësi të krijojnë hapa kërcimi duke lëvizur këmbët në mënyrë ritmike, rrotullojnë duart, lëvizin në formë rrethi dhe bëjnë hapa të tjerë kërcimi argëtues. Lërinë ata të punojnë në grup për të krijuar kërcimin e tyre. Më pas grupet mund t'i tregojnë njeri-tjetrit kërcimet e tyre. Sa të ngjashme janë ato dhe si dallojnë nga njera tjetra?

Lojërat

- Kërkojini fëmijëve të vihen në rresht nga fëmija më i shkurtër tek ai më i gjatë, por për këtë ata nuk duhet të flasin ose të maten me njeri tjetrin.
- Merrni një enë të madhe me ujë dhe disa gota të vogla. Pyetini fëmijët sa gota të vogla duhen për të marrë të gjithë ujin nga ena. Kërkojini fëmijëve të hedhin ujin në gotat e vogla për të parë se cili nga fëmijët e gjeti ose ishte afër numrit të saktë të gotave të vogla që duheshin për të hequr ujin nga ena.
- Kërkojini fëmijëve të ulen në rreth, përqark tavolinës ose në rreth të ulur në gjunj në dysheme dhe të vendosin duart e tyre përpara vetes. Çdo fëmijë duhet të vendosë dorën e djathtë midis dy duarve të fëmijës ulur në të djathtë të tij dhe dorën e majtë midis duarve të fëmijës ulur në të majtë të tij/saj. Ndihmojini fëmijët që të gjithë të kenë duart në mënyrë të tillë që midis duarve të çdo fëmije të jenë dy duart e fëmijëve të ulur përkrah tij/saj. Pasi të jenë pozicionuar të gjithë, një fëmijë duhet të bëjë një lëvizje të thjeshtë me një dorë. Lëvizja duhet të përsëritet nga dora përkrah, më pas nga dora përkrah dorës së sytë.....deri kur çdo dorë në rreth, njëra pas tjetrës, ka përsëritur lëvizjen.

KAPITULLI 8

Ndjenjat dhe forca - Aftësia për t'u ripërtërirë

HYRJE

Këndvështrimi i fëmijëve - Ndonjëherë në jetën tonë ndodhin gjëra që janë të vështira, që mund të na trishtojnë, të na shqetësojnë ose të na frikësojnë. Në momente të tilla, ne të gjithë kemi nevojë për dikë i/e cili/cila mund të bëjë të ndihemi më të sigurtë dhe të mbrojtur. Ne ndihemi më të fortë kur e dimë që ka njëri të cilët na duan dhe kujdesen për ne.

Këndvështrimi i të rriturve - Shumë fëmijë rriten në mjerim dhe varfëri. Megjithatë, ka shumë fëmijë të cilët kanë aftësinë për të parandaluar, zvogëluar apo për të kapërcyer pasojat e mjerimit. Faktorët që janë të lidhur më aftësinë e fëmijëve të vegjël për t'u ripërtërirë, lidhen me praninë e të rriturve të besueshëm dhe përkujdesës, marrëdhënies dhe vetëdijes së fëmijës për arritjet e tij/saj, qëllimit dhe vetëvlerësimit, karakterit dhe përbërjes gjenetike të fëmijës (psh. dobësia ndaj ankthit, problemeve të shëndetit mendor), si dhe duke pasur njëri në jetën e tyre që u japin dashuri pa kushte.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve

Neni 2: Ti ke të drejtë të trajtohesh në mënyrë të barabartë pavarësisht se kush je, ku jeton, racës apo besimit fetar që i përket, nëse je djalë apo vajzë.

Neni 12: Ti ke të drejtë të shprehësh mendimin tënd. Ti ke të drejtë të thuash atë që mendon e ndien, dhe ke të drejtë që të rriturit të të dëgjojnë.

Neni 19: Ti ke të drejtë të ndihesh i sigurtë dhe i mbrojtur.

Ne mund të zhvillojmë aftësinë ripërtëritëse tek fëmijët duke qënë përkujdesës, mbështetës si dhe duke ofruar modele të dashura për ta. Ne mund dhe duhet të ndihmojmë fëmijët të njohin aftësitë dhe kapacitetin e tyre për të sjellë një ndryshim pozitiv në klasë ose në shtëpi që mund të zhvillojë vetë-vlerësimin, besimin dhe strukturën. Përmes dëgjimit, mbështetjes, udhëzimit, ndërtimit të vetëbesimit dhe duke u dhënë mundësi fëmijëve të jenë aktorë të fuqishëm, fëmijët mund të jenë pjesëmarrës aktiv në mjedisin e tyre dhe kjo mund të zhvillojë ripërtëritjen.

Pyetjet të mundshme për diskutim:

- Kujt i drejtohesh kur ke nevojë për ndihmë?
- A ka njëri të tjerë të cilët mund t'ju ndihmojnë dhe mbështesin?
- Kush ju bën të ndiheni të sigurtë?
- Kush ju ndihmon të kuptoni çfarë është e “duhur” dhe çfarë është e “gabuar”?
- Kush i vendos rregullat për ty? Çfarë rregullash duhet të ndjekësh?
- A të pëlqen të provosh gjëra dhe aktivitete të reja? Si ndihesh kur diçka nuk ecën ashtu si dëshiron?
- Si përballesh me gjërat kur ato nuk ecin ashtu sic dëshiron?
- A mund të më tregosh dy gjëra që të pëlqen të bësh?

- Në çfarë gjërash/veprimtarish mendoni se jeni të mirë?
- Çfarë gjërash të reja doni që të mësoni?

Aktivite për t'u zhvilluar në qendër

Diskutime/Gjuha/ Aktivite mbi Komunikimin

- Mësuesi mund të përdorë kukullën për të ndarë ndjenjat dhe përvojat. Kukulla u tregon fëmijëve se ndonjëherë është e frikësuar nga gjërat që ndodhin rreth e qark saj. Por, gjithmonë shkon te mami ose gjyshi për ndihmë. Për këtë, kukulla do të dijë se çfarë bëjnë fëmijët e tjerë kur ndihen të frikësuar. Kujt i drejtohen ata për ndihmë?
- Mund të nxisni secilin fëmijë t'i tregojë kukullës (ose të përshpërijë në veshin e kukullës) se çfarë bëjnë kur janë të frikësuar ose të mërzitur. Nëse një fëmijë nuk dëshiron të flasë, ai/ajo mund t'ja kalojë kukullën një fëmije tjetër.
- Fëmijët mund të flasin për familjet e tyre, ngjarje që ndodhin rreth e qark tyre, mbi atë çfarë ndodh në shkollë. Si e përballojnë situatën?
- Një aktivitetet tjetër mund të jetë kur kukulla u tregon fëmijëve një histori mbi një stuhi të fortë shiu. Stuhia lëkundit të gjithë shtëpinë. Ajo u frikësua. Por mendoi që mami dhe babi ishin në dhomën tjetër. Kështu ajo shkoi tek ata dhe së bashku mbyllën dritaret, derën dhe më pas u ulën të gjithë bashkë dhe tregonin histori mbi njeri-tjetrin. Ajo madje u tregoi prindërve një barcoletë (ki gati një barcoletë)!!!
- Kërkojini fëmijëve të ndajnë përvoja të ngjashme, si kanë reaguar dhe si kanë vepruar në rrethana të vështira. Nxisni reagimet e tyre dhe nxitini ata të mendojnë për mënyra të tjera se si mund të reagonin ata në situata të vështira, të tilla si: kur dikush është duke u zënë, kur ndodh një stuhi e madhe, kur dikush humbet, etj.

Tregimi i historive

- Është një mundësi e mirë për të përfshirë të gjithë anëtarët e komunitetit të cilët kanë kaluar situata të vështira. Ata mund të zhvillojnë biseda mbi këto situata dhe se si ata dhe fëmijët e tyre e kanë përballuar.
- Gjeni histori që flasin për fëmijë të cilët kanë mundur të zgjidhin problemet dhe të përballen me vështirësitë. Pas leximit të historisë, shihni se çfarë veprimesh dhe çfarë aftësish e kanë ndihmuar fëmijën të zgjidhë problemet. Shpesh herë, këto veprime përfshijnë thirrjen e dikujt për ndihmë, leximin e udhëzimeve, të ndihmuarit e fëmijëve, ose rrinë të qetë dhe presin që prindërit të kthehen në shtëpi.
- Zgjidhni histori ku fëmijët janë aktiv në eksplorimin e mjedisit tyre. Ju mund t'i kërkonit fëmijëve të zgjedhin vetë historinë që duan të dëgjojnë. Kjo i jep mundësi fëmijëve të ndihen udhëheqës dhe vendimmarrës. Sa më shumë që fëmijët të nxitin për veprime pozitive, aq më shumë kanë mundësi për zhvillimin e aftësive ripërtëritëse.
- Ndihmoni fëmijët të krijojnë librin e tyre me histori - 5 gjëra që mund të bëjnë dhe 5 gjëra që duan të mësojnë t'i bëjnë – njohja dhe vlerësimi aftësive të tyre është pjesë e ndërtimit të aftësisë për ripërtëritje.
- Bisedoni me fëmijët për kafshët shtëpiake, se si ato kanë nevojë t'i përqafosh, t'i përkëdhelësh, t'u flasësh dhe kur ndihen të pasigurta, ashtu si qëniet njerëzore, ata shkojnë te personat që kanë më shumë besim për të marrë kujdesje dhe mbrojtje, për

shembull në kohë bubullimash, vetëtimash ose zhurma të forta dhe se si më pas ato ndihen të sigurta dhe të forta sërish.

Aktivitete artistike

- Kërkojini fëmijëve të vizatojnë njerëzit dhe ngjarjet më të rëndësishme në jetën e tyre. Pyesni fëmijët t'ju tregojnë për këto persona, vende ose ngjarje. Pyesni fëmijën çfarë po bënte ose po mendonte gjatë kohës që ndodhnin ngjarjet.
- Emërtoni vizatimin e fëmijës për atë çfarë po tregon me fjalët e tij/saj. Pas emërimit, ndihmoni fëmijën të shpjegojë ndjenjat dhe mendimet e tij/saj në atë moment. Për shembull, nëse fëmija thotë, "Isha vetëm..." i rrituri mund të drejtojë pyetjen, "Si u ndjeve i lënë vetëm?" Ndhmojini fëmijën të shprehë ndjenjat e tij/saj përmes vizatimeve dhe asaj çfarë thonë. Mos i vini në dyshim përjetimet e tyre
- Kërkojini fëmijëve të vizatojnë momente kur ishin të lumtur dhe me dëshirë për të bërë diçka. Cilat janë aktivitetet më të preferuara? Me kë u pëlqen të rrinë? Si u pëlqen të kalojnë kohën? Pyesni fëmijët t'ju shpjegojnë atë çfarë po ndodh në vizatim. Shkruani atë që duhet të thotë fëmija. Vini në dukje momentin kur fëmija është në vetëkontroll. "Pra, u kënaqe duke lëvizur nëpër shtëpi?" "E dije shumë mirë çfarë të bëje kur po binte shi dhe ndaj hyre brenda për t'u ngrohur." Inkurajoni sjelljet dhe veprimet e tyre pozitive.

Lojëra

- Loja "Vigan Shkurtabiqi"...u jep mundësi fëmijëve të japin udhëzime fëmijëve me radhë. Lërimi t'a udhëheqin ata situatën dhe të jenë vendimmarrës.
- Mësues për një ditë. Çdo ditë caktoni një fëmijë si ndihmësin tuaj. Fëmija duhet t'ju ndihmojë të vendosni për aktivitetet që do të zhvillojnë fëmijët dhe do t'ju ndihmojë në klasë. Ky rol i ri i jep mundësi fëmijës të ndihet i kërkuar dhe i nevojshëm. Gjithashtu i zhvillon atij/asaj sensin e udhëheqjes dhe drejtimit. Të gjithë fëmijët duhet të jenë ndihmësi/a juaj për një ditë.

Pyetje për diskutim:

- Ku shkoni kur keni nevojë për ndihmë?
- A ka njerëz të tjerë që mund t'ju mbështesin dhe ndihmojnë?
- Kush ju bën të ndjeheni të sigurtë?
- Kush ju ndihmon të kuptoni atë që është e "drejtë" dhe e "gabuar"?
- Kush i vendos rregullat për ju? Cfarë rregullash duhet të ndjekësh?

1. UNË DHE MIQTË E MI: Ne e ndihmojmë njëri tjetrin ZINXHIRI i MIQËSISË

Materialet që nevojiten:

- Lapsa
- Gjashtë postera
- Shkumës
- Shirita letrash,(7.5 x 2.5 cm, një për çdo fëmijë)
- Shirit ngjitës
- Fletë e bardhë (një për çdo fëmijë)

Para sesionit, vendosi gjashtë postera në vënde të ndryshme në dysheme. Vizatoni një vizë ndërmjet posterave dhe vendosni një vizë “Fundit” pas posterit të fundit. Nëse keni oborr ose hapsirë të sigurtë jashtë kopështit, ju mund të bëni aktivitetin e “Fillimit” jashtë.

HAPI 1:

3. Kërkojini fëmijëve që të bëhen çift me njëri-tjetrin. Kërkojini çdo fëmijë që të kapet nga krahu me partnerin e tyre. Shpegoni se ata duhet të kërcejnë për të shkuar nga një poster në një poster tjetër. Me fëmijë më të rritur, ju mund t’i kërkoni çdo çifti që të ndalojë sa herë që arrijnë vizatimin/posterin dhe të thonë me zë të lartë një gjë që ai/ajo ka shumë dëshirë të bëjë me miqtë (psh. Të qeshë, të luajë, të këndojë, etj).
4. Pasi të gjithë të kenë arritur në vizën e “Fundimi”, kërkojini fëmijëve që të ulen në një rreth dhe pyesni:
 - Ishte e lehtë apo e vështirë që të arrijnë në vizën Fundit?
 - A mendoni se do të ishte më e lehtë apo më e vështirë për të arritur vizën e Fundit nëse shoku/shoqja juaj nuk do të kishte kërcyer bashkë me ju? Përse?

HAPI 2:

1. Kërkojini fëmijëve që të mbarojnë këtë fjali dhe jepi atyre disa shembuj që mund t’i ndihmojnë:
Unë kam shumë qejf kur miqtë e mi..... (psh. më përqafojnë, luajnë me mua, këndojnë me mua, më takojnë, etj).
2. Flisni rreth përgjigjeve të tyre dhe se çfarë pëlqejnë tek një shok/shoqe. Flisni rreth rëndësisë për të patur ato cilësi – psh. Nëse keni qejf miqtë që qeshin shumë, atëherë ju duhet të përpiqeni që të qeshni sa më shumë.
3. Bëni me dije fëmijët se ata do të formojnë zinxhirët e miqësisë me mikun/partnerin e tyre.
4. Jepi çdo fëmijë një shirit letre. Kërkojini atyre që të vizatojnë shokun/shoqen e tyre. Ndërkohë që ata vizatojnë, kërkojini fëmijëve që të ndajnë me partnerin e tyre se çfarë pëlqejnë tek njëri-tjetri.
5. Kur të kenë mbaruar, bëjni bashkë shiritat e çifteve si një zinxhir, duke i ngjitur fundet e shiritave me njëra-tjetrën për të krijuar një shirit.
6. Bëjeni këtë me pjesën tjetër të miqve/çifteve. Ju do të përfundoni me disa lidhje çiftesh.
7. Vareni zinxhirin e miqësisë në klasë.

Pyetje për reflektim

1. Kujtoni fëmijët se miqtë n' a ndihmojnë ne kur jemi të mërzitur, ata qeshin me ne dhe ata luajnë dhe zbulojnë gjëra të reja me ne.
2. Pyesni fëmijët:
Çfarë gjërash të tjera pëlqeni të bëni me miqtë tuaj
3. Kërkojini fëmijëve që të vizatojnë përgjigjet e tyre dhe të vendosin vizatimet e tyre në kutinë apo dosjen e tyre.

Personazhet kukulla

- Përdorni personazhet kukulla për të folur mbi rastet kur ata nuk dinë çfarë të bëjnë por përdorin mendjen e tyre për të vendosur se çfarë është e mirë dhe çfarë mund të jetë e rrezikshme;
- Personazhet kukulla mund të bisedojnë për momentet kur janë të hutuar, të frikësuar dhe nuk janë shumë të sigurtë për atë çfarë duhet të bëjnë. Pastaj ai/ajo kërkon mbështetje dhe mbrojtje nga mami ose babi ose dikush tjetër po aq i rëndësishëm;
- Personazheve kukulla u pëlqen të marrin dhe të japin përqafime ...ndjehen mirë kur ndjejnë që dikush i do. Po juve kush ju do? (Fëmijët mund të flasin për ata që do dhe që i duan. Kjo është një veprimtari e mirë që ju ndihmon të identifikoni fëmijët që mund të kenë problem në mjedisin familja)
- Personazhi kukull/kukulla marionetë ka një problem dhe do që fëmijët të dëgjojnë problemin e tij/saj dhe ta ndihmojnë për të gjetur zgjidhje ...atë e kanë ngacmuar kur po kthehej nga shkolla për në shtëpi, dikush e ka lënduar dhe ndonjëherë ndihet i/e vetmuar
- Fëmijët mund të japin alternativat e tyre për zgjidhje si dhe mund të dëgjojnë alternativat për zgjidhje që japin fëmijët e tjerë.
- Personazhi kukull/kukulla marionetë u tregon fëmijëve se të ndash me të tjerët ndjenjat dhe mendimet është diçka e mirë. Ne mund të ndihmojmë njeri tjetrin për të zgjidhur problemet. Ne duhet t' u kërkojmë ndihmë personave që duam dhe që i besojmë.

2. Une kam shume qejf kur....

8. Kërkojini fëmijëve që të mbarojnë këtë fjali dhe jepi atyre disa shembuj që mund t' i ndihmojnë:
Unë kam shumë qejf kur miqtë e mi..... (psh. më përqafojnë, luajnë me mua, këndojnë me mua, më takojnë, etj.
9. Flisni rreth përgjigjeve të tyre dhe se çfarë pëlqejnë tek një shok/shoqe. Flisni rreth rëndësisë për të patur ato cilësi – psh. Nëse keni qejf miqtë që qeshin shumë, atëherë ju duhet të përpiqeni që të qeshni sa më shumë.
10. Bëni me dije fëmijët se ata do të formojnë zinxhirët e miqësisë me mikun/partnerin e tyre.
11. Jepi çdo fëmije një shirit letre. Kërkojini atyre që të vizatojnë shokun/shoqen e tyre. Ndërkohë që ata vizatojnë, kërkojini fëmijëve që të ndajnë me partnerin e tyre se çfarë pëlqejnë tek njëri-tjetri.
12. Kur të kenë mbaruar, bëni bashkë shiritat e çifteve si një zinxhir, duke i ngjitur fundet e shiritave me njëra-tjetrën për të krijuar një shirit.
13. Bëjeni këtë me pjesën tjetër të miqve/çifteve. Ju do të përfundoni me disa lidhje çiftesh.
14. Vareni zinxhirin e miqësisë në klasë.

Pyetje për reflektim:

1. Kujtoni fëmijët se miqtë na ndihmojnë kur jemi të mërzhitur, ata qeshin me ne dhe ata luajnë dhe zbulojnë gjëra të reja me ne.
2. Pyesni fëmijët:
 - Çfarë gjërash të tjera pëlqeni të bëni me miqtë tuaj?

Kërkojini fëmijëve që të viztojnë përgjigjet e tyre dhe t'i vendosin në Kutinë apo Dosjen e tyre.

3. Unë mund të bëj gjithë këto gjëra

HISTORIA E LEPURIT DHE BRESHKËS

Materialet e Nevojshme:

- Tregimi: Lepuri dhe Breshka (Shtojca 2)
- 3 kuti
- Disa kopje të kartave të Talentit
- Çorape për të bërë kukulla (një çorape për çdo fëmijë)
- Bojëra uji (me dy ngjyra: jeshile dhe kafe)
- Letra në formë rrethi të vegjël (për sytë e kukullave prej çorapi)
- Ngjitës
- Kutitë të vogla kartoni dhe disa materiale mbështetëse (për aktivitetin shtesë)

Para se të fillojë ky sesion sigurohuni që të keni nga një çorape për çdo fëmijë dhe tre kuti. Vizatoni veten tuaj në një nga kutitë, në kutinë e dytë një pikturë të dy fëmijëve së bashku, në kutinë e tretë vizatoni pikturën e një fëmijë vetëm. Sigurohuni që të keni sa më shumë kopje të kartave të talentit në duar.

HAPI 1:

Kërkojini fëmijëve që të formojnë 2 grupe. Jepi çdo fëmijë nga një corap. Shpjegoni që ata do të dëgjojnë një histori për dy personazhe, “Lepurin” dhe “Breshkën”. Kërkojini njërit prej grupeve që të bëjnë një lepur me corape dhe një breshkë.

Shpërndani bojrat e ujit, letra rrumbullake, ngjitës dhe kërkojini fëmijëve që të ngjyrosin lepurin dhe breshkën e tyre që ata bënë me corape. Ata duhet të përdorin ngjyrën jeshile për breshkën dhe kafe ose të verdhë për lepurin. Për të ndihmuar fëmijët në vizatim, do të ishte mirë që të kishit figurën e breshkës dhe lepurit.

Nëse fëmijët janë shumë të vegjël, është më mirë që lepurit dhe breshka e bërë me corape të bëhen më parë dhe shpërndajeni tek fëmijët para se të fillojë aktiviteti.

Pasi të kënë mbaruar, kërkojini fëmijëve që të veshin kukullat - corape dhe të lëvizin sa herë dëgjojnë emrin e personazhit që kanë veshur.

HAPI 2:

1. Kur ata të mbarojnë, kërkojini fëmijëve të vendosin në duar kukullat-çorape dhe t'i lëvizin ata sa herë që karakteri i tyre flet.
2. Lexoni për fëmijët historinë mbi “Lepurin dhe Breshkën”.
3. Pasi të keni mbaruar së lexuari historinë, pyesni fëmijët:
 - Ku ndryshojnë dhe ku janë të ngjashme lepuri me breshkën? Ku ndryshonin? Ku ishin të ngjashëm?
 - Si mundi të fitonte garën breshka?
 - Përmendni diçka që lepuri e bënte shumë mirë. Po breshka? A kishte diçka që ajo e bënte shumë mirë?
4. Prezantojini fëmijëve konceptin e talenteve. Talentet janë aftësi të veçanta që ka secili prej nesh, diçka që ne e bëjmë shumë mirë. Ne mund të kemi talent për të kënduar, kërcyer, për të vizatuar, për t'i rënë një instrumenti muzikor, etj.
5. Shpjegojini fëmijëve që në të gjithë kemi ngjashmëri dhe gjithashtu jemi të ndryshëm, njësoj si lepuri dhe breshka. Diskutoni me fëmijët në lidhje me ngjashmëritë dhe ndryshimet që ata kanë me miqtë e tyre dhe lidheni këtë me talentet që ata kanë dhe gjërat që bëjnë më mirë.

HAPI 3:

1. Kërkojini fëmijëve që të ulen në një rreth
2. Vendosni tre kutitë dhe kopjen e kartave të talenteve në mes të rrethit. Shpjegojini fëmijëve që ata duhet të zgjedhin një kartë që tregon një talent që ata kanë t'a vendosin në kutinë ku është vizatuar fugura juaj. Nëse fjala “talent” është shumë komplekse apo e vështirë për t'u kuptuar, zëvendësojeni me “gjërat që ju i bëni më mirë”. Për t'i ndihmuar, jepuni atyre disa shembuj duke i pyetur:
 - Kush është talenti me i madh që kam unë sipas mendimit tuaj? është
 - A mendoni se unë jam guximtar/e?
 - A mendoni se unë mund të këndoju? E kështu me rradhë.
3. Ndërkohë që ata vendosin kartat në kuti, pyesni fëmijët se përse ai/ajo mendon se ky është talenti juaj.
4. Më pas, kërkojini atyre që të zgjedhin një kartë që përfaqëson talentin e shokut/shoqes së tij/saj dhe ta vendosin tek kutia ku janë të vizatuar dy fëmijë. Ndërkohë shpjegoni se përsë është një talent shoku/shoqe.
5. Më në fund, kërkojini a tyre që të bëjnë të njëjtën gjë me talentet e tyre dhe ta vendosin kartën në kutinë ku ka të vizatuar një fëmijë në të.
6. Shpjegojini fëmijëve që ndryshimet që ne kemi na bëjnë unik dhe ngjashmëritë që kemi na japin diçka për t'a ndarë më njëri-tjetrin. Shtoni edhe rëndësinë që ka njohja e talenteve të shokëve dhe shoqeve.

Pyetje për reflektim:

1. Këndoni këngën “Ku është...” por këtë herë përdorni edhe fjalët “lepuri” dhe “breshka” në vargje. Kërkojini fëmijëve që të veshin në duart e tyre corapet e vizatuara si lepuri dhe breshka dhe dëgjojini ndërsa ata këndojnë këngën.

Edukatori/a: “Kush është lepuri? Ku është lepuri?” (Ndërkohë kërkojini fëmijëve të tregojnë çorapin - lepur që kanë në dorë.)

Fëmijët: “Ja ku jam, ja ku jam.”

Edukatori/a: “Si jeni këtë mëngjes?”

Fëmijët: “Shumë mirë, faleminderit.”

Edukatori/a: “Përshëndesni me dorë, përshëndesni me dorë.”

2. Përsërsini të njëjtën gjë me fëmijët për breshkën.
3. Pasi të mbaroni, ndihmojini fëmijët që të vendosin emrin e tyre në corape dhe vendosini corapet në kutinë e dosjen e tyre.

Diskutime/Gjuha/Aktivitete mbi Komunikimin

- Edukatorja mund të përdorë një Personazh Kukull që ka frikë për të ndarë ndjenjat dhe përvojat. Personazhi kukull do t’i thotë fëmijëve se si ajo ndjehet dhe se çfarë bën kur ka frikë psh: ai/ajo gjithmon shkon te mami i tij/saj ose tek gjyshi i cili e ndihmon gjithmonë. Ai/ajo do të dijë se çfarë bëjnë fëmijët e tjerë kur frikë?
- Mund të nxisni secilin fëmijë t’i tregojë kukullës (ose të përshpërijë në veshin e kukullës) se çfarë bëjnë kur janë të frikësuar ose të mërzitur. Nëse një fëmijë nuk dëshiron të flasë, ai/ajo mund t’ja kalojë kukullën një fëmije tjetër.
- Fëmijët mund të flasin për familjet e tyre, ngjarje që ndodhin rreth e qark tyre, mbi atë çfarë ndodh në shkollë. Si e përballojnë situatën?
- Një aktivitetet tjetër mund të jetë kur kukulla u tregon fëmijëve një histori mbi një stuhi të fortë shiu. Stuhia lëkundit të gjithë shtëpinë. Ajo u frikësua. Por mendoi që mami dhe babi ishin në dhomën tjetër. Kështu ajo shkoi tek ata dhe së bashku mbyllën dritaret, derën dhe më pas u ulën të gjithë bashkë dhe tregonin histori mbi njeri-tjetrin. Ajo madje u tregoi prindërve një barcoletë (ki gati një barcoletë)!!!
- Kërkojini fëmijëve të ndajnë përvoja të ngjashme, si kanë reaguar dhe si kanë vepruar në rrethana të vështira. Nxisni reagimet e tyre dhe nxitini ata të mendojnë për mënyra të tjera se si mund të reagonin ata në situata të vështira, të tilla si: kur dikush është duke u zënë, kur ndodh një stuhi e madhe, kur dikush humbet, etj.

Tregimi i historive

- Është një mundësi e mirë për të përfshirë të gjithë anëtarët e komunitetit të cilët kanë kaluar situata të vështira. Ata mund të zhvillojnë biseda mbi këto situata dhe se si ata dhe fëmijët e tyre e kanë përballuar.
- Gjeni histori që flasin për fëmijë të cilët kanë mundur të zgjidhin problemet dhe të përballen me vështirësitë. Pas leximit të historisë, shihni se çfarë veprimesh dhe çfarë

aftësish e kanë ndihmuar fëmijën të zgjidhë problemet. Shpesh herë, këto veprime përfshijnë thirrjen e dikujt për ndihmë, leximin e udhëzimeve, të ndihmuarit e fëmijëve, ose rrinë të qetë dhe presin që prindërit të kthehen në shtëpi.

- Zgjidhni histori ku fëmijët janë aktiv në eksplorimin e mjedisit tyre. Ju mund t'i kërkonti fëmijëve të zgjedhin vetë historinë që duan të dëgjojnë. Kjo i jep mundësi fëmijëve të ndihen udhëheqës dhe vendimmarrës. Sa më shumë që fëmijët të nxiten për veprime pozitive, aq më shumë kanë mundësi për zhvillimin e aftësive ripërtëritëse.
- Ndhmoni fëmijët të krijojnë librin e tyre me histori - 5 gjëra që mund të bëjnë dhe 5 gjëra që duan të mësojnë t'i bëjnë – njohja dhe vlerësimi aftësive të tyre është pjesë e ndërtimit të aftësisë për ripërtëritje.
- Bisedoni me fëmijët për kafshët shtëpiake, se si ato kanë nevojë t'i përqafosh, t'i përkëdhelësh, t'u flasësh dhe kur ndihen të pasigurta, ashtu si qëniet njerëzore, ata shkojnë te personat që kanë më shumë besim për të marrë kujdesje dhe mbrojtje, për shembull në kohë bubullimash, vetëtimash ose zhurma të forta dhe se si më pas ato ndihen të sigurta dhe të forta sërish.

Lojra krijuese

- Imagjinoni sikur jeni në një xhungël dhe po dëgjoni shumë zëra rreth jush. Jeni duke ecur me një grup fëmijësh dhe me mësuesin tuaj. Çfarë do bëni? Këtu mësuesja mund të ndihmojë fëmijën të imagjinojë çfarë kafshësh mund të ketë në xhungël... është luan apo mace, është qen apo ujk? Edhe në xhungël ne mund të jemi të sigurtë nëse qëndrojmë në grup, nëse ndjekim të rriturit dhe nëse jemi dëgjuar të vëmëndshëm
- Gjatë natës ka pasur stuhi. Kur zgjoheni shihni që çdo gjë ka lëvizur dhe gjërat janë bërë pis. Çfarë mund të bëni për të ndihmuar? Imagjinoni sikur ju po rregulloni rrëmujën. Çfarë duhet të bëj secili? Çfarë mjetesh ju duhen? Si mund t'i rregulloni gjërat? Kush mund t'ju ndihmojë?

Aktivite Praktike

- Fëmijët mund të luajnë një lojë me role duke imituar profesione të rëndësishme dhe duke bërë

detyrat që ka secili profesion. Zhvilloni një bisedë pse këto profesione janë kaq të rëndësishme për fëmijët ose për të rriturit; psh mjekë/infermiere ose kryeplak fshati që bëjnë të mundur që të gjithë të kenë ushqim ose një shtëpi.

4. YLLI I DËSHIRAVE

Materialet e Nevojshme:

- Lepuri dhe breshka të bëra me corape
- Kartat e Aftësive të Fëmijës
- Prerje figurash situatash/punë të ndryshme
- Prerja e fletëve të bardha në formë yjesh (një për çdo fëmijë)
- Fije spangoje (një për çdo fëmijë)
- Lapsa me ngjyra
- Ngjitës lëng
- Ngjitëse letër
- Ftesë për çdo fëmijë (për aktivitetin shtesë)

HAPI 1:

1. Kujtojini fëmijëve historinë e Lepurit dhe Breshkës nga aktiviteti 18. Kërkojini fëmijëve që të (retrive) marin kukullat e tyre të bëra me corape nga Kutia e Udhëtimit Aflatun, më pas kërkojini që t'i vendosin ato në duart e tyre.
2. Vizatoni një Vizë në fund të klasës.
3. Shpjegojini fëmijëve që do të bëni garën e Lepurit dhe Breshkës: Kërkojini fëmijëve që kanë çorapet në formën e breshkës/me të cilat po luajnë rolin e breshkës që tëzvarritendrej fundit Vizës në fund të dhomës, ndërsa ata që luajnë rolin e lepurit të shkojnë drejt fundit të fizës duke kërcyer hopthi-topthi.
4. Kur fëmijët të arrijnë Vizën në fund, pyesni ata se kushështë talenti më i madh që kanë, apo çfarë bëjnë më mirë ata. Jepni shembuj duke përdorur kartat e Talentit Aflatun.
5. Shpjegojini fëmijëve që ju do të eksploroni më shumë detaje për të zbuluar talentet e tyre dhe se çfarë mund të bëjnë ata me këto talente.

HAPI 2:

1. Shpjegojini fëmijëve që duke ditur se çfarë bëjnë më mirë ata, është më e lehtë për të realizuar ëndrrat që kanë. Pyesni fëmijët se çfarë duan të bëhen ata kur të rriten. Jepni disa shembuj.
2. Jepi çdo fëmijë një yll të bardhë dhe një fije spango. Thuajini fëmijëve që ylli simbolizon ëndrrën e tyre.
3. Kërkojini fëmijëve që të shohin tek figurat e prera më parë dhe midis tyre të zgjedhin ëndrrën apo punën që ata duan të bëjnë kur të rriten.
4. Ndihmojini fëmijët që të ngjisin në yjet e tyre, figurën/at që prenë, shkruani emrin e tyre nga pas yllit dhe më pas ngjiteni yllin e çdo fëmijë tek fija e spangos duke përdorur ngjitësen.

Pyetje për reflektim:

1. Kërkojini fëmijëve që të ndajnë punën e tyre me pjesën tjetër të klasës. Varini yjet aty ku fëmijët kanë mundësi t'i shohin çdo ditë.
2. Thuajini fëmijëve që yjet e tyre janë aty në mënyrë që ata të mendojnë se çfarëëndërrojnë të bëhen kur të rriten. Theksojini atyre se, me talentin që ata kanë, me shumë punë dhe shumë dedikim, ata do të jenë të aftë të arrijnë qëllimet e tyre.

Në aktivitetin tjetër, ju do të organizoni një Shou/Koncert me Talente me fëmijët dhe nëse është e mundur, ju do të ftoni familjen e fëmijës dhe miqtë që të vijnë dhe të shohin shfaqjen e talenteve/koncertin.

Për këtë arsye, gjatë përgatitjes për këtë aktivitet, jepini çdo fëmijë një letër - ftesë dhe e cila jep informacion të detajuar në lidhje me shoun/koncertin. Kërkojini fëmijëve që të zbukurojnë letrën e tyre dhe t'ua japin prindërve. Ju mund të përdorni modelin e figurës si shembull.

Dërgojini prindërve nga një letër dhe kërkojini atyre që të shkruajnë një letër për djalin/vajzën e tyre me titull "Ëndrrat e mia për Ty". Kërkojini prindërve që t'ia lexojnë letrën fëmijës së tyre dhe kërkojini fëmijëve që këtë letër ta vendosin te kutia apo dosja e tyre.

Kërcimi dhe muzika

Tregojini fëmijëve muzikë të llojeve të ndryshme; muzikë të shpejtë, muzikë të qetë, muzikë që kërcëhet lehtë. Thuajini fëmijëve të zgjedhin çfarë muzike duan të dëgjojnë. Lëri ata të dëgjojnë muzikën që duan. Më pas vendos muzikë të qetë. Thuajini të mbyllin sytë dhe të

mendojnë për vende të qeta, të tilla si fusha të gjelbërta, oqean, shumë pemë, një kënd lojërash. Merrni frymë thellë, mbyllni sytë dhe qetësohuni. Si ndiheni tani?

Llojet e muzikës që tregojnë stuhi ose erë mund të përdoren me fëmijët që ata të përjetojnë edhe njëherë si janë ndjerë ose se si pemët do të shtyheshin dhe tërhiqeshin në drejtime të ndryshme dhe pasi stuhitë mbarojnë, pema qëndron përsëri e drejtë dhe e gjatë. Ju mund të bëni të njëjtën gjë, por të duhet të gjeni muzikë e cila të jep ndjesinë e dallgëve të forta, duke lundruar pa mbështetje – çfarë ndodh pas qetësimit të ujërave.

5. KONCERTI I TALENTEVE

Materialet e Nevojshme:

- Kartat e Koncertit të Talenteve
- Materiale artistike për të bërë objekte skene
- Prerje figurash situatash/punë të ndryshme
- Lapsa
- Ngjitës lëng
- Letër për ftesat
- Shirita “Të lumtë” për çdo fëmijë
- Letër (për kostumet – zgjedhje alternative)

HAPI 1:

1. Filloni duke informuar fëmijët se ky aktivitet do të jetë me të vërtetë i veçantë.
2. Pyesni ata:
 - Çfarë mendoni se është një “Spektakël për Aftësitë e Fëmijëve”?
3. Kujtojini fëmijët për historinë e “Lepurit dhe Breshkës” dhe më pas pyesni ata:
 - A e mbani mend se kush ishte talenti i lepurit?
 - A e mbani mend se kush ishte talenti i breshkës?
4. Mbani mend se talentet janë gjëra të veçanta të cilat ne i bëjmë shumë mirë. Ne mund të ndajmë talentet tona me familjarët dhe miqtë tonë për t’i bërë ata të lumtur dhe krenarë për ne. Ne gjithashtu duhet të vlerësojmë talentet e të tjerëve, si përshembull guzhinieri/ja në kopështin tonë që gatuan gjithmonë ushqim të mrekullueshëm.
5. Tregojini fëmijëve se sa e mrekullueshme do të ishte që ata të mund të tregonin gjithkujt gjërat që bëjnë më mirë, dhe mënyra më e mirë për t’u bërë këtë gjë është “Spektakli i Talenteve”.
6. Bëjini fëmijët që si grup, të planifikojnë se çfarë duhet të kenë për Spektaklin e Aftësive të Fëmijëve. Shpjegoni se ky është një spektakël ku ata mund t’i ndajnë talentet e tyre me shokët dhe shoqet e grupit, familjarët dhe lehtësuesit/edukatorët.
7. Ndani fëmijët në tre grupe. Jepini çdo grupit tre alternativat e mëposhtme të spektakleve dhe kërkojini atyre që të zgjedhin një. Jini të lirë që të bëni sygjerimet e nevojshme sipas grupit që keni.
8. Pasi çdo grup të ketë vendosur se çfarë spektakli do të bëjnë, ndihmojini ata që të bëjnë prova e performancës së tyre në klasë. Para spektaklit të talenteve, vendosni punë ekstra për fëmijët. Punët do të jenë:
 - Vendosja e objekteve skenike.
 - Vendosja e karrigeve.
 - Përgatisin fëmijët që do të performojnë (me ndihmën e lehtësuesit/edukatores).

- T'i tregojnë të ftuarve se ku mund të ulen (shoqëruesit).
- Prezantimin e Spektaklit (sigurisht me ndihmën e lehtësuesit/edukatores).
- Përgatisin biletat për Spektaklin e Talenteve (fëmijët më të rritur).

HAPI 2:

1. Filloni Koncertin e Talenteve duke i uruar mirëseardhjen prindërve/miqve të cilët kanë ardhur për të marrë pjesë.
2. Falenderoni fëmijët për përpjekjet që kanë bërë në krijimin e Spektaklit të Talenteve dhe lejoni prezantuesin/en të prezantojë fëmijët që do të performojnë.
3. Pas kësaj, lëreni skenën për fëmijët dhe jepini mundësi atyre të tregojnë talentet që kanë.

Pyetje për Reflektim:

1. Pas spektaklit pyesni fëmijët:
 - Si u ndjetë kur ndatë me familjen tuaj talentet që keni?
2. Përforconi se sa e admirueshme ishte fakti që ata i treguan njerëzve talentet e tyre dhe ndihmën që dhanë për të përgatitur spektaklin.
3. Jepini atyre një shirit “Të lumtë” për punën e bërë.
4. Kërkojini atyre që të vendosin shiritat “Të Lumtë” në kutinë apo dosjen e tyre.

AKTVITET ME FAMILJEN

FTESA PËR NË KONCERTIN E TALENTEVE

Kërkojini disa prindërve nëse edhe ata duan që të tregojnë talentin e tyre gjatë Spektaklit të Talenteve. Ata kanë nevojë të parapërgatiten për këtë gjë dhe gjithësecili duhet të ketë një program të detajuar të aktivitetit në mënyrë që t'a dinë se kur do të performojnë.

KONCERTI YNË I TALENTEVE!

I/E dashur _____,

Ne po organizojmë një Spektakël Talentesh në _____ (data)!

Ne ju ftojmë që të n'a bashkoheni dhe të gëzoni me ne në këtë ditë të veçantë!

DATA:

ORA:

VËNDI:

Për më shumë informacion ju lutem kontaktoni, _____

Ju presim në spektaklin tonë!

Me konsideratë, _____

6. HISTORIA E LUANIT DHE MIUT

HAPI 1:

1. Kërkojini fëmijëve që të ulen në atë mënyrë që ata të shohin vizatimet në librin e historisë.
2. Tregojini fëmijëve figurën e luanit, dhe më pas pyesni ata:
 - *A keni parë ndonjëherë ndonjë luan?*
 - *A e dini se çfarë tingulli bën luani?*
 - *Po miu si bën?*
3. Lexojini fëmijëve historinë e “*Luani dhe Miu*” (Shtojca 4)
4. Kur të mbaroni, pyesni fëmijët:
 - A ishte e lehtë për luanin dhe miun që të bëheshin miq që në fillim?
 - Si u bënë ata miq?
 - Çfarë bëjnë miqtë për njëri-tjetrin
 - A i bëni edhe ju këto gjëra për miqtë tuaj?
 - Çfarë gjërash bëni ju me miqtë tuaj?

HAPI 2:

1. Shpjegojini fëmijëve që do të lexoni disa thënie rreth atyre gjërave të mira që miqtë bëjnë për njëri-tjetrin.
2. Kërkojini fëmijëve që të ulërijnë\ bëjnë me zë të lartë siç bën luani nëse ata mendojnë se ajo që po thoni ju është e saktë, dhe të bëjnë si mi në rast se ata mendojnë se ju e keni gabim.
3. Lexoni me zë një e nga një thënie e mëposhtme:
 - Miqtë i ndajnë gjërat me njëri tjetrin.
 - Miqtë ju ndihmojnë të bëni gjëra që s’duhet t’i bëni.
 - Miqtë nuk e ndihmojnë njëri-tjetrin.
 - Miqtë luajnë bashkë.
 - Miqtë i gjuajnë njëri-tjetrin.
 - Miqtë të ngrëjnë humorin kur ju jeni i/e mërziur.
4. Jepi çdo fëmijë nga një copë letër dhe kërkojini atyre që të vizatojnë shokun/shoqen i/e tyre më të mirë. Kjo punë do të quhet: “Unë dhe shoku/shoqja ime i/e ngushtë”.
5. Kërkojini fëmijëve që të vendosin emrin e tyre poshte vizatimit dhe ta vendosin vizatimin tek kutia apo dosja e tyre.

Pyetje për reflektim:

1. Thuajini fëmijëve që ata do të luajnë një lojë tjetër.
2. Kërkojini fëmijëve që të japin nga një shembull se çfarë do të donin të bënin me shoqet/shokët e tyre. Kujtojini fëmijëve që shoku/shoqja e tyre është i/e mirë, ai/ajo kujdeset për ata, ai/ajo ka shumë dëshirë që të luajë dhe zbulojë gjëra të reja me ata.
3. Tani, kërkojini fëmijëve që të luajnë lojë me pantonime (mime) veprimet e mëposhtme:
 - Duke shëtitur me miqtë e tyre.
 - Duke ndihmuar një mik që të ngrihet nga dyshemeja.
 - Duke ndihmuar një mik që të ujisë lulet.
4. Me fëmijë më të rritur kërkojini atyre që të gjejnë një partner dhe të luajnë lojë me role sipas situatave të mësipërme dhe njëri prej fëmijë duke bërë rolin e Aflatunit.

Aktivitete artistike

- Kërkojini fëmijëve të vizatojnë njerëzit dhe ngjarjet më të rëndësishme në jetën e tyre. Pyesni fëmijët t'ju tregojnë për këto persona, vende ose ngjarje. Pyesni fëmijën çfarë po bënte ose po mendonte gjatë kohës që ndodhnin ngjarjet.
- Emërtoni vizatimin e fëmijës për atë çfarë po tregon me fjalët e tij/saj. Pas emërimit, ndihmoni fëmijën të shpjegojë ndjenjat dhe mendimet e tij/saj në atë moment. Për shembull, nëse fëmija thotë, "Isha vetëm..." i rrituri mund të drejtojë pyetjen, "Si u ndjeve i lënë vetëm?" Ndhmojeni fëmijën të shprehë ndjenjat e tij/saj përmes vizatimeve dhe asaj çfarë thonë. Mos i vini në dyshim përjetimet e tyre
- Kërkojini fëmijëve të vizatojnë momente kur ishin të lumtur dhe me dëshirë për të bërë diçka. Cilat janë aktivitetet më të preferuara? Me kë u pëlqen të rrinë? Si u pëlqen të kalojnë kohën? Pyesni fëmijët t'ju shpjegojnë atë çfarë po ndodh në vizatim. Shkruani atë që duhet të thotë fëmija. Vini në dukje momentin kur fëmija është në vetëkontroll. "Pra, u kënaqe duke lëvizur nëpër shtëpi?" "E dije shumë mirë çfarë të bëje kur po binte shi dhe ndaj hyre brenda për t'u ngrohur." Inkurajoni sjelljet dhe veprimet e tyre pozitive.

KAPITULLI 9

FAMILJET DHE KOMUNITETET

Vendi ku jetoj - Familja dhe Komuniteti

HYRJE

Këndvështrimi fëmijëve - Fëmijët jetojnë të rrethuar nga të rriturit dhe ndonjëherë dhe nga fëmijë të tjerë, të cilët i duan dhe kujdesen për ta. Ky është kuptimi familjes.

Këndvështrimi të rriturve - (Është e rëndësishme që një i rritur të jetë i ndjeshëm ndaj gjëndjes familjare të fëmijës).

Fëmijët rriten në lloje familjesh të ndryshme dhe komunitete të larmishme. Marrëdhëniet familjare janë përvojat më të rëndësishme për fëmijët dhe ato kanë një ndikim të veçantë në zhvillimin e tyre social dhe emocional. Përvojat që kalojnë fëmijët në moshën e hershme kanë ndikim të dukshëm në zhvillimin e trurit të njeriut. Në raste konfliktesh, familjet mund të ndahen dhe rrethi kujdesit për fëmijën mund të thyhet. Familjet e gjëra, komunitetet e sigurta, të rritur model pozitiv, mësues përkujdesës janë ata për të cilët kanë nevojë fëmijët e vegjël në zhvillimin e përkatësisë dhe lidhjes. Është e rëndësishme të zhvillohet ndjenja komunitare që në vitet e hershme si dhe të ndihmohen fëmijët të shprehin ndjenjat e tyre, të mësojnë të jenë të ndjeshëm, të gjejnë mënyra alternative për zgjidhjen e konfliktit dhe të respektojnë diversitetin. Edukimi hershëm i fëmijës mbështetet në edukatën e familjes, dhe nëse prindërit dhe mësuesit punojnë së bashku në një ambjent respekti reciprok, fëmija do të ndiheshte më pozitiv dhe me besim në vetvete.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve

Neni 9: Ti ke të drejtë të jetosh në një familje e cila kujdeset për ty

Puna me Familjet

Puna me prindërit është e rëndësishme nëse duam që puna me fëmijët të jetë efektive. Kur profesionistët dhe prindërit punojnë së bashku, rezultatet kanë një ndikim pozitiv në zhvillimin dhe të mësuarin e fëmijëve. Marrëdhëniet duhet të jenë kuptimplota, të vërteta dhe me respekt të ndërsjelltë.

Të mirat e punës me familjet

- Fëmijët ndihen të sigurtë dhe pozitiv për veten kur prindërit dhe profesionistët punojnë së bashku në një atmosferë respekti të ndërsjelltë;
- Prindërit/kujdestarët e dinë cila është më e mira për fëmijën e tyre;
- Puna që bëjnë prindërit/kujdestarët me fëmijët në shtëpi ka një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e tyre emocional, social dhe intelektual;
- Pavarësisht prejardhjes sociale, prindërit/kujdestarët mund të nxisin zhvillimin e fëmijës tyre
- Ajo çfarë bën prindi/kujdestari për fëmijën është më e rëndësishme se sa pozita shoërore e prindit/kujdestarit;

Ndikimi është i dukshëm në të gjitha grupet sociale dhe etnike.

Disa këshilla praktike në punën me familjet

- Përfshini familjet në një komunikim të ndërsjelltë;
- Ndërtoni vetëbesimin e prindërve mbi atë çfarë bëjnë dhe jepni mbështetjen tuaj që ata të zhvillohen më tej;
- Mos bëni hamendësime për prindërit;
- Dëgjoni prindërit si individë dhe kushtojini kohë që të njihni të gjithë familjen. Vlerësoni pikëpamjet e tyre.
- Pyesni prindërit se çfarë aktivitete apo informacionesh kanë qënë të dobishme për ata dhe për çfarë kanë nevojë më shumë;
- Qendrimet e fëmijëve ndaj diversitetit ndikohen nga sjellja e të rriturve që janë rreth e qark tyre. Të gjitha familjet duhet të mirëpritën dhe vlerësohen.
- Buzëqeshja jote e përshëndetjes për prindërit, u tregon atyre që janë të mirëpritur.
- Profesionistët duhet të mendojnë si i përqrasen familjeve. Shpesh dëgjojmë se sa e vështirë është të arrish prindërit, por profesionistët duhet të bëjnë të pamundurën për t'ju treguar prindërve që ata janë aty për ta
- Stafit duhet të jetë fleksibël dhe në gjendje të përballet me kthesat e jetës së përditshme familjare. Nëse prindërit kanë nevojë për më shumë mbështetje sidomos në situatë konflikti, stafi duhet të ketë burimet dhe njohuritë për ti referuar aty ku duhet.
- Përfshini prindërit/kujdestarët në punën tuaj me fëmijët për ndërtimin e paqes, në mënyrë që ata të mbështesin fëmijën në shtëpi

Prindërit ndihen të vlerësuar nëse:

- Mirëpritën ngrohtësisht dhe me sinqeritet
- Ata nuk shohin që prindërit e tjerë trajtohen më mirë se ata
- Stafit e njeh shumë mirë fëmijën e tyre dhe tregon interes të sinqertë për të
- Stafit ndan me ta njohuritë/ekspertizën e tyre dhe i mbështesin ata në angazhimin me fëmijën në shtëpi;
- Stafit shkëmben informacion për fëmijën në mënyrë të rregullt
- Ka komunikim të ndërsjelltë dhe prindërit ndjehen që zëri tyre dëgjohet

Puna me komunitetet

Zhvillimi komunitetit përshkruhet si një qasje që rrit mundësitë për pjesëmarrje, ndarje të aftësive, zhvillon vetëmbështetje, siguron zotërimin e zonës dhe përdor burime lokale për të zgjidhur çështje të lokale.

Nëse u jepet mbështetje komuniteteve lokale, ata do të jenë në gjendje të identifikojnë vetë prioritetet për fëmijët dhe si ti trajtojnë ato në situata konflikti dhe pas konflikti.

Përfitimet e qasjes së zhvillimit të komunitetit

- Ka potencialin të nxisë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe ndërmarrjen e përgjegjësive në interesin më të mirë të fëmijëve;
- Çështjet identifikohen nga vetë komuniteti, dhe jo nga agjenci/organizata të jashtme;
- Aftësitë, njohuritë dhe mendimet e anëtarëve të komunitetit merren në konsideratë gjatë marrjes së vendimeve dhe u jep zë grupeve të marginalizuara (njëherë të dëbuar; refujatë; viktimat të prekur nga konfliktet; fëmijë të vegjël; gratë; njëherë pa atdhe...)
- Sjellja në vëmendje e zhvillimit të fëmijërisë së hershme, mund të ndihmojë në kapërcimin e konflikteve në komunitete dhe midis tyre, drejt një kohezioni;
- Puna me komunitetet përfshin ndërtimin e besimit, ngritjes së vetëbesimit dhe vetëvlerësimit të të gjithë anëtarëve të komunitetit.

Disa këshilla praktike në punën me komunitetet

- Ndihmojini ata të krijojnë hapësira të sigurta për fëmijët në komunitet;
- Ndihmojini ata të identifikojnë burimet egzistuese në komunitete, çfarë funksionon dhe si të ndërtoni mbi aspektet pozitive në vend që të fokusoheni në aspektet negative;
- Në situata pas konflikti, ndihmojini ata të identifikojnë se çfarë projektesh dhe aktiviteteve mund të zbatohen me përfshirjen e komuniteteve të konfliktuara ose të ndara;
- Mund të filloni biseda në grupe të vogla. Një grup i vogël prindërisht mund të takohen për të ndarë mendime mbi rritjen e fëmijëve në komunitet dhe mbrojtjen e tyre;
- Ndihmon të kuptosh se çfarë u intereson njëherë dhe si angazhohen për të sjellë ndryshime;
- Anëtarët e komuniteteve janë në pozitë më të mira për t'u dhënë zë nevojave të tyre;
- Filloni me hapa të vegjël veprimi dhe gëzojuni sukseseve për të marrë energji për ndryshime pozitive

Pyetje të mundshme për diskutim:

- A mund të na tregosh se ku jeton dhe me kë jeton?
- A ke motra dhe vëllezër?
- A ke gjyshër, daja/xhaxhallarë, teze/halla, kushërinj?
- Çfarë gjërash ju pëlqen të bëni me familjen tuaj ose me njëherë me të cilët jetoni?
- Në çfarë vendesh ju pëlqen të shkoni në komunitetin tuaj dhe pse?

- Si mund të ndihmojnë ne të bëjmë komunitetet tona një vend të duhur për të luajtur dhe për të jetuar në të?
- Si mund t’u tregojmë anëtarëve të familjes sonë/njerëzve me të cilët jetojmë që i duam?
- Çfarë të pëlqen në kopësht/shkollë?
- Çfarë aktivitete të pëlqejnë në kopësht/shkollë?
- A ka ndonjë gjë që s’të pëlqen nga kopështi/shkolla?
- A ke shok/shoqe në kopësht/shkollë?
- Si mund t’ja tregojmë shokëve/shoqeve në kopësht/shkollë që i kemi xhan?
- Çfarë gjërash mund të bëjmë në kopësht/shkollë për ta bërë një vend të bukur për të gjithë?

Aktivite Praktike

1. UNË MUND TË REALIZOJ ËNDRRAT E MIA

Materialet e Nevojshme

- Një top,
- Yje të përgatitura më parë,
- Fletë të bardha të prera në formë ylli (një për cdo fëmijë)
- Lapsa me ngjyra,
- Ngjitës (mundësisht të lëngshëm)

Përpara se të filloni që të zhvilloni këtë aktivitet, sigurohuni që të keni mjaftueshëm Yjet e Ëndrrave, të përgatitura më parë nga prindërit e fëmijëve. Ky aktivitet ka të bëjë me dëshirat dhe talentet e fëmijëve për të cilat ata kanë diskutuar edhe më parë.

HAPI 1:

1. Pyesni fëmijët nëse e mbajnë mend historinë e “Lepurit dhe Breshkës”. Kërkojini disa prej tyre që ta ri-tregojnë atë.
2. Më pas, pyetini fëmijët nëse e mbajnë mend se çfarë ishin talentet dhe pse janë të rëndësishme për ne që t’i njohim ato. Kujtojuani atyre, që talentet janë gjëra që na bëjnë në të veçantë dhe unik dhe që na dallojnë ne nga të tjerët. Talentet janë ato gjëra që ne dimë t’i bëjmë më mirë, si për shembull të kënduarit, të kërcyerit, të vrapuarit, të vizatuarit apo të qënurit i duruar. Shpjegojuni gjithashtu fëmijëve që talentet që secili nga ne ka na ndihmojnë për të realizuar ëndrrat tona.
Për shembull dikush që ka talent dhe është me të vërtetë i mirë që të tregojë aftësi për të ndihmuar të tjerët, do ta ndihmonte atë që mundësisht më vonë të përmbushë ëndrrën e tij/e saj për t’u bërë një zjarrfikës apo mjek.

HAPI 2:

1. Kujtojini fëmijëve që të gjithë ne jemi të veçantë dhe unik dhe si të tillë të gjithë ne kemi ëndrra të ndryshme.
2. Kërkojuni fëmijëve që të ulen në formë rrethi. Shpjegojuni atyre që ata duhet të thonë diçka që pëlqejnë ta bëjnë dhe që ndihen se e bëjnë mirë këtë gjë. Jepu sugjerime të tilla si të kënduarit, të kërcyerit, të ndihmuarit e dikujt tjetër, të qënurit i duruar, të kërcejnë shumë lart, të zbulojnë gjëra të reja, etj. Kujtojuani edhe një herë atyre se këto gjëra quhen ndryshe talente.
Jepi topin një fëmije dhe kërkoji atij/asaj të thotë me zë të lartë Talentin e Tij/Saj të Veçantë. Dhe pasi ai/ajo ta thotë atë kërkoji atij/asaj të ja kalojë topin fëmijës përbri tij/saj, ku i/e cila duhet të thotë po me zë të lartë atë që ai/ajo mendon se ka Talentin e Tij/Saj të Veçantë. Përsërite këtë proces deri sa të gjithë fëmijët të kenë shprehur talentet e tyre me zë të lartë.
3. Pasi fëmijët t'i kenë shprehur mendimin e tyre për atë që ata mendojnë se kanë talent informojini ata që do të këndojnë të gjithë së bashku rreth asaj se çfarë na bën ne të veçantë. Këndoni bashkë me ta vargjet e mëposhtme me melodinë e këngës “Unë jam i veçantë”, duke qënë ju të parët që udhëhiqni këngën dhe fëmijët t’ju ndjekin më pas me veprime.

Unë jam i veçantë
(tregoni me dy gishtërinjtë e mëdhenj veten tuaj)

Unë jam i veçantë
(tregoni me dy gishtërinjtë e mëdhenj veten tuaj)

Po unë jam, po unë jam i veçantë

Unë mund të.....

(Përmendni të gjitha talentet që fëmijët ndanë gjatë hapit të tretë të mësimit si për shembull ndihmoj familjen në shtëpi)

Unë mund të (ndihmoj familjen time në shtëpi).

Po unë mundem!

(shriji dy krahët lart mbi kokë)

Po unë mundem!

(shriji dy krahët lart mbi kokë)

4. Përsëriteni këngën disa herë, duke ndryshuar aktivitetin në varësi të llojit të talentit që kanë shprehur fëmijët më parë në hapin e tretë të orës së mësimit.

HAPI 3:

1. Tregojuni fëmijëve *Yjet e Ëndrrave, të prera gjatë aktivitetit të mëparshëm.*

Pyesni ata:

- A e mbani mend se për çfarë n’ a shërbenin këto yje, pra yjet e ëndrrave?
- A e mbani mend se cila ishte ëndrra juaj?

Kujtojuni atyre që secili nga ne është i veçantë dhe kemi ëndrra të veçanta dhe gjëra të veçanta që do të dëshironim t’i realizonim kur të rritemi.

2. Shpërndajuni fëmijëve Yllin e Ëndrrave të tij/saj dhe pyetini ata:

- A është kjo ëndrra juaj më e madhe? Apo dëshironi ta ndërroni atë tani me një tjetër?
- A keni ndonjë ëndërr të re? Përse?
- Çfarë mendoni se ju keni nevojë që të përmbushni/realizoni ëndrrën tuaj?

Theksoni se kur vjen puna për të realizuar ëndrrat që gjithësecili nga ne ka, atëherë është shumë e rëndësishme që të marrim në konsideratë edhe talentet që ne kemi dhe që këto talente duhet t'i përdorim me zgjuarësi.

Jepni disa shembuj.

Shpjegojuni gjithashtu fëmijëve që ata mund të mësojnë që t'i përdorin talentet që ata kanë në mënyra të ndryshme, dhe që teksa rriten mund të zbulojnë se kanë edhe talente të tjera.

3. Jepuni secilit fëmijë nga një yll të prerë bosh dhe kërkojuni atyre që të vizatojnë brenda tij Talentin e tyre të Veçantë.
4. Shpjegojuni atyre se është shumë e rëndësishme që të mbajnë mend se cilat janë ëndrrat dhe talentet e tyre. Pasi fëmijët të kenë përfunduar së vizatuari talentet e tyre, kërkojuni që t'i ngjisin ato në pjesën e pasme të Yllit të Ëndrrave të tyre dhe më pas ta vendsoin në kutinë apo dosjen e tyre.
5. Pyesni sërish fëmijët:
 - A vazhdon të jetë e njëjta ëndërr për ju si ajo që futet në kutinë apo dosjen tuaj?
 - A mendoni se është mirë që të kemi më shumë se një ëndërr?
 - (Për fëmijët më të rritur) A duhet që njerëz të tjerë t'ju pengojnë në realizimin e ëndrrave të juaja?

Shpjegojuni fëmijëve se ata kanë të drejtë të ndjein ëndrrat e tyre dhe të zhvillojnë talentet që kanë.

Aktiviteti me familjën

Kërkojuni fëmijëve që të ndajnë gjërat që mësuan sot edhe me anëtarët e tjerë të familjes. Kërkojuni gjithashtu fëmijëve që t'i pyesin prindërit se çfarë pune bëjnë dhe përse e kanë qejf punën e tyre. Për çfarë aftësish kanë nevojë ata që të bëjnë punën e tyre?

A mundet që prindëri dhe fëmijët të vizatojnë profesionin e njërit për prindërve? Këtu mund të përfshihen profesione si: çoban i cili kujdeset për delet; shtëpiake e cila kujdeset për shtëpinë; mjelëse lopësh, economist/e; avokat/e; doctor; infermjer/e apo mësues/e ?

Sesion në vazhdim: Llojet e punëve dhe profesioneve që ka në komunitetin ku jetojnë fëmijët

Materialet e nevojshme:

- Figura mbi profesione të ndryshme të prera nga revista/gazeta të vjetra
- Figura, uniforma apo mjete që përdoren në profesione të ndryshme të prera nga revista/gazeta të vjetra.
- Brum i bërë në shtëpi (shihni udhëzimet)
- Fletë të bardha

Shënim: Paraprakisht sigurohuni që në përzgjedhjen e figurave mbi profesionet të keni edhe figura që ilustrojnë profesionet e prindërve të fëmijëve. Ju lutem mos harroni që të keni figura profesionale të cilat bëhen nga meshkuj dhe nga femra. Mirmbajtja e shtëpisë dhe kujdesi për fëmijët mund të jetë një punë e papaguar por është një kontribut i madh për ekonominë e familjes si dhe për mbarëvatjen efektive të komuniteteve.

HAPI 1:

1. Ndani fëmijët në dy grupe të vogla.
2. Jepini çdo grupi një set figurash të prera nga revista ku ilustrohen njëri me profesione të ndryshme dhe figura të “mjeteve” që përdoren në këtë profesione.
3. Kërkojini fëmijëve të lidhin figurat me mjetet që kanë lidhje me profesionin/et.
4. Tregojini fëmijëve që në aktivitetin e ditës së sotme do të flisni për profesionet që kanë anëtarët e familjeve tyre.

HAPI 2:

1. Tregojuni fëmijëve që, ashtu si tek figurat, edhe anëtarët e familjeve të tyre kanë profesione të ndryshme.
2. Pyesni fëmijët:
 - Çfarë pune bëjnë prindërit/gjyshërit tuaj?
 - A këni qënë ndonjëherë në vendin e punës së prindërve tuaj?
 - A mund të n’a tregoni çfarë keni parë?
 - Sipas mendimit tuaj, pse duhet të punojnë prindërit?
3. Duke përdorur brumin e bërë në shtëpi, kërkojini fëmijëve të bëjnë “mjetet” që përdorin prindërit në profesionet e tyre.
4. Kur fëmijët të përfundojnë me krijimin e mjeteve me brum, vendosini ato mbi një letër të bardhë, dhe pyesni fëmijën për çfarë e përdor prindi tij/saj mjetin (për shembull: “Babai im përdor një thikë të madhe kur pret pemët”).
5. Sapo të jenë ngurtësuar mjetet në brum, jepjani fëmijëve që t’i vendosin në kutinë apo dosjen e tyre.

Pyetje për diskutim

1. Rikujtojini fëmijëve që prindëri duhet të punojnë për të fituar para në mënyrë që të mund t’u blejnë ushqime dhe gjëra të tjera për të cilat ka nevojë familja.
Të gjitha llojet e punëve që kryejnë prindërit janë të rëndësishme për atë që i sjell jo vetëm familjes, por edhe komunitetit.
Theksoni këtë përmes pyetjeve të mëposhtme që mund t’i drejtoni fëmijëve:
 - Si mendoni, çfarë do të ndodhte nëse nuk do kishte polic?
 - Si mendoni, çfarë do ndodhte nëse nuk do kishte fermerë?
 - Si mendoni, çfarë do ndodhte nëse nuk do kishte mësues?
 - Si mendoni, çfarë do ndodhte nëse nuk do kishte zjarrfikës?
 - Si mendoni, çfarë do ndodhte nëse nuk do kishte mjek/doktorë?
 - Si mendoni, çfarë do ndodhte nëse nuk do kishte infermjer/e?
2. Prezantojini këngën “Çfarë pune bëj unë?” (këndojeni me melodinë e “A po fle?”)
3. Kërkojini fëmijëve të krijojnë vetë vargjet.

Këndoni këngën “Çfare pune bëj unë?”



Çfarë pune bëj unë?

Çfarë pune bëj unë?

A e gjen dot?

A e gjen dot?

Unë ndihmoj njëri me tjetrin të shërohen*

Unë ndihmoj njëri me tjetrin të shërohen*

Kush jam unë?

Kush jam unë?

*Vargje të tjera: Mund të rregulloj tubat e ujit; Shpërndaj letra; Gatuaj ushqime të shijshme për ty; Kujdesem për shëndetin e kafshëve tuaja; Mund t'ju mësoj gjëra të reja.



AKTIVITET ME FAMILJEN

Ftoni prindërit apo gjyshërit apo njerëz me profesione të ndryshme në komunitet që të vijnë në klasën tuaj dhe t'i tregojnë fëmijëve rreth profesionit të tyre. Ju mund të përdorni formatin e mëposhtëm:

2. PËRSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË NDIHMOJMË NË FAMILJE

I/E Dashur _____.

Aktualisht jemi duke njohur profesionet dhe mjetet që përdoren gjatë ushtrimit të punës.

JENI TË FTUAR të vini në kopështin/shkollën tonë për të na treguar dhe folur më shumë rreth profesionit apo punës tuaj.

A mund të sillni dhe mjetet që përdorni në profesionin tuaj? Në tashme kemi mësuar shumë rreth profesioneve dhe mjeteve që përdoren ndaj ju do n'a ndihmonit të mësojmë akoma më shumë!

KUR? Ejani në _____

Ju mirëpresim

Me konsideratë, _____

Materialet:

Historia: *Arbeni kalon kohë me miqtë e tij* (Shtojca 5)

HAPI 1:

1. Informoni fëmijët se Arbeni bën shumë gjëra në shtëpi për të ndihmuar familjen e tij. Edhe familja e Arbenit bën shumë gjëra që e bëjnë atë të lumtur.
2. Tregojini fëmijëve që ju do të ndani me ta se çfarë bën Arbeni për të ndihmuar familjen e tij.
3. Kërkojini fëmijëve të kërcejnë dhe të thonë me zë të lartë “Unë jam Arbeni” nëse edhe ata bëjnë të njëjta gjëra për familjen e tyre.
4. Me fëmijët më të rritur, kërkojini atyre ta thonë atë me zë më të lartë dhe të hidhen dy herë në ajër nëse e kryejnë shpesh. Përdorni shembujt si më poshtë:
 - Arbeni rregullon krevatin e tij (për fëmijët më të rritur)
 - Arbeni ndihmon prindërit për përgatitjen e darkës (për fëmijët më të rritur)
 - Arbeni ujit lulet.
 - Arbeni u jep ushqim kafshëve që ka në shtëpi.
 - Arbeni i vendos lodrat/gjërat e tij në vendin e duhur.
 - Arbeni i ndihmon motrat/vëllezërit e tij më të vegjël të bëhen gati për në shkollë (për fëmijët më të rritur)
5. Pyesni fëmijët:
 - Si mendoni, pse bën Arbeni të gjitha këto gjëra në shtëpi?
 - Çfarë do ndodhte nëse nuk i bënte asnjë njeri?
6. Tregojuni fëmijëve se sot do flisni për “Përgjegjësitë tona në familje”, ose për gjërat që duhet të bëjmë/ndihmojmë në familje.

HAPI 2:

1. Lexoni historinë “*Arbeni kalon kohë me Miqtë e tij*”. (Shtojca 5)
2. Pyesni fëmijët:
 - A ndihmoni edhe ju në familje ashtu si Jona dhe Arbeni?
 - Çfarë punësh bëni ju në familjen tuaj?
 - Pse mendoni se është e rëndësishme të ndihmoni në familjen tuaj?
3. Shpjegojini fëmijëve që, ashtu si Arbeni, familjet e tyre, në mënyrë të veçantë prindërit e tyre, ju tregojnë sesi mund të ndihmoni në familje
Informoni fëmijët se, së bashku, ju do bëni të gjitha gjërat që bën Arbeni në familjen e tij. Filloni duke drejtuar këto pyetje:
 - Tani, le të rregullojmë krevatet tona. Bëni me pantonime sikur po rregulloni krevatin.
 - Tani, le të ndihmojmë të gjithë prindërit tanë për të përgatitur darkën. Bëni me pantonime sikur po gatvani. Dhe kështu me radhë.
4. Kërkojini fëmijëve të mendojnë se si i ndihmojnë ata anëtarët e familjes dhe/ose si i ndihmon familja fëmijët për të bërë të bërë një detyrë të caktuar. Për shembull, merren me kopshtarinë – veprimi që duhet të aktrojnë është sikur përkulen poshtë dhe bëjnë sikur këpusin barërat e këqinj).
5. Kërkojini fëmijëve të tjerë të aktrojnë së bashku lëvizjet/veprimet.

Mësojini fëmijëve këngën “Kështu ndihmoj”. Ndryshojini vargjet sipas asaj çfarë kanë thënë fëmijët.

Shkëmbeni fjalën “nënë” me “babai” në vargun e radhës, dhe me një anëtar tjetër të familjes në vargjet e mëpasme.

3. PËRSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË NDIHMOJMË NË FAMILJE

“Kështu unë ndihmoj”



Kështu e ndihmoj unë nënën time,
Kështu e ndihmoj,
Kështu e ndihmoj

(Fëmijët të bëjnë me veprime mënyrën si e ndihmojnë nënën e tyre, psh të bëjnë me veprim sikur po gatuajnë së bashku)

Kështu e ndihmoj unë nënën time çdo ditë



HAPI 1:

Pysni fëmijët se si ata mund të ndihmojnë për t'u kujdesur për mjedisin e tyre. Një nga detyrat është që të kursejnë ujin.

Opesni fëmijët se si ata kursejnë ujin dhe nuk e shpërdorjnë. Fëmijët duhet të japin përgjigje të ngjashme me: e mbyllin rubinetin e ujit që most ë shkojë dëm; ose që mbledhin ujin e rënë nga shiu për të ujitur lulet etj.

Kërkoji fëmijëve që të vendosin në kutitë apo dosjet e tyre vizatimet që bënë për pridërit e tyre se si ata kursejne ujin. Duke qënë se fëmijët e realizuan këtë aktivitet me fëmijët, për çfarë floën ata bashkë më njëri tjetrin? A ka menduar familja për mënyra të tjera për të kursyer ujin?

4. UNË DHE KOMUNITETI IM - Jetojmë dhe Punojmë Sëbashku

Krijimi i një mini-marketi

Materialet e Nevojshme:

- Kartona të mëdhenj apo letër flipçarti për të përgatitur postera të ndryshme.
- Shirit ngjitës.
- Letra të bardha A4
- Lapsa me ngjyra/bojra uji
- Objekte të ndryshme apo artikuj ushqimorë (stilolapsa, mollë, banane, karrota etj) ose kuti të boshatisura ushqimesh dhe kuti apo mbajtëse të tjera boshe ushqimesh apo produktesh të tjera (si kuti shampoje, kuti pastë dhëmbësh etj). Në të kundërt, nëse nuk i siguron dot këto, mund të përdorni figura të prera ushqimesh dhe objektesh të tjera nga revistat reklamuese të marketeve të ndryshme.
- Copë tekstile të ndryshme.
- Ngjitës

HAPI 1:

1. Kujtojeni fëmijëve shëtitjen që bëtë në fshatin/lagjen apo qytetin tuaj. Pyesni fëmijët:
 - A e mbani mend shëtitjen që bëmë në lagje?
 - Cilat vende vizituam së bashku?
 - Çfarë pamë në ato vende?
 - Çfarë gjërash të tjera ndodhën gjatë shëtitjes sonë?
2. Nëse fëmijët nuk e përmendin, kujtojeni atyre vizitën që bëtë në një dyqan/market dhe shpjegojeni atyre se sot ata do të eksplorojnë së bashku më me hollësi se çfarë ndodh në një dyqan/market.
3. Pyesni fëmijët:
 - A e dini se përse janë dyqanet/marketet?
 - A e mbani mend se çfarë po bënte shitësi/shitësja kur dikush po blinte diçka në dyqanin e tij/e saj?
4. Kujtojeni fëmijëve që blerësi i dha shitësit/es para në këmbim të gjërave që ai/ajo donte të blinte.
5. Recitoni bashkë me fëmijët vjershën e dyqanit. Ju mund ta shoqëroni me lëvizje imituese në mënyrë që ta bëni atë më argëtuese për fëmijët dhe kërkojeni fëmijëve që të imitojnë lëvizjet tuaja (që i keni të shënuara me gërma të pjerrëta).

Në dyqan...në dyqan

(Marshoni).....(imitoni veprimin sikur po hani diçka)

Në dyqan në dyqan ne po shkojmë

Që të blejmë që të blejmë disa kokrra mollë.

(Imitoni një shtëpi) (kërceni)

Mollët i blemë dhe u kthyem në shtëpi

Kërcejmë nga gëzimi, o sa lumturi.

(Marshoni).....(imitoni veprimin sikur po hani diçka)

Në dyqan në dyqan të gëzuar vemi

Që të blejmë bukën, gjalpin edhe reçelin.

(Imitoni një shtëpi) (kërceni)

Bukën, gjalpin dhe reçelin i çojmë në shtëpi

Kërcejmë nga gëzimi, o sa lumturi.

(Marshoni).....(imitoni veprimin sikur po hani diçka)

Në dyqan në dyqan tani ne po shkojmë sot

Për të blerë qumësht, për të blerë kos.

(Imitoni një shtëpi) (kërceni)

Blerjet për sot i mbaruam dhe kthehemi në shtëpi

Kërcejmë dhe këndojmë, o sa lumturi.

HAPI 2:

- Shpjegojuni fëmijëve që ata do të luajnë një lojë imagjinare dhe do të imagjinojnë sikur ndodhen në një dyqan/market.
- Ndani fëmijët në grupe të vogla me nga 5-6 fëmijë për çdo grup. Kërkojuni secilit grup fëmijësh që të ulen në rrëth në kënde të ndryshme të dhomës së klasës.
- Shpjegojuni atyre se secili grup do të përgatisë dhe ndërtojë një tezgë për dyqanin/marketin e tij. Diskutoni me secilin grup fëmijësh mundësitë e llojeve të ndryshme të tezgave që ata mund të ngrenë për dyqanin/marketin e tyre dhe se çfarë gjërash mund të përfshijnë në to. Gjithashtu shpjegojuni fëmijëve që ata duhet ta ndërtojnë tezgën e dyqanit sa më bukur dhe sa më tërheqës që të jetë e mundur në mënyrë që ato të jenë tërheqëse për blerësit (për njerëzit që duan të blejnë diçka nga ato që shesin. Disa sugjerime mund të jenë: krijimi i disa posterave me ngjyra, shtrimi i një mbulose tavoline të krijuar prej tyre me copa tekstile me ngjyra dhe ngjites, etj.
- Kërkojuni fëmijëve që pasi të kenë vendosur se çfarë tezge do të ndërtojnë, pra çfarë lloj dyqani/marketit do të kenë, të krijojnë një poster ku përmes të cilit të japin idenë se çfarë produktesh ata shesin, poster që pasi ata ta krijojnë mund t'i ndihmoni që ta varin në murin pranë këndit të dhomës ku ata kanë ngritur dyqanin e tyre. Pasi të keni vendosur posterin, përpara posterit vendosni një tavolinë dhe shpjegojuni fëmijëve që tavolina do të shërbejë si tezga e dyqanit/marketit të tyre të vogël.
- Pasi fëmijët të kenë bërë edhe dekorimin e tezgës (tavolinës) së tyre, tregojuni fëmijëve objektet e ndryshme apo artikuj ushqimorë (stilolapsa, mollë, banane, karrota etj) ose kuti të boshatisura ushqimesh dhe kuti apo mbajtëse të tjera boshe ushqimesh apo produktesh të tjera (si kuti shampoje, kuti pastë dhëmbësh etj) që ju keni parapërgatitur. Mund t'u tregoni atyre edhe figura të prera ushqimesh dhe objektesh të tjera nga revistat reklamuese të marketeve të ndryshme që ju i keni prerë më përpara apo që jua kanë sjellë prindërit me kërkesën tuaj paraprake. Pasi t'ua tregoni çdonjërin prej këtyre materiale, kërkojuni secilit grup fëmijësh që të zgjedhin objektet apo produktet

ushqimore që ata pëlqejnë më shumë dhe që do të donin t'i shisnin në dyqanin/marketin e tyre. Kërkojini secilit fëmijë që të zgjedhë 3 objekte ose produkte të tjera, në mënyrë që secili grup fëmijësh do të ketë në dizpozicion 15-18 objekte dhe produkte për dyqanin/marketin e tyre.

Pyesni fëmijët se kush janë gjërat për të cilat ka nevojë familja e tyre? Cfarë ushqimi hanë më shumë ata gjatë javës? Përveç produkteve që janë në dyqan, a b lejnë prindërit e tyre gjëra të tjera në dyqane të tjera?

- Ndani secilin grup fëmijësh në dy grupe më të vogla, dhe shpjegojuni se njëri grup do të luajë rolin e shitësit, ndërsa grupi tjetër do të luajë rolin e blerësit. Shpjegojuni atyre që pas disa minutash grupet do të ndërrojnë rolet, pra ata që ishin blerësit do të bëhen shitësit, dhe ata që ishin shitësit do të bëhen blerësit.
- Kërkojini secilit fëmijë që të marrin një kutipër të vendosur paratë të cilat janë bërë nga mësesja në aktivitete të mëparshme. Kërkoji një prej fëmijëve që të praktikojnë duke shkuar dhe pyetur për cmimin e objekteve? Ju mund t'i shpjegoni fëmijëve se si mund të kërkojnë bjehtin që duan të blejnë dhe ti shpjegoni shitësit se sa para kushton një objekt dhe se sa para duhet të kthejë si kusur.
- Kërkojini fëmijëve që të luajnë rolet e shitësit dhe blerësit për rreth 15 minuta. Përfshihuni edhe ju në lojë duke shkuar në secilën tezgë (tavinë) të dyqanit/marketit të çdo grupi fëmijësh dhe t'u bëni pyetje të tilla si për shembull:
- Sa monedha kushton ky stilolapës? A mund të blej një kile mollë/patate/karrota? Sa kushton kjo?
- Për ta bërë lojën edhe më zbavitëse sugjerojini fëmijëve që të krijojnë situata të ndryshme, për shembull:
 - Dy fëmijë në rolin e blerësit të duan të blejnë të njëjtën gjë, por që ka vetëm një copë prej kësaj gjëje në shitje. So do të vendosë shitësi se kujt blerësi do t'ja japë objektin dhe të shpjegojë se kur mund ti vi furnizimi i ri?
 - Ka ardhur furnizimi i ri, kush do të merret me mallin që ka ardhur dhe kush do t'i shërbejë blerësve?

Shënim: Mbani mend që ky aktivitet mund të zhvillohet në të njëjtën ditë ose mund të ndahet në dy ditë të njëpasnjëshme. Pasi të kenë ngritur tezgat e dyqaneve/marketeve të tyre, fëmijët mund ta vazhdojnë lojën edhe në orët e ardhshme mësimore.

- Pasi të keni përfunduar lojën e dyqanit/marketit, kërkojini fëmijëve që të ulen të gjithë së bashku në një rreth dhe pyetini ata se si u ndjenë teksa pretendonin që po punonin në një dyqan/market apo që të ishin blerës. Për ta bërë një gjë të tillë mund të përdorni pyetje të tilla si:
- Cila pjesë ishte më argëtuese – të shesësh apo të blesh? Përse?
- Çfarë bletë në dyqan? Përse bletë pikërisht

HAPI 3:

1. Kujtojuni fëmijëve rëndësinë e ruajtjes së gjërave me vlerë në një vend të sigurtë. Pyesni fëmijët:

- A duhet t'i lemë vërdallë nëpër dhomë monedhat që ju fituat gjatë shitjes?
- A duhet t'i lemë ato mbi tavolinë?

- A duhet t'i fusim ato përsëri në Kutitë tuaja të kuti po ne dosje?
2. Kërkojuni fëmijëve që të fusin gjërat që blenë në kutitë apo dosjet e tyre dhe paratë e vërteta t'ua japin juve për ti përdorur me vonë në aktivitete të tjera. Meqënëse ky aktivitet u zhvillua në grup, kërkojuni një fëmijë nga secili grup që të mbledhë të gjitha monedhat e fituara nga dyqani/marketi i grupit dhe t'i shpërndajë ato në mënyrë të barabartë për çdo fëmijë të grupit të tij.
 3. Theksoni rëndësinë e mbajtjes së gjërave me vlerë në një vënd të sigurtë duke u thënë fëmijëve:
 - Ku i ruajmë ne paratë tona? Në kutitë tonë të Kursimit!
 Përsëriteni sërish por kësaj rradhe kërkojuni fëmijëve që ta përsërisin bashkë me ju me zë të lartë.

Lojrat

Shënim: Përpara se të zhvilloni këtë orë mësimore, sigurohuni që keni planifikuar me kohë një Shëtitje në Natyrë. Gjithashtu sigurohuni që të keni planifikuar që shëtitjen ta zhvilloni në një rrugë që është e sigurtë për të dalë shëtitje me fëmijët si dhe që të ketë gjëra interesante për t'u parë dhe për t'u prekur nga fëmijët (lloje të ndryshme kafshësh ose insektesh, pemë, lule etj).

Nëse është e mundur, kërkojuni ndonjë prindi apo anëtar të komunitetit ku jetoni që kujdeset për pemë apo bimë që të vijë një ditë në kopshtin tuaj dhe t'u flasë fëmijëve duke u shpjeguar atyre se çfarë ata bëjnë në mënyrë që të sigurojnë që bimët dhe pemët të rriten të shëndetshme.

HAPI 1:

1. Prezantoni konceptin e ruajtjes së burimeve natyrale. Shpjegoni se ne mund të ruajmë gjëra të ndryshme si: uji, pemët, paratë etj.
2. Pyesni fëmijët:
 - Cfarë tjetër mund të ruajmë?
 - A mund të mendoni për mënyra të tjera që të ruajmë ujin?

Ndihmojini ata duke u dhënë sygjerime si: mbushni një gotë me ujë në mënyrë të kujdesshme që të mos e derdhim dhe të mos e shpërdorojmë.
3. Tregoji fëmijëve dy figura ku tregohet ruajtja e ujit a[po mos shpërdorimi i tij: një vajzë që mbyll rubinetin dhe një djalë që rregullon një tubë që e derdh ujin. Theksojini fëmijevë që një fëmijë i mirë e mbyll gjithmonë rubinetin pasi lan duart në mënyrë që të mos e shpërdorjë ujin dhe të shpëtojë planetin. Nëse rrjedh ujë, fëmijët duhet që ti tregojnë gjithmonë të rriturve që ta rregullojnë tubin e carë. Edhe një veprim i tillë do të ruante shpërdorimin e ujit!
4. Ndajeni klasën në dy grupe dhe jepini mundësi cdo fëmijë që të zgjedhë një figurë ilustruese. Kërkojuni atyre që të marrin këto figura në shtëpi dhe ti ngjyrosin bashkë me prindërit e tyre.

Shënim, ju mund ta ripërsërsni këtë aktivitet duke përdorur burime të tjera, përshembull: Nëse keni dëshirë mund të flisni për ruajtjen e pemëve dhe mund të aplikoni të njëjtat hapa sic bë të me ruajtjen e ujit.

Aktivite Praktike

HISTORIA E MILINGONËS DHE GJINKALLËS

Materialet e Nevojshme

- Historia “Gjinkalla dhe milingona”(Shtojca 6).
- Kuti për të vendosur gjërat/lodrat e veçanta të fëmijëve.
- Foto ose figurë/pikturë e një gjinkalle.
- Foto ose figurë/pikturë e një milingone.
- Fletë Flipçarti
- Markera/shkumësa

Shënim: Përpara fillimit të orës së mësim, rutinë e siguruar prej jush në një kënd të dhomës në mënyrë që më vonë fëmijët të vendosin në të gjërat apo lodrat e tyre të veçanta.

HAPI 1:

1. Në mënyrë që të përgatiteni për këtë pjesë të parë të orës mësimore, lërimi fillimisht fëmijët që të ndajnë me njëri-tjetrin gjërat apo lodrat e tyre të preferuara që kanë sjellur nga shtëpia. Kjo parantezë do t’i ndihmojë ata që të fillojnë të kuptojnë rëndësinë e ndarjes së gjërave me të tjerët. Por përpara se t’i ftoni fëmijët që të ndjanë gjërat e tyre të preferuara me njëri-tjetrin, sigurohuni që u keni sqaruar më parë se në fund të ditës secili prej tyre do t’i marrë sërish gjërat e veta të preferuara për t’i kthyer në shtëpi.
2. Më pas diskutoni me fëmijët se çfarë do të thotë që të ndash gjërat e tua me të tjerët. Theksojuni atyre rëndësinë e përmbushjes së një rregulli të thjeshtë por mjaft të rëndësishëm që duhet të ndjekim kur e bëjmë një gjë të tillë. Dhe ky rregull është që ne duhet të tregojmë kujdes për gjërat që na i ka dhënë shoku/shoqja. Pyetini ata:
 - Nëse një nga shokët apo shoqet e tua u ka dhënë diçka prej vetes qoftë një lodër apo diçka tjetër dhe ju e thyni apo e prishni atë, a mendoni që shoku/shoqja juaj do të mërzitet?Kujtojuni fëmijëve edhe një herë që është e rëndësishme që të të kenë shumë kujdes me gjërat që morën prej shokëve dhe shoqeve të tyre dhe që duhet të mbajnë mend se në fund të ditës duhet të ja kthejnë sërish atë shokut apo shoqes që i përket.
3. Kërkojuni fëmijëve që t’i vendosin gjërat/lodrat e tyre të preferuara në rutinë që ndodhet në njërin prej këndeve të dhomës dhe shpjegojuni atyre që pak më vonë do të luajnë lojën e Gjinkallës dhe Milingonës dhe për ta zhvilluar këtë lojë do t’i përdorin gjërat e tyre të preferuara.
4. Nëse fëmijët nuk e dinë se çfarë është një milingonë apo një gjinkallë, tregojuni fotot apo figurat që ju keni parapërgatitur të gjinkallës dhe milingonës. Dhe më pas pyetini ata:
 - Çfarë shihni në këto foto/figura?
 - Çfarë mund të thoni për milingonën?

- Sa këmbë ka një milingonë?
 - Po për gjinkallën çfarë mund të thoni?
 - Çfarë ngjyre ka gjinkalla?
5. Shpjegojuni fëmijëve që milingonat janë shumë të vogla, dhe që shpesh ato lëvizin në rresht për një nga një largësi e madhe nga shtëpia e tyre për të transportuar ushqimin nga vendi ku e mbledhin deri në shtëpi (nëse gjatë shëtitjeve që ju keni bërë e keni parë një gjë të tillë me fëmijët atëherë mund t'i referoheni asaj se çfarë keni parë dhe diskutuar më parë fëmijët rreth milingonave).
- Ndërsa për gjinkallat, ju mund t'u thoni fëmijëve se ato janë të vogla por më të mëdha se milingonat dhe që shpesh ata këndojnë, veçanërisht në ditët e nxehta.
- Më pas pyetini fëmijët:
- Çfarë tingujsh mendoni se lëshon gjinkalla kur këndon?
- Kërkojuni fëmijëve që të imagjinojnë se janë gjinkalla dhe të lëshojnë tingujt që ata mendojnë se një gjinkallë lëshon kur këndon.
6. Ndajini fëmijët në dy grupe. Njëri grup do të luajë rolin e milingonave dhe grupi tjetër i fëmijëve do të luajnë rolin e gjinkallave.
7. Informojini fëmijët se tani do të luajnë lojën e Gjinkallës dhe Milingonës. Shpjegoju atyre se një fëmijë do të fshehë diku në dhomë një lodër, dhe të tjerët do të përpiqen që ta gjejnë atë. Fëmijët që luajnë rolin e milingonave do të lëvizin nëpër dhomë duke ecur me hapa të vegjël në rresht për një, ndërsa fëmijët që luajnë rolin e gjinkallave do të ecin duke kërcyer lart tamam sikur bëjnë edhe në të vërtetë insektet që ata po dramatizojnë.
8. Kërkoji njërit prej fëmijëve që të nxjerrë një nga lodrat apo gjërat e vendosura në kuti dhe ta fshehë atë diku në dhomë. Ndërkohë që ky fëmijë e fsheh lodrën, të gjithë fëmijët e tjerë mbajnë sytë e mbyllura dhe me kurriz nga ana se ku do ta fshehë fëmija lodrën apo gjënë që ka marrë nga kutia e gjërave/lodrave të preferuara. Kërkojuni fëmijëve të tjerë që duhet ta gjejnë objektin/lodrën e fshehur si një grup ndaj duhet të lëvizin të gjithë së bashku sikur të ishin një gjarpër i madh. Ndërkohë pasi fëmija që ka fshehur lodrën duhet që të vijë të rrijë pranë jush dhe t'u japë udhëzime fëmijëve të tjerë duke u treguar atyre nëse janë afër apo larg lodrës së fshehur, duke thënë “ngrohtë”, “shumë ngrohtë”, “shumë nxehtë” nëse i afrohen objektit/lodrës dhe duke thënë “ftohtë”, “shumë ftohtë”, “ngriva fare” kur i largohen objektit.
9. Pasi fëmijët ta kenë gjetur objektin/lodrën, përsëriteni këtë proces edhe dy deri në tre herë me dy deri në tre fëmijë që zgjedhin lodra/objekte të tjera nga kutia e gjërave/lodrave të preferuara. Për ata fëmijë që nuk patën mundësi të fshehin një objekt/lodrë të preferuar, kërkojuni atyre që të shkojnë ta marrin atë nga kutia e gjërave/lodrave të preferuara dhe t'u shpjegojnë fëmijëve të tjerë se pse do të dëshironin ta ndanin atë me miqtë e tyre.
10. Në fund të këtij aktiviteti, vendosini sërisht të gjitha gjërat/ lodrat në kutinë e gjërave/lodrave të preferuara për t'i përdorur përsëri në një aktivitet tjetër që do të ndodhë pak më vonë.

HAPI 2:

1. Kërkojuni fëmijëve që të ulen në rreth.
2. Lexojuni fëmijëve historinë “Gjinkalla dhe Milingona”. Kur ju të keni përfunduar së lexuari historinë, apo edhe gjatë tregimit të saj nëse ju e preferoni një gjë të tillë, bëjuni fëmijëve pyetjet e mëposhtme:
 - Çfarë i pëlqen milingonës që të bëjë?
 - Çfarë i pëlqen gjinkallës?

- Çfarë ndodhi kur erdhi dimri?
- A do të bënit edhe ju të njëjtën gjë?
- Pse mendoni se milingona e ndau ushqimin e saj me gjinkallën?

HAPI 3:

1. Merrni rutinë e lodrave/gjërave të preferuara të fëmijëve.
2. Kërkojuni fëmijëve që ata duhet të ndajnë me shokët dhe shoqet e tyre lodrën/objektin e tyre të preferuar, po ashtu siç e ndau ushqimin milingona me gjinkallën.
3. Theksoni përsëri rregullin që duhet të kujdesen për objektin/lodrën që shoku/shoqja e tyre po i ndan me ta. Kujtojuni fëmijëve pyetjen që keni bërë edhe më parë:
 - Nëse një nga shokët apo shoqet e tua u ka dhënë diçka prej vetes qoftë një lodër apo diçka tjetër dhe ju e thyeni apo e prishni atë, a mendoni që shoku/shoqja juaj do të mërzhitet?
4. Kërkojini njërit prej fëmijëve që të mbyllë sytë dhe të marrë me sy të mbyllur një prej lodrave/objekteve që ndodhet në rutinë e lodrave/gjërave të preferuara të fëmijëve.
5. Përsëriteni këtë proces me të gjithë fëmijët.
6. Lëroni ata të luajnë me objektet/lodrat që morën nga kutia e lodrave/gjërave të preferuara të fëmijëve për rreth 5 deri në 10 minuta.
7. Inkurajojini ata që të luajnë së bashku me lodrat dhe objektet që ata kanë marrë në dorë ose që t'i ndajnë përsëri me njëri-tjetrin.
8. Në fund të aktivitetit kërkojuni fëmijëve që secili prej tyre t'i rikthejë lodrën/objektin fëmijës që i përket në mënyrë që ta marrë sërish me vete për në shtëpi.

Materiale Mbështetëse për Profesionistët që Punojnë me Fëmijërinë e Hershme

Dokumentacioni pedagogjik – krijimi i një praktikë të qartë

Shpesh praktikuesit mendojnë ka shumë shkrim në procesin e dokumentimit por ka të bëjë me njohjen dhe regjistrimin e vëzhgimeve të rëndësishme. Nëpërmjet vëzhgimit, të asaj që thonë fëmijët dhe veprimeve të tyre kundrejt të tjerëve, ju do të jeni të aftë të njihni kur ndodh një ndryshim në sjelleje dhe kur ndodh progresi.

Vëzhgimi, të dëgjuarit me kujdes dhe regjistrimi (mbajtja shënim), janë mjete të nevojshme të cilat i japin mundësi praktikantëve për të drejtuar një grup dhe për të ofruar një mjedis të sigurt, të lumtur dhe për të mësuar" për fëmijët, prindërit e tyre dhe mësuesit parashkollorë

Në kuptimin më të gjerë të fjalës, dokumentacioni pedagogjik është një metodë cilësore e të punuarit që të jep mundësi për të rishikuar dhe reflektuar praktikën profesionale, për t'a diskutuar dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme. Nuk është gjithmonë e lehtë për të komunikuar brenda këtij kuadri apo edhe për të gjetur një fjalor të përshtatshëm. Duke i bërë gjërat e dukshme, ju hapni tema diskutimi duke mbështetur në këtë mënyrë procesin ku mund të bëhen ndryshime dhe përmirësime. Kjo mbështetje është thelbësore në procesin e regjistrimit/mbajtjes së të dhënave shënim. Duke krijuar një praktikë të dokumentuar e cila është e dukshme dhe e prekshme, ju mund të flisni për këtë, bëni interpretime, dhe të reflektoni mbi metodat dhe teknikat tuaja të punës. Kjo qasje kërkon një mjedis të sigurt, një atmosferë barazie, respekti dhe një vullnet për të mësuar nga të tjerët dhe për tu angazhuar në zhvillimin profesional.

Dokumentimi / regjistrimi ju ndihmon jo vetëm për të reflektuar mbi procesin tuaj të të mësuarit / mësimdhënies, por shërben edhe për të kuptuar se si dhe çfarë mësojnë fëmijët, për çfarë kanë interes ata dhe çfarë kanë zbuluar. E njëjta gjë vlen edhe për prindërit. Dokumentacioni pedagogjik është në fakt një punë në progres: përdorimi i materialeve të ndryshme në një aktivitet dhe institucione arsimore mundëson diskutime në praktikë, bërjen e pyetjeve, zbulimin e “zonave” ku ka nevojë për ndryshime dhe për të gjetur mënyra për t'i zbatuar ato. Dokumentacioni pedagogjik mund të ofrojë mbështetje në mënyra të ndryshme:

- Mbështet zhvillimin e stafit, diskutimet dhe një praktikë të mirë reflektuese
- Promovon konceptin e një fëmije kompetent
- Mbështet mirëqenien e fëmijës dhe ndjenjën e përkatësisë në grupin
- Mbështet të mësuarin e fëmijëve
- Mundëson një dialog mes prindërve dhe stafit dhe ofron mundësi për të diskutuar idetë në mënyrë cilësore
- Vizualizon programin, diversitetin dhe proceset e ndryshimeve në pranimin dhe respektimin e dallimeve dhe ndërtimin e paqes.

Të gjithë duhet të përfshihen: mësuesit e parashkollorit, prindërit, fëmijët dhe organizatat lokale. Dokumentacioni mund të përfshijë shënime të rastit, forma të strukturuar për

mbledhjen e të dhënave, foto, pamje të regjistruara, pjesë krijuese të punës së fëmijëve dhe tregime. Kjo mund të bëhet në mënyrë më sistematike si mbajtja e një rekordi për çdo fëmijë me shënimet ditore rreth performancës, shprehive, progresit në të mësuar, vizatimet e fëmijës apo testeve etj.

Dokumentacioni nuk është vetëm për anëtarët e stafit, por ai i shërben gjithashtu interesit publik. Prindërit mund të monitorojnë progresin e fëmijës së tyre duke shfletuar nëpër fletoren e tij / saj, fëmijët mund të jenë të informuar në lidhje me ngjarjet që ndodhën gjatë mungesës së tyre për shkak të sëmundjes ose ata thjesht mund të shohin se si vizatimet e tyre kanë ndryshuar gjatë gjithë vitit, praktikuesit mund të vlerësojnë progresin e fëmijëve nga ndryshimet në punën e tyre dhe duke diskutuar çështjet me grupe fëmijësh ose individualisht. Dokumentacioni gjithashtu nxit ndjenjën e përkatësisë dhe të vetë-vlerësimit. Dokumentacioni dhe të dhënat mund të shërbejë si një instrument i reflektimit në praktikën e vet të mësuesit, në sjelljen dhe ndjenjat e fëmijëve.

Informacion i përgjithshëm për mësuesit e parashkollorit, zbatuese të programit

Parimet e një shoqërie demokratike kërkojnë që cdo individ, pa marrë parasysh moshën e tyre, i jepet mundësia të marrë pjesë në jetën shoqërore. Për këtë arsye të dëgjuarit aktiv dhe konsultimi me fëmijët e vegjël janë parakushte të një demokracie të fortë. Duke dëgjuar fëmijët, të rriturit mund t'i ndihmojë ata të ushtrojnë të drejtat e tyre civile dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre të nevojshme për t'u rritur si qytetarë aktivë. Duke dëgjuar fëmijët, të rriturit mund të koordinojnë aktivitetet e tyre me të drejtat e fëmijëve dhe të japin respekt për nevojat dhe perspektivat e fëmijëve.

Monitorimi i referohet mbledhjes së informacioneve në mënyrë të vazhdueshme me qëllim të përmirësimit të cilësisë së punës dhe të vlerësimit të ndryshimeve në përvojat e fëmijëve, familjeve të tyre dhe praktikuesve që marrin pjesë në aktivitete që kanë të bëjnë me respektimin e diversitetit dhe të ndërtimit të paqes. Vlerësimi i referohet vlerësimit të përgjithshëm të ndikimit të aktivitetit, mënyrart e përshtatjes së programit në një kontekst të caktuar, si dhe strategjitë e mundshme për përmirësimin e praktikës vetë.

Gjërat që mund të monitorohen dhe vlerësohen

- Ndryshimet në sjelljen e fëmijës, qëndrimet, besimi dhe njohuritë
- Progresi dhe zhvillimi i aftësive dhe njohurive tek fëmijët
- Praktika e praktikuesve dhe qëndrimet ndaj respektit për dallimet kur punojnë me Fëmijët në situata konflikti dhe pas konfliktit
- Ndikimi i vetë-reflektim në qëndrimet tona, paragjykimet dhe sjelljet
- Praktikrat gjithëpërfshirëse që inkurajon fëmijët e të gjitha aftësive, kulturave apo staturave të mësojnë së bashku
- Sjellja e prindërve, familjeve dhe komuniteteve dhe qëndrimet ndaj dallimeve dhe motivimi i tyre për të siguruar një shoqërie harmonike dhe paqësore

Disa këshilla praktike për vlerësimin e ecurisë së fëmijëve në aktivitetet për ndërtimin e paqes në qendrat e fëmijërisë së hershme

1. Përpara se të prezantoni aktivitetet për ndërtimin e paqes, të tilla si ngjashmëritë dhe dallimet, ndjenjat dhe emocionet, respektimi dallimeve, zgjidhja konfliktit etj, duhet të vëzhgoni dhe mbani shënim se çfarë dinë fëmijët për këto tema. Nëpërmjet asaj çfarë thonë dhe përmes veprimeve të tyre me të tjerët ju mund të krijoni një ide për qendrimet dhe aftësitë e tyre. Këto vëzhgime do jenë bazë ku do të mbështeteni dhe monitoroni përmirësimet në sjelljen ose veprimet e fëmijës kur përballet me konfliktin. Do të ishte ideale nëse do të kryhej një studim nga një hulumtues me përvojë para se të vazhdonit me programin.
2. Organizoni trajnime ose mundësi për trajnime për praktikuesit që të marrin pjesë në një trajnim ku ata mund të mësojnë në lidhje me vetë-vlerësimin, paragjykimet, stereotipet dhe diskriminimi që ndodh çdo ditë në shoqërinë, komunitetin apo vendin ku ata jetojnë. Është e vështirë që të punsh me çështje që dikush nuk i kupton ose nuk e ka menduar ndonjëherë. Vetë shqisat tona mund të jenë sfiduese si emocionalisht ashtu dhe nga sjellja.
3. Vlerësimi duhet të fillojë me çdo fëmijë që në momentin që ai/ajo fillon të frekuentojë kopështin. Shpenzoni kohë për të njohur fëmijët, personalitetin e tyre, gjendjen e tyre familjare dhe prejardhjen e tyre. A ka fëmija alergji, kushtet mjekësore ose nevojat që duhet të merren parasysh gjatë ditës?
4. Ndërsa filloni të përfshini aktivitete për ndërtimin e paqes në rutinën e përditshme, p.sh. dallimet dhe ngjashmëritë, vëzhgoni dhe mbani shënim reagimet e fëmijëve si dhe reflektoni mbi aftësinë e stafit për të punuar mbi çështjet. Nëse nuk ka reagime atëherë ka problem me të kuptuarin dhe angazhimin. Fëmijët e kuptojnë kur gjerat nuk janë të vërteta.
5. Në fund të ditës së parë të prezantimit të temës së re, uluni me anëtarët e stafit dhe diskutoni reagimet e fëmijëve dhe si u ndjenë vetë anëtarët gjatë bisedës ose gjatë praktikimit të aktivitetit – a kishit ndonjë vështirësi? A mendojnë anëtarët e tjerë të stafit se aktiviteti u prit mirë apo nuk kishte reagime apo kishte kundërshtime? Nëse do të zhvillonin sërish të njëjtin aktivitet, çfarë do t'i ndryshonin?
6. Shqyrtoni rregullisht me të gjithë anëtarët e stafit pikëpamjet dhe ndjenjat e tyre.
7. Ri-vlerësoni rregullisht ecurinë dhe ndërveprimin e fëmijës me të tjerët; a është përmirësuar aftësia e tij për të bashkëpunuar dhe ndarë me të tjerët; a ka më pak zënka? Dokumentoni përmirësimet dhe ndikimin që kanë aktivitetet mbi sjelljen e fëmijëve.
8. Në një ditë të caktuar, caktoni punonjës për të vëzhguar një numër të vogël fëmijësh: jepini atyre tregues specifik që duhet të vëzhgojnë dhe të vlerësojnë në lidhje me lojën e përbashkët, ndarjen me të tjerët dhe zgjidhjen e konfliktit. A ka pasur ndikim në ndërveprimet me të tjerët përfshirja në aktivitete për ndërtimin e paqes? Në fund të ditës, diskutoni me të gjithë anëtarët e stafit rezultatet e vëzhgimeve; a kanë pasur ndikim aktivitetet për ndërtimin e paqes ose respektimi diversitetit në nivelin e agresionit të shfaqur

në qendër; a janë më përkujdesës fëmijët ndaj bashkëmoshatarëve të tyre; a tregojnë keqardhje kur mërzhitet një fëmijë tjetër?

9. Anëtarët e stafit mund të zhvillojnë sesione mbi praktikën e tyre për të rishikuar aftësinë e tyre për zhvillimin e aktiviteteve me fëmijët për ndërtimin e paqes. Si mund të mbështesin njeri tjetrin anëtarët e stafit kur kanë vështirësi me ndjenjat dhe sjelljet e tyre? A është e nevojshme një këshilltar i jashtëm ose training?

10. Zhvilloni mënyra kreative për të marrë reagimet nga vetë fëmijët sesi ndihen ata në lidhje me aktivitetet për ndërtimin e paqes.

11. Përfshini prindërit në monitorim dhe vlerësim, kështu ata do të ndihen pjesë e procesit dhe mund të ofrojnë informacion mbi zhvillimin e fëmijës tyre dhe ndikimin e aktiviteteve për ndërtimin e paqes.

12. Vlerësimi duhet të kryhet me çdo fëmijë që në momentin kur ai ose ajo fillon të frekuentojë qendrën e fëmijërisë së hershme. Kushtojini kohë për të njohur më mirë fëmijën, karakterin e tyre, gjendjen e tyre familjare dhe prejardhjen e tyre shoqërore në lidhje me konfliktin.

13. Gjeni se nga ku po ja nisin fëmijët. Cili është niveli i zhvillimit tyre emocional dhe social? A mund të shprehin ndjenjat e tyre? A janë të ndërgjegjshëm për ndjenjat e të tjerëve?

14. Duhet të dëshmoni/vërtetoni zhvillimin social, emocional dhe aftësitë e fëmijëve. Kjo mund të bëhet përmes vëzhgimeve tuaja në lidhje me ndërveprimet të fëmijëve dhe mënyrat si ata shprehen.

15. Gjatë zbatimit të aktiviteteve për ndërtimin e paqes, duhet të caktoni rezultate specifike për Fëmijët.

16. Duhet të rishikoni rregullisht ecurinë e fëmijës. Kjo mund të bëhet përmes vëzhgimit, diskutimit më punonjës të tjerë dhe diskutimit me fëmijën dhe prindërit

Parimet e monitorimit dhe vlerësimit të programit janë baza për:

- **Qasje e etike për të punuar me fëmijët.** Të rriturit mbrojnë dhe mbështesin të drejtat e fëmijëve duke u konsultuar me t'ua dhe duke i dëgjuar ata. Tipari më i rëndësishëm gjatë konsultimit me fëmijët është se fëmijët kanë "një hapësirë në të cilën ata mund të ndajnë idetë e tyre pa u kritikuar nga të rriturit"; kanë privatësinë e tyre - për t'u pyetur nëse duan të regjistrohen ose të filmohen për të ilustruar një situatë ose një objekt, (pëlqimi i prindërve duhet të kërkohet gjithnjë përpara se të bëhet aktiviteti ku do të bëhet fotografi apo filmime); e drejta për të dhënë pëlqimin e tyre për të ndarë idetë me të tjerët. Respektimi i çdo fëmije si një individ me të drejta. Të rriturit duhet të reflektojnë në mënyrë kritike në: 1. Pse është e rëndësishme që ata të dinë pikëpamjet e fëmijëve? 2.

Interesat e kujt përfaqësojnë ata? 3. Cili është pozicioni i fuqisë së fëmijëve dhe të rriturve në një situatë të caktuar?

- **Dëgjimi në mënyrë aktive.** Të rriturit duhet të gjejnë kohë për të dëgjuar fëmijët duke u dhënë mesazhin atyre se ata e vlerësojnë perspektivën e tyre; ata duhet të pushojnë dhe të reflektojnë para se t'ju përgjigjen fëmijëve duke treguar që ata të vlerësojnë dhe e marrin në mënyrë serioze komentin e fëmijëve; ata duhet të vendosin dhe të japin një shembull për të tjerët; ata duhet të përpiqen që të regjistrojnë fjalët e fëmijëve në vend se që përqendrohen në komentin e tyre.
- Njohja e mënyrave të ndryshme në të cilat fëmijët shprehin pikëpamjet e tyre.
- Përdorimi i teknikave të ndryshme për të mbështetur fëmijët që të shprehin veten përmes komunikimit jo-verbal. Ndërkohë që dëgjoni fëmijët dhe të rriturit duhet të: reflektoni mbi temat për të cilën ju do të donit të dëgjoni mendimin e fëmijëve; ofroni mënyra të ndryshme me të cilat fëmijët mund të shprehin idetë e tyre - foto, zë, tekst, ilustrim; bisedoni me fëmijët; regjistroni / mbani shënim dhe krahasoni thëniet e fëmijëve; diskutoni çështjet e fëmijëve, ndjenjat dhe besimet e tyre; përpiquni që të përfshini të gjithë fëmijët në mënyrë që askush të mosk ndjehet i lënë pas dore.

Dokumentimi i perspektives së fëmijëve dhe një mundësi për të ndarë analizën e të dhënave dhe interpretimin me të tjerët.

Vazhdimësia e punës me fëmijët

Çfarë vëzhgoni ju?

- A janë fëmijët në gjendje të identifikojnë dhe emërtojnë ndjenjat?
- A janë fëmijët në gjendje të përdorin gjuhën rreth ndjenjave?
- A janë fëmijët në gjendje të njohin ndjenjat e të tjerët?
- A janë fëmijët gjithëpërfshirës?
- A shfaqin ndjeshmëri fëmijët?

Sesionet e Manualit

1. Një ndjenjë të fortë e identitetit dhe përkatësisë

Aktivitetet

Diskutime / komunikimi Gjuha

Tregim historish

Aktivitete Artistike

Personazhet kukulla

Lojra kreative/ imagjinare

Kërcim/ muzikë

Aktivitetet në natyrë

Treguesit e ndryshimit:

- Fëmijët janë në gjendje të shprehin ndjenjat dhe t'i lidhin ato me përvojat e tyre (dëshmi për këtë është përmes vëzhgimeve)
- Fëmija është në gjendje të shprehë zgjedhjet apo preferencat e tij pëlqyese ose jo (vëzhgimet)
- Njëpërmjet lojrave krijuese dhe imagjinare fëmijët luajnë janë në gjendje të shprehin identitetin dhe aspiratat e tyre (dëshmi për këtë gjendet në punën e fëmijëve)

2. Të qëniti i ndërgjegjshëm për nevojat e të tjerëve

Aktivitetet

Diskutime / komunikimi Gjuha
Tregim historish
Aktivitete Artistike
Personazhet kukulla
Lojra kreative/ imagjinare
Kërcim/ muzikë
Aktivitetet në natyrë

Treguesit e ndryshimit:

- Fëmija është shumë i vetëdijshëm për ndjenjat e të tjerëve
- Fëmija mund të njoh ndjenjat e të tjerëve
- Fëmija është më i vetëdijshëm për ngjashmëritë dhe dallimet
- Përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet
- Njëpërmjet vëzhgimeve të lojës me role fëmijët janë në gjendje të ndjenjnë se çfarë është të jetë dikush tjetër - dmth nëna, babai, fëmija, gjyshi, mjeku, infermierja, dentist
- Fëmija është më i vetëdijshëm për dallimin mes sjelljeve të dobishme (vëzhgimet bashkëveprimet tregues të ndjeshmërisë)
- Ndërveprimet me personazhet kukulla

3. Fëmijët repsketojnë dallimet/diversitetin

Aktivitetet

Diskutime / komunikimi Gjuha
Tregim historish
Aktivitete Artistike
Personazhet kukulla
Lojra kreative/ imagjinare
Kërcim/ muzikë
Aktivitetet në natyrë

Treguesit e ndryshimit:

- Fëmijët kanë kureshtje për dallimet dhe e shohin në një mënyrë pozitive (dëshmi për këtë është përmes vëzhgimeve të ndërveprimeve të fëmijëve me stafin dhe njëri-tjetrin)
- Fëmijët e janë më shumë të vetëdijshëm për festivalet, muzikën, valle, kulturën apo veshjet e traditave të ndryshme (vëzhgimet)
- Fëmijët zhvillojnë një inteligjencë të mirë emocionale

- Fëmijët janë në gjendje të shprehin ndjenjat dhe emocionet
- Njohin ndjenjat në vetvete dhe të tjerët
- Njohin gjuhën e trupit lidhur me ndjenjat dhe emocionet
- Fëmijët janë më të aftë për të rregulluar emocionet

4. Fëmijët mund të shprehin ndjenjat e tyre në një sërë mënyrash (inteligjenca emocionale)

Aktivitetet

Diskutime / komunikimi Gjuha
 Tregim historish
 Aktivitete Artistike
 Personazhet kukulla
 Lojra kreative/ imagjinare
 Kërcim/ muzikë
 Aktivitetet në natyrë

Treguesit e ndryshimit

- Fëmijët janë në gjendje të emërojnë ndjenjat
- Fëmijët janë të vetëdijshëm për gjuhën e trupit lidhur me ndjenjat
- Fëmijët janë në gjendje të lidhin ndjenjat me përvojën

ii. 5. Fëmijët zhvillojnë aftësitë e të dëgjuarit (Vetë-shprehja dhe Vetë-aktualizimi)

Aktivitetet

Diskutime / komunikimi Gjuha
 Tregim historish
 Personazhet kukulla
 Muzike dhe kërcim
 Lojra

Treguesit e ndryshimeve:

- Fëmijët janë të aftë të dëgjojnë të tjerët 1/1 dhe në grup
- Fëmijët e vlerësojnë kontributin e të tjerëve duke i dëgjuar

4. 6. Fëmijët ndjehen të sigurtë dhe të mbrojtur

Aktivitetet

Diskutime / komunikimi Gjuha
 Tregim historish
 Personazhet kukulla
 Muzike dhe kërcim
 Lojra

Treguesit e ndryshimit:

- Fëmijët mund të shprehin ndjenjat e tyre rreth ndjesive të qënurit të sigurtë/të frikësuar
- Fëmijët janë më të vetëdijshëm se si të jenë të sigurtë

- Fëmijët dhe të rriturit zhvillojnë strategji për ti ndihmuar ata që të jenë të sigurtë.

5. 7. Fëmijët kanë aftësi në zgjidhjen e konflikteve

Aktivitetet

Biseda, komunikim gjuhësor
Tregimi historive
Personazhet kukulla
Muzika dhe Lëvizjet
Lojrat

Treguesit e ndryshimit:

- Fëmijët janë në gjendje që të zgjidhin problemet në mënyrë jo-agresive
- Fëmijët bashkëpunojnë me njëri-tjetrin
- Fëmijët shfaqin ndjeshmëri

6. 8. Fëmijët shfaqin elasticitet

Aktivitetet

Diskutime / komunikimi Gjuha
Tregim historish
Aktivitete Artistike
Personazhet Kukulla
Loja creative/ imagjinare
Kërcimi / muzikës
Lojrat

Treguesit e ndryshimit:

- Fëmijët mund të flasim për frikën e tyre
- Fëmijët mund të flasim rreth se si ata zgjidhin problemet
- Fëmijët mund të marrin vendime
- Fëmijët mund të marrin përgjegjësi për detyra të vogla
- Fëmijët shfaqin ndjeshmëri
- Fëmijët shfaqin besim

i. 9. Fëmijët kanë një ndjenjë të fortë të familjes dhe komunitetit

Aktivitetet

Diskutime / komunikimi Gjuha
Tregim historish
Aktivitete Artistike
Personazhet Kukulla
Loja creative/ imagjinare
Kërcimi / muzikës
Lojrat

Treguesit e ndryshimit:

- Fëmijët flasin për familjet dhe komunitetet në një mënyrë pozitive dhe të ngrohtë
- Fëmijët mund të flasim se si mund të jenë të dobishëm në familjen dhe komunitetin e tyre
- Fëmijët flasin për vendet ku ata shkojnë në komunitetin e tyre në një mënyrë pozitive
- Fëmijët flasim për festivalet në komunitetin e tyre
- Fëmijët bëjnë lojë me role duke luajtur rolin e një anëtarit familje ose të dikujt në komunitet p.sh. nëna, babai, fëmija, gjyshi, infermierja, doktori, mësuesi, shitësi apo ndërtuesi.

Teknikat e përdorura në këtë program përfshijnë hartat, modelet, diagramet, vizatimet, intervistimin, lojë me role, tregimët dhe duke lojrat me personazhet kukulla. Ata duhet të të dizajnohen në atë mënyrë që të inkurajojnë fëmijët të shprehin veten e tyre, të.

Si duket ky process – perspektiva e fëmijëve/të rriturve¹

Cështja	Pyetjet	Teknikat
Si e perceptojnë ata kopështin?	Pse mendoni se vini në kopësht? Si e dini ju që është një vend për fëmijët? Çfarë mund të thoni për një fëmijë që nuk e shkon në kopësht, pse duhet ai / ajo t'a frekuentojë kopështin?	Hapi 1: Biseda
Si i perceptojnë ata aktivitetet në kopësht?	Cfarë të pëlqen të bësh më shumë në kopësht? (Përse? Me kë? Kur mun t'a bëni? Kush e mori vendimin?) Cfarë pëlqeni më pak (Përse? Cfarë bëni aty? A mund të refuzosh për mos t'a bërë këtë gjë? Kush vendos? ...)	Hapi 2: Bërja e fotografive dhe përdorimi i tyre gjatë bisedave
Si i përdorni mjediset e kopështit?	Më trego se ku shkon kur futesh në kopësht? Ku e shpenzon kohën më të gjatë? Përse atje? Kur shkon përsëri? Përse nuk shkon asnjëherë atje?)	Hapi 3: Harta
Cfarë lloj kopështi do të donin ata të kishin?	Cfarë do të bëjë në ditën tënde më të bukur në kopësht? (Kush do të ishte aty? Ku do të ishte? Si do të dukej? Ku do të ishin mësuesit/edukatorët, cfarë do të bënin ata? A do të kishte të rritur të tjerë, cfarë do të bënin ata?)	Hapi 4: Vizatimi dhe biseda

¹Kur flisni me prindërit, pyesni për fëmijët e tyre

Përdorimi i teknikave të ndryshme

Bisedat

Intervista: shih Hapi 1. Ju mund të ktheheni tek hap 1 duke përdorur hartat, fotografi dhe vizatime si një nxitje për një bisedë më të detajuar (për shembull: A ju kujtohet kur unë ju pita se përse fëmijët duhet të shkojnë në kopësht? Tani që shihni fotografitë dhe vizatimet tuaja, a ju vijnë ndërmend ide të tjera, do të dëshironit të shtoni diçka?)

Biseda: së bashku me të gjitha teknikat e tjera (hartat, bërja e fotografive, vizatimet – hapat 2, 3, 4) filloni një bisedë për të shpjeguar se çfarë do të bëni dhe kush është detyra e tij / saj. Ju mund të nxisni fëmijën të zgjasë shpjegimet e tij / saj dhe përshkrim nëpërmjet pyetjeve që mund t'i bëni, por duhet të jeni të kujdesshëm për të mos e shkëputur atë nga tema.

Biseda e bazuar në fotografi ose vizatime: hapi 2 dhe 4. Pyesni fëmijët në lidhje me përmbajtjen e ilustruar me fotografi ose vizatime duke marrë sqarime shtesë (p.sh. Çfarë është duke bërë këtu mësuesi; Kush është ai / ajo? Cilët janë fëmijët etj???)

Harta

Para hartës: bëni një skicë / projekt të kopshtit brenda duke përfshirë hyrjen dhe sallën e pritjes (sallë, banjo, zona ngrënie, klasat, dhomë të përbashkët, palestër, etj) dhe lini jashtë oborrin. Pikturoni lehtë vijat dhe shkruani emrat e dhomave. Tregojini fëmijëve atë që keni bërë dhe theksoni qartë se çfarë do të donit të dini (hapi 3, pyetja 1).

Kërkojini fëmijës që t'ju shëtisë nëpër kopësht duke filluar që hyrja kryesore. Lëreni fëmijën që të zgjedhë vetë rrugën e tij / saj duke vizatuar vijat dhe bëni pyetjet e dhëna në hapin 3. Kur fëmija të përqëndrohet tek zona ku qëndron më shumë, drejtoji pyetje të përcaktuara në hapin 3 lidhur me atë vend (p.sh. në klasë) dhe lëreni fëmijën që të shënojë lëvizjet e tij / saj dhe veprimet në atë dhomë gjatë gjithë ditës – ju duhet të etiketoni vendet e caktuara (për shembull: studio arti, kuzhinë, tavolina, krevati etj).

Bërja e fotografive

Bëni pyetjet nga hapi 2. Do të ishte më mirë nëse i printoni fotografitë më parë dhe pastaj të flisni rreth tyre. Bisedoni duke ndjekur udhëzimet e dhëna në seksionin *Biseda*. Nëse ju mohohet leja për të marrë fotografi, ju mund të përdorni vizatimet si zëvendësim (por vetëm nëse është e pamundur për të marrë fotografi).

Vizatimi

Prezantoni fëmijën për temën dhe pyesni atë se për çfarë ka nevojë. Jepini lapsa me ngjyra dhe një fletë letre. Ndërkohë që fëmija vizaton, flisni me të dhe pasi të ketë përfunduar vizatimin, diskutoni rreth vizatimit duke ndjekur udhëzimet nga kapitulli i Bisedës.

Shtojca 1

Historia “Qyteti i Ndjenjave”

Na ishte njëherë, në një qytet shumë të largët, një grup njerëzish të ndryshëm që jetonin në shtëpi të lyera me ngjyra të ndryshme. Rreth shtëpive kishte pemë të vogla, pemë të mëdha, të verdha, të kuqe, lule lejla. Kishte dhe shumë insekte si milingona, bletë dhe merimanga të vogla që i kalonin ditët duke folur dhe qeshur me njëri-tjetrin. Por a doni të dini se kush jetonte në shtëpitë shumëngjyrëshe?

Në shtëpinë blu, jetonte, Frika, në shtëpinë e kuqe, Mërzitja, në atë të verdhën jetonte Lumturia dhe në atë jeshilen jetonte e vogla Ema.

Frika rrinte gjithmonë në shtëpinë e saj blu, ajo nuk kishte qejf të dilte jashtë dhe të shikonte pemët dhe lulet e bukura. Në fakt ajo gjithmonë mendonte se nëse do të dilte jashtë, do t’i binte një pemë, ose lulet do të talleshin me të. Frika gjithashtu mendonte se nëse ajo dilte jashtë nga shtëpia, do të binte një stuhi dhe ajo do të lëndohej. Frika gjithmonë frikësohej nga çdo gjë. A mund të imagjinoni se sa e vështirë është të jetoni si ajo?

Mërzia, e cila jetonte në shtëpinë e kuqe, qante gjatë gjithë kohës. Mërzia shpesh ecte rreth shtëpisë së saj, por nuk shkonte shumë larg pasi sa herë që shkelte në bar, ajo ndjehej e mërzitur që lëndonte barin me hapat e saj. Pas ecjeve që bënte rreth shtëpisë, ajo ktheheshte brënda saj duke qarë sepse duhet t’i thoshte lamtumirë pemëve, luleve dhe insekteve. Çdo gjë do ta mërziste shumë atë dhe sytë i ishin bërë më të mëdha se një kokërr limoni ngaqë qante tërë ditën.

Në shtëpinë e verdhë jetonte Lumturia. Ajo gjithmonë qeshte dhe tregonte histori për të qeshur. Ajo ishte aq e lumtur aq sa nuk i kushtonte vëmendje askujt; ajo donte vetëm të qeshte dhe të gëzonte gjatë tërë ditës. Ajo gjithmonë mendonte se ishte e lumtur me jetën e saj dhe se nuk kishte nevojë për askënd që të kalonte ditën, kështuqë ajo rrinte në kopshtin e saj gjatë gjithë ditës duke treguar histori për të qeshur për milingonat, lepujt, luleve dhe pemëve. A mendoni ju se Lumturia nuk kishte nevojë për miq?

Dhe në shtëpinë e fundit jetonte e vogla Ema. Ajo ishte e re në qytet. Ajo kishte marrë me vete një valixhe plot me lodra, rroba me ngjyra dhe gatime që i’a kish të dhënë gjyshja e saj para se të ikte.

Pasi disa ditësh që ajo u rehatua në shtëpinë e saj jeshile, filloi të mendonte: “Duhet të dal jashtë që të takoj fqinjët e mi; ndoshta mund të organizoj një festë për t’i takuar të gjithë.” Kështu Ema përgatiti disa ftesa me vizatime shumë të këndshme dhe në to shkruajti: “Unë jam Ema dhe jam banore e re në qytet. Unë do të kisha shumë dëshirë që t’ju takoja të gjithëve dhe për këtë arsye do të përgatis një drekë të shijshme të Shtunën në orën 1. Jeni të ftuar që të merrni pjesë dhe të kalojmë një kohë të këndshme sëbashku në këtë festë!”

Ema nuk e dinte se sa komshinj do të takonte por vendosi të bënte 15 ftesa.

Ajo doli jashtë shtëpisë dhe takoi banorin e parë në këtë qytet, një zog të bukur të verdhë me krahë të gjatë dhe zë shumë të bukur.

Zogu i tha: “Oh ju jeni e re në këtë qytet? Emri im është Kiki, po i yti? Ema u gëzua pa masë që takoi mikun e parë në qytet dhe prezantoi veten: “Emri im është ema dhe sapo kam ardhur në shtëpinë jeshile. Në fakt po dal për një shëtitje që të njoh fqinjët dhe t’ju ftoj në një festë për t’u njohur me të gjithë.”

Zogu Kiki u lumturua kur dëgjoji këtë gjë dhe i dha asaj disa udhëzime se ku mund t’i gjejë komshinjtë e tjerë, Frikën e cila jetonte në shtëpinë blu, Mërzinë e cila jetonte në shtëpinë e kuqe dhe Lumturinë e cila jetonte në shtëpinë e verdhë. Kiki mori një ftesë për vete, familjen e tij dhe për kafshët dhe insektet e tjera, dhe fluturoi larg për tek foleja e tij.

Ema vazhdoi të shpërndante ftesat tek komshinjtë që Kiki e kishte rekomanduar.

Dita e madhe erdhi, ishte e Shtunë dhe Ema kishte përgatitur bukë të shijshme, xhelatina të ndryshme, lëng frutash të freskët dhe e kishte dekoruar shtëpinë plot me tullumbance me ngjyra.

Në orën 1, të ftuarit filluan të vinin dhe të gjithë e shijuan drekën dhe u takuan me njëri-tjetrin. Pas drekës së shijshme, të gjithë u ulën dhe po bisedonin.

Zogu Kiki, foli për familjen e tij e cila jeton në fole dhe se sa krenar ishte ai për 10 fëmijët e tij. Insektet i treguan Emës se çfarë bënin gjatë ditës, si i ndërtonin strehëzat e tyre apo si mblidhnin ushqim për komunitetin e tyre.

Më vonë erdhi rradha e Frikës e cila tha: “E dashur Ema, zakonisht unë nuk dal jashtë shtëpisë time sepse kam shumë frikë se mos më ndodh diçka e keqe. Por sot erdha sepse kasha shumë dëshirë të të njihja, dhe se kam shumë kohë pa dal jashtë.” Ema u habit pa masë por ajo e falendero Frikën që ndau me ta frikërat e saj dhe vazhdoi të dëgjonte të ftuarit e tjerë.

Mërzia mori rradhën e saj dhe tha: “Ema, shumë faleminderit për ftesën tënde, zakonisht unë eci rreth e rrotull shtëpisë time por ndjehem kaq e mërzitur kur shkel barin dhe kur i them mirupafshim miqve të mi, luleve dhe pemëve sa që përfundoj duke qarë tërë ditën. Mendova se nuk do t’ja dilja sot por isha shumë kurioze të të njihja saqë vendosa tëvi.”

Ema ishte shumë e habitur se si këto komshinj kanë jetur kaq të ndarë nga njëri-tjetri, por ajo vazhdoi të dëgjonte të ftuarën tjetër, Lumturinë e cila tha: “E vogla Emë, në fillim mendova se nuk kasha nevojë të vija në këtë festë sepse unë jam e lumtur gjithsesi.... por ashtu siç thanë edhe të tjerët, isha me të vërtetë kurioze të të njihja dhe vendosa të vija.”

Pasi të gjithë të ftuarit folën, Ema vendosi të ndante disa gjëra për veten e saj. “Siç e dini unë jam e re në këtë qytet. Kur jetoja në qytetin tjetër, mora një ftesë për të punuar në një dyqan këtu. Isha aq e lumtur sa u ndjeva si Lumturia, mendoja se nuk kasha nevojë për askën pasi isha e lumtur aq sa doja. Njerëzit vinin për të më përgëzuar dhe mua nuk më bënte përshtypje.” Lumturia e pa Emën e habitur se si dikush mund të kishte ndjenja të ngjashme me atë.

Ema vazhdoi me historinë e saj: “Kur e kuptova që duhej të lëvizja kaq larg, kisha shumë frikë dhe u ndjeva si Frika. Nuk doja të vija dhe nuk e bëra valixhen time gati për dy ditë. Pas kësaj, gjyshja ime më tha se unë do të takoja shumë miq të rinj dhe të mirë dhe për këtë arsye fillova të përgatisja gjithçka për të ardhur këtu.” Frika gjithashtu u habit kur dëgjoji se nuk ishte e vetmja që kishte ato lloj ndjenjash.

Më në fund Ema tha: “Kur mbërrita në qytetin tuaj, nuk njihja askënd dhe u ndjeva pak e mërzitur. Qaja për gjithçka, njësoj si Mërzia. Por pastaj mu kujtua se çfarë më tha gjyshja dhe vendosa të organizoj këtë festë.” Edhe Mërzia u habit shumë kur dëgjoji fjalët e Emës dhe kur kuptoi se nuk ishte e vetmja e mërzitur që qante.

Ema u tha miqve të saj: “Të gjitha emocionet që ju ndjeni janë normale dhe nuk duhet të rrini në shtëpi vetëm se ndjeheni në atë mënyrë. Ashtu siç mund ta shihni edhe vetë, është e mundur që të rrini me të tjerë dhe të ndani ato që ndjeni. Sa herë që të ndjeheni të mërzitur apo të frikësuar, flisni me mua, me miqatë apo me fqinjët tuaj dhe do të ndjeheni më mirë ashtu siç po ndjehem unë tani. Për shkak të kësaj feste, unë nuk jam më e mërzitur sepse unë u takova me ju.”

Festa mbaroi me Emën duke falenderuar të gjithë miqtë e saj. Të gjithë të ftuarit e falenderuan Emën që i ftoi dhe që do të jetë mikja e tyre nga ajo ditë. Gjithashtu, ata i prematuan njëri-tjetrit që gjithmonë do të ndajnë me njëri-tjetrin ndjenjat që i bezdisin dhe kështu do të ndjehen më mirë.

Ema shkoi të fle shumë e lumtur që dita shkoi mirë dhe për faktin që bëri shumë miq; mië që kanë ndjenja si ajo dhe me të cilët ajo mund të ndajë këto ndjesi nga ajo ditë.

Shtojca 2

Historia “Foshnja në Djep”

Shënim: Mos harroni t’i kujtoni fëmijëve që të imitojnë tingujt e kafshëve dhe të imitojnë lëvizjet e tyre ndërkohë që ju lexoni.

Në një pyll që ndodhej shumë larg, jetonin tre bretkosa. Ata të gjitha kishin qejf të këndonin. (Edhe pse e vërteta ishte që ata nuk kishin zëra të bukur.) Një ditë ata vendosën që të praktikoheshin buzë lumit.

“Kokak-kak-kuak-kak-kak!” këndoi bretkosa e parë.

“Ribit - rribit,” këndoi bretkosa e dytë

“Kroak-kroak-kroaaaaaaak,” i’a mori e treta.

Por ata papritmas ndaluan kur dëgjuan....

“Uaaaaa! Uaaaaa! Uaaaaa!”

Ata panë një djep që po lundronte mbi lum. Kur u afruan, u mrekulluan të gjithë, brënda në djep ishte një foshnje.

“Bebe! Bebe! Përse po qan?”, pyeti bretkosa e parë. “Përse je brënda në djep?” pyeti me kuriozitet bretkosa e dytë? “Ku është familja jote?” shtoi e treta. “Uaaa! Uaaa! Uaaaaaaaaaaaaa!” ishte përgjigja e foshnjes. “Ai nuk ka familje?” po pyeste bretkosa e parë ndërkohë që po kruante kokën. “Ai ka nevojë për një familje që të kujdeset për të,” psherëtiu bretkosa e dytë. “Po kjo gjë nuk është problem! Ne do të gjejmë një familje për atë!” tha e treta. Të tre bretkosat ranë dakord që të kërkonin për një familje për foshnjen e vogël në djep. Në fillim ata takuan dy dhi. “Meee...Meee...Ne kemi bar të freskët për foshnjen,” tha dhia. “Por foshnjet nuk hanë bar,” thanë bretkosat duke u përshëndetur me një shtrëngim duarsh. “Aakk! Aakk! Ai fëmijë do të jetonte i sigurtë nëse do të ishte me mua këtu lart në follenë time të guximshme,” qau një sorrë zonjë. “Por foshnja nuk mund të jetojë në një fole,” shpjeguan bretkosat. Grrrr! Grrrr! Foshnja do të jetë më i sigurtë me mua!” foli me mburrje një çift luanësh të moshuar. “Të gjithë të rrezikshmit e pyllit kanë frikë nga unë!”. “Nëse ne kujdesemi për të, ai do të bëhet inteligjent si ne,” tha çifti i vjetër. “Ne do t’i lexojmë atij të gjithë librat tonë!” “Ssss! Ssss! Me siguri që ne do të kujdesemi për foshnjen,” tha babai gjarpër. “Ne do t’a duam atë njësoj si të ishte fëmija ynë.” “A mund t’i japim asaj foshnje një përfaqim?” pyeti me padurim mamaja gjarpër ndërkohë që filloi të rrotullohej rreth qafës së foshnjes. “Prit! Lëre foshnjen të shkojë!” bërtitën bretkosat. “Lloji juaj i dashurisë po e mbyl atë.” Nga pylli u mblodhën edhe më shumë kafshë. Ata u vunë në rrjesht. Secili prej tyre kishte diçka që i duhej foshnjes. Secili prej tyre u ofrua që të kujdesej për të. Por tre bretkosat akoma nuk vendosnin dot se kush duhej të kujdesej për foshnjen. “Dikush po vjen!” bërtitën tre bretkosat ndërkohë që një çift po i afrohej lumit. bretkosat u fshehën më një shpejtësi marramendëse. Ata po shinin duke mos bërë zhurmë, burrin dhe gruan që po ecnin në lumë drejt djepit. “Është një foshnje!

Një foshnje brenda djepit!” Uaaaaa! Uaaaaa! Uaaaaa!” “Ai ka nevojë për një familje që të kujdeset për të. Unë mendoj që ta marrim dhe ta bëjmë fëmijën tonë,” tha çifti ndërkohë që po përqafonin foshnjen. Tre bretkosat e ndoqin çiftin deri sa arritën në shtëpinë e tyre. Nëpërmjet një të care nëmur, ata mund të shihnin se si çifti ndihmonte njëri-tjetrin për t’i vendosur bebilinën foshnjes, për t’a veshur dhe për ta përkundur që ta zinte gjumi. “Si t’ja vëmë emrin? Ne duhet ti vendosim një emër atij.” “Le ta quajmë Noel!” Tre bretkosat panë njëra-tjetrën. Më në fund foshnja kishte një familje. Ata ishin aq të lumtura sa i’a morën këngës sapo u kthyen tek lumi. Çifti u hutua kur dëgjoi bretkosat. Foshnja hapi sytë e tij, hodhi një vështrim përreth dhe buzëqeshi.

Shtojca 3

Historia “Breshka dhe Lepuri”

Një ditë, një lepur po mburrej se sa shpejtë mund të vraponte ai. Ai, mburrej e mburrej dhe qeshte edhe me breshkën e cila ishte shumë e ngadaltë.

Breshka, nxorri nga guacka e saj qafën e gjatë dhe e sfidoi lepurin që të bënin një garë, kërkesë e cila e bëri lepurin që të qeshë.

“Hajde, hajde çfarë gallate!” - mendoi lepurin. “Një garë, me të vërtetë një garë.”

Breshka tha: “ti mund të jesh më i shpejtë nga mua, sigurisht, ti e ke një talent të madh për të vrapuar. Por unë do të të tregoj që mund të të mund!”

Kafshët e pyllit u mbledhën dhe përcaktuan rrugën ku do të bëhej gara. gara filloi dhe lepurin, duke qënë një vrapues i thjeshtë, shumë shpejt e la breshkën mbrapa. Në gjysëm të garës, lepurin vuri re se kishte shumë kohë në dispozicion për të mundur breshkën e ngadaltë.

“Oh Zot!” - mendoi lepurin - “Unë kam tërë këtë kohë për të luajtur në këtë lëndinë.” Dhë kështu bëri. Pasi lepurin mbaroi së luajturi, a vendosi se kishte kohë për të bërë edhe një sy gjumë. “Kam tërë këtë kohë për të mundur breshkën,” - mendoi ai. U mbështet pas një peme dhe filloi të dremiste. Më në fund, lepurin u zgjua nga gjumi. “Koha për të vazhduar,” - mendoi ai.

Lepurin filloi të vraponte edhe më shpejt nga më parë! Ai u drejtua vijës së finisht me një shpejtësi marramendëse dhe takoi breshkën e cila etësisht po priste për ardhjen e lepurit.

“E shikon, ti mund të jesh më i shpejti për të vrapuar në këtë pyll, por unë kam talente të tjera! Unë jam shumë e zgjuar! Ja përse fitova me kaq lehtësi!”

Shtojca 4

Historia “Luani dhe Miu”

Në një ditë me diell në Savana, një mi i vogël po luante me miqtë e tij rreth një Baobabi të madh. Ato po vraponin rreth e rrotull pemës, duke u fshehur në për vrima dhe duke kërcyer lart e poshte nëpër degë.

Luani, mbreti i Kafshëve, po flinte qetësisht duke shijuar hijen poshtë pemës.

“Jam i sigurtë që nuk do të guxoje t’i afroheshe atij luani të madh!” - i tha një Mi, Miut të vogël. “Jam i sigurtë që do të guxoj! Unë jam aq trim dhe nuk kam frikë nga luani!” - i’u përgjigj Miu i vogël. “Epo, nëse je kaq trim, përse nuk i afroresh Luanit?” - e pyeti miku i tij. Miu i vogël buzëqeshi, pa Luanin dhe mendoi se mund të shkonte shpejt e shpejt afër tij dhe të largohej menjëherë.

Ai, mori frymë thellë dhe vrapoi afër Luanit, duke u kujdesur që të mos t’u prekte atë apo ta zgjonte. Më pas ai shkoi me vrap drejt shokut të tij. “Ah, por kjo ishte shumë e lehtë,” - tha miu tjetër kur ai u kthye duke marrë frymë me vështirësi dhe shpejtë nga vrapit i shpejtë dhe nga frika gjithashtu. “Çdokush mund t’u bëjë atë!” - po tallej miu tjetër. “Por a do të guxoje të prekje bishtin e luanit?” - tha ai.

Miu i vogël filloi të ndjente pak frikë, por ishte shumë krenar për ta anashkaluar sfidën dhe vendosi t’u pranojë atë. Ai pa nga luani, mori frymë thellë, vrapo në drejtim të bishtit të luanit, e preku dhe u kthye me vrap të shpejtë. Luani po flinte aq thellë sa që ai nuk lëvizte fare, përveçse një tundje të lehtë të bishtit pasi po mendohej të largonte një mizë të bezdisshme.

“Në rregull në rregull”, - tha miu tjetër. “E pranoj që ti je më guximtar se sa unë mendoja. Por a do guxoje të shkoje dhe të prekje hundën e luanit dhe të tërhiqje një nga qimet e mustaqeve të tij dhe të kthehesh përsëri?”

Kësaj here miu i vogël u frikësua shumë, por Luani dukej se po flinte aq thellë sa që Miu i vogël mendoi se mund t’u dilte pa e zgjuar atë. Ai bëri një hap fluturues, hypi mbi kurrizin e luanit dhe filloi të shkante afërt mustaqeve të tij, por ndërkohë luani u zgjua, e kapi Miun e vogël nga kurrizi dhe e vuri poshtë putrës së tij të madhe. Ai e hapi gojën e tij të madhe dhe do ta gëlltiste me një të kafshuar Miun e vogël nëse Miu nuk do të fillonte të qante. “Më fal o Mbret!” - tha ai. “Më fal këtë herë” “Përse duhet të të fal?” - e pyeti Luani duke qeshur. “Më jep një arsye të mirë se përse nuk duhet të të ha!” “Nëse më lë të gjallë, unë kurrë nuk do të ta harroj: Ndoshta, ndonjëherë unë mund të t’u kthej nderin!” Luani shpërtheu duke qeshur “Hahahahahaha,” - ai tha, “Ti je një Mi i cuditshëm! Nuk mund të imagjinoj se si një mi i vogël si ti mund të më shpërblejë një nder që më shpëton jetën, apo diçka tjetër!”

Por luani u ngacmua nga ideja se si një Mi i vogël mund të mbajë premtin e tij... dhe gjithashtu ai admiroi kurajon dhe krenarinë që Miu kishte treguar dhe për këto arsye ai vendosi që të mos e vriste miun dhe e ngriti putrën e tij për t’u lënë të lirë atë. “Ti je një Mi guximtar dhe unë jam kurioz të shoh se si mund t’u mbash premtimin tënd... Do të të lë të ikësh. Kush e di, ndoshta do të takohemi përsëri!” - qeshi ai, duke u tallur me Miun e vogël i cili ndërkohë po vraponte me sa shpejtësi mundej.

Disa ditë më vonë, ndërkohë që luani po ndiqte një sorkadhe, ai ra në një kurth të ngritur midis disa pëmvë nga disa gjuetarë. Papritmas, luani e gjeti veten të kapur në një rrjet që varej në një pemë dhe sa më shumë përpiquej për të dalë nga ajo, rrjeti e mbështillte edhe më shumë. Ai ishte aty, brënda një rrjete të varur në pemë, duke pritur që gjuetarët të vinin dhe ta vrisnin kur ndërkohë pa miun e vogël që po kalontë aty afër.

“Çfarë ndodhi o Mbret?!” “Oh mike i’ m! Sa i pafat që jam...po vrapoja pas një sorkadheje dhe përfundova në këtë rrjetë... Për mua s’ka më shpëtim, vecse të pres për gjuetarët që të vinë e të më vrasin,” - dhe po qante. “Oh i dashuri im Luan, mos qaj! Unë do të të kthej lirinë!” - tha Miu i vogël.

Dhe shpejt e shpejt ai vrapoi për të hypur në pemë, kafshoi rrjetën duke krijuar një vrimë duke bërë që Mbreti i Kafshëve të kërcejë jashtë rrjetës dhe të shpëtonte. “Faleminderit Miu im i vogël!” - tha Luani. Që nga ajo ditë, disa njerëz thonë se kanë parë një luan të të madh që mban gjithmonë një mi të vogël në kurrizin e tij.

Shtojca 5

Historia “Arbeni Kalon Kohën me Miqtë e Tij”

Është një mëngjes i bukur dhe me diell. Arbeni zgjohet herët sepse ai ka dëshirë që të ketë shumë kohë për të kaluar me familjen dhe miqtë tij. Edhe kur koha është e keqe (me mjegull) dhe është ftohtë, ai zgjohet herët në mëngjes. Ai ndihmon mamën dhe babën që të përgatisin mëngjesin. Pastaj, Arbeni bëhet gati që të shkojë tek këndi i lojrave për t’u takuar me shokët dhe shoqët e tij.

“A i lave dhëmbët?” e pyet mamaja e tij ndërkohë që e ndihmon për t’i veshur pantallonat dhe këpucët e tij.

“Po mami! Unë mbarova me dhëmbët!” Qesh ai me krenari. Arbeni ka shumë dëshirë që të mësojë për t’i bërë gjërat vetë.

Më pas Arbeni dhe prindërit e tij shkojnë tek këndi i lojrave për t’u takuar me miqtë e tij. Jona, Misheli, Tomi dhe Sara janë duke luajtur në bar dhe kur shohin Aflatunin e përshëndësin me dorë.

“Mirmëngjës Arben, hajde të luajmë sëbashku!” i thotë Sara. “Përse je kaq vonë? Çfarë po bëje? Pyet Tomi.

“Ndhimova mamën dhe babën të përgatisnin mëngjesin për mua dhe vëllain. Unë ndihmova në shtrimin e tavolinës dhe pastrimin e saj pasi mbaruam së ngrëni.”

Arbeni dhe miqtë e tij e kalojnë kohën duke luajtur sëbashku. Ata luajnë kukafshehti, dhe duke ndjekur njëri-tjetrin. Ata shpikin lojra të reja. Ata i tregojnë njëri-tjetrin histori të ndryshme. Ata gjithashtu kanë shumë dëshirë që të zbulojnë gjëra të reja. Arbeni dhe miqtë e tij janë shumë kurioz! Arbeni dhe miqtë e tij gjejnë një fole të madhe milingonash afër një shkurreje. Arbeni dhe miqtë e tij kalojnë pak kohë duke parë se çfarë bëjnë milingonat. Ata kërkojnë për ushqim dhe formojnë rrjeshta të gjatë dhe secila prej tyre sjell ushqim në shtëpi. “Sa të zellshme që janë këto milingonat!” – mendon Arbeni.

“Mirë atëherë, është koha që unë të kthehem në shtëpi!” – thotë Arbeni.

“Po, po bëhet vonë dhe mami më tha që të jem në shtëpi për të ngrënë drekën!” – thotë Jona.

“Unë po vi me ty dhe në këtë mënyrë mund të flasim bashkë gjatë rrugës!”

“Hë more dhe ju! Është shumë herët për të shkuar në shtëpi! Hajde të luajmë edhe pak!” – thotë Tomi.

Po Arbeni dhe shoqa e tij Jona e dinë që ka një kohë për çdo gjë: ka një kohë për të luajtur, një kohë për të shkuar në shkollë dhe një kohë për të ndihmuar në shtëpi! Dhe gjithmonë është e rëndësishme që të bëjmë atë që na thotë mami dhe babi. “Faleminderit Tomi, por ne duhet të shkojmë patjetër në shtëpi! Mami po përgatit drekën dhe është mirë që të jem aty në kohë për t’u ndihmuar në shtrimin e tavolinës! Edhe pse unë po kënaqesha duke luajtur, tani erdhi koha për të shkuar në shtëpi.”

Atë ditë, Jona e ftoi Arbenin që të shkonte për darkë në shtëpinë e saj bashkë me familjen e saj. Arbeni është shumë i ka shumë dëshirë që të kalojë kohë me shoqen e tij. Arbeni shkon në tek shtëpia e saj dhe takon familjen e Jonës. Arbeni vëren se çdo njeri në familje ndihmon në punët e shtëpisë.

Mami i kërkon Jonës dhe Arbenit që të shkojnë të blejnë një bukë për darkë. Kështu pra, Arbeni dhe Jona shkojnë tek dyqani ngjitur. Në dyqan ata shohin ushqime të ndryshme që duken shumë të shijshme. Madje në një nga muret e dyqanit është një poster i madh me një akullore që duket shumë e shijshme e cila ta bën me sy për t'a blerë. Arbeni dhe Jona e shohin figurën e akullores dhe duan t'a blejnë por ata vendosin të blejnë bukën dhe nisen për në shtëpi. Buka është ajo që nevojitet për darkën.

Kur mbërrin në shtëpi, shoqja e Arbenit fillon të shtrojë tavolinën e ngrënies ndërkohë që motra e saj pastron. Arbenit i thonë që kjo është ajo që bëjnë fëmijët para se të hajnë dhe në këtë mënyrë ata ndihmojnë mamën dhe babin që ta mbajnë vendin në rregull. Edhe pas ngrënies së darkës, secili prej tyre ndihmon në diçka. Arbeni është i gëzuar kur sheh se si familja ndihmon njëri-tjetrin.

Shumë shpejt vjet koha për të fjetur. Para se Arbeni të ikë, Jona i thotë se sa falenderuese është për këtë ditë të veçantë që kaloi me Arbenin. Edhe Arbeni shprehet i gëzuar që kaloi kohën me shoqen e tij. Ndoshta nesër, ai do të përjetojë një aventurë tjetër. Ku mendoni se do të shkojë herën tjetër?

Shtojca 6

Historia e milingones dhe gjinkalles

Na ishte një herë një milingonë dhe një gjinkallë, të cilat jetonin në një fushë të madhe të gjelbëruar.

Gjinkallës i pëlqente që të këndonte dhe të kërcente gjatë gjithë ditës. Gjinkalla e kalonte ditën nën rrezet e diellit, duke u kënaqur me këngën e saj si dhe duke ndjerë aromën e këndshme të luleve.

Edhe milingonës i pëlqente të këndonte dhe të pushonte, por në vend që ta bënte një gjë të tillë, ajo punonte gjatë gjithë ditës për të mbledhur grurë nga fushat e mbjella me grurë aty pranë. Ajo shkonte dhe vinte nga fusha me grurë deri në shtëpi për të mbledhur sa më shumë grurë për t'i ruajtur si ushqim rezervë për kur të vinte stina e dimrit.

Sa herë që gjinkalla e shihte atë duke punuar qeshte dhe i thoshte:

“Hajde tani edhe ti mikja ime! Nuk e shikon se sa ditë e bukur është sot? A nuk do që të pushosh pak dhe të vish të këndosh me mua?”

Milingona iu përgjigj:

“Do të më pëlqente që të ndaloja dhe të pushoja pak, por dimri po afron, dhe kur të vijë dimri nuk do të ketë ushqim mjaftueshëm. Më duhet të punoj shumë tani që të kem mbledhur ushqim të mjaftueshëm për të jetuar në dimër.”

Dhe milingona vazhdoi rrugën e saj për të mbledhur sa më shumë grurë.

Ndërkohë gjinkalla vazhdoi këngën e saj dhe duke kërcyer nën hijen e një peme të madhe aty pranë.

Vera iku dhe moti filloi të ftohej gjithnjë e më shumë. Ditët filluan të shkurtoheshin dhe netët po bëheshin gjithnjë e më të gjata.

Dimri erdhi.

Ushqimi në fushë u mbulua nga dëborë. Gjinkalla kërkoi e kërkoi gjithandej për ushqim por nuk gjeti dot.

Po vdiste nga uria. Ndaj dhe shkoi t'i kërkonte ndihmë milingonës në shtëpinë e saj dhe kur mbërriti atje trokiti në derë.

“Përshëndetje milingonë” – tha gjinkalla duke qarë. – *“Oh mikja ime. Po ngrij së ftohti këtu jashtë dhe nuk kam asgjë për të ngrënë. Të lutem më ndihmo sepse po vdes nga uria dhe së ftohti këtu jashtë!”*

Milingona e pa dhe paksa e zhgënjyer i thotë: *“Ah e dashura gjinkallë, çfarë ke bërë gjatë gjithë verës, teksa unë punoja shumë dhe mbledhja ushqim?”*

“E di” – tha gjinkalla e turpëruar. “Unë këndoja dhe kërcëja nën rrezet e diellit. Më fal. Premtoj

që verën tjetër do të punoj edhe unë ushqim për ta ruajtur për në dimër. Por të lutem, më ndihmo kësaj here, ndryshe unë do të vdes nga uria dhe të ftohti këtu jashtë.”

Milingona pa nga gjinkalla dhe i buzëqeshi dhe më pas i tha:

“Sigurisht që do të të ndihmoj mikja ime. Nuk do të të lë aty jashtë në të ftohtë. Hajde, hyr brenda dhe ngrohu pranë zjarrit në vatrën time. Do të të jap edhe për të ngrënë se kam mbledhur ushqim që mund të na dalë të dyjave”.

“Faleminderit, unë nuk do t’ia kisha dalë mbanë këtij dimri pa ndihmën tënde. Si mund të ta shpërblej gjithçka që po bën për mua?”

“Ti duhet vetëm të më premtosh që do të jesh më e zgjuar vitin tjetër. Të punosh në verë, ndërsa në dimër mund të këndosh bashkë me mua, sepse të këndosh së bashku është më argëtuese!”

Më poshtë mund të gjeni 4 faqe interneti të cilat mund të jenë të dobishme për të punuar me fëmijët e vegjël për çështje nga më të ndryshmet:

http://www.4children.org/issues/1999/september_october/preparing_children_for_a_multicultural_world/

http://www.adl.org/issue_education/hateprejudice/prejudice1.asp

http://www.teachingforchange.org/wp-content/uploads/2012/08/ec_stoppingbias_english.pdf

http://www.pbs.org/kets/preciouschildren/diversity/read_activities.html